

Shtator 2016
Numri: 102
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



Edukimi I EGOS KOLEKTIVE

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Shtator 2016

VITI: X

NUMRI: 102

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Njeriu, si domosdoshmëri e natyrshmërisë së tij, e ndjen të nevojshme që t'i përkasë një grupi, komuniteti, bashkësi etj. Shpesh herë kjo është një nevojë e natyrshmërisë njerëzore, sepse njeriu është i dobët kur është i vetëm. Ndërsa dobësia sjell paaftësinë. Për këtë arsye, njeriu e ndjen të nevojshme që të gjendet bashkë me dikë, në mënyrë që të qëndrojë në këmbë. Në të kundërt, ndjenja se do të shkatërrohet apo se do të zhduket, ia pushton qenien. Ka prej njerëzve që dëshirojnë të futen në ndonjë grup, shoqëri apo komunitet për shkaqe të ndryshme si; për t'u edukuar dhe zhvilluar sa më mirë, për të kryer ndonjë punë, për të realizuar ndonjë synim, për të arritur sundimin apo për të qetësuar e kënaqur ndjenjat pozitive apo negative. Të vërtetat dhe nevojat psiko-sociologjike e imponojnë njeriun për ta bërë këtë.

Periodhë pas periudhe marrim përkatësi të ndryshme. Përkatësia familjare, përkatësia arsimore, përkatësia atdhetare, përkatësia shtetërore, përkatësia në racë, fe, medhheb, tarikat, skuadër, parti, xhemat dhe shumë përkatësi të tjera të ngjashme me këto hyjnë në rendin e ditës sonë. Në një pjesë prej këtyre përkatësive gjendemi pa vullnetin tonë, domethënë se janë përkatësi që kanë ardhur nga lindja. Ndërsa në pjesën tjetër kemi zënë vend përsëri në mënyrë të natyrshme brenda kornizave të ecurisë dhe zakoneve të shoqërisë. Por nga ne ka edhe prej atyre që dëshirojnë të bëhen anëtarë të një grupi me vetëdije dhe me dëshirë.

Çdo mjedis ndaj të cilit ndjejmë se i përkasim i shton disa ndryshime dhe vlera të reja personalitetit, mendimit dhe botës sonë të ndjenjave. Këndvështrimi ynë ndaj jetës, kriteret tona për të vlerësuar ngjarjet, gëzimet dhe hidhërimet tona fillojnë të formohen sipas grupit të cilit i përkasim. Përkatësia është një e vërtetë jetësore. E vërteta se kujt, përse dhe si duhet t'i përkasim një grupi, komuniteti apo shoqërie është një zgjedhje e rëndësishme. Nisur nga kjo pikëpamje, përkatësitë tona mund të jenë shkak për zhvillimin tonë ashtu siç mund të jenë edhe për prishjen.

Egoja "e fryrë" që del në pah te një person që nuk ka marrë edukim, që nuk ka disiplinë dhe që nuk e di cakun e tij, shkakton tirani dhe padrejtësi të mëdha. Kjo është një e vërtetë që dihet nga të gjithë. Edhe rrezikun e tërbimit të shumë nefseve të papjekura që veprojnë duke u bashkuar në grupe duhet ta krahasojmë me këtë. Nisur nga kjo që thamë, siç kanë nevojë njerëzit të edukohen dhe disiplinohen një nga një, në të njëjtën mënyrë, lind edhe domosdoshmëria për ta edukuar, disiplinuar dhe orientuar në rrugë të drejtë "nefsin" e grupit, bashkësisë apo komunitetit, nefsi i cili në përgjithësi është edhe më i vështirë për t'u edukuar. Madje, edhe "nefsi" i grupeve të cilat formohen nga individë që kanë marrë apo po marrin edukim dhe disiplinë, ka nevojë për një edukim të veçantë. Në të kundërt, "egoja e grupit" zhvillohet dhe me kalimin e kohës shndërrohet në ezhdërha. Në një situatë të tillë as vatrat e edukimit nuk mund t'i kryejnë funksionet e tyre. Në këtë atmosferë nefset fillojnë të rriten në një mënyrë të ndryshme. Si rezultat, udhëtimi i "ahseni takvim-it" shndërrohet në udhëtimin e "esfeli safilin-it".

Përmbajtja



8

Nëse përkatësitë
ushqejnë neftin dhe jo zemrën
Dr. Adem Ergyl



Njerëzimi ka nevojë për atë moral
dhe qytetërim madhështor
Osman Nuri Topbash

34



15

20



Edukimi shpirtëror në Epokën e Lumturisë
Adem Sarac

- 5 Edukimi i egos kolektive
Ahmet Tashgetiren
- 11 E drejta për të shprehur
Nuredin Jëlldëz
- 12 Feja dhe fetaria
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 15 Të mbrosh të dhunuarit
Ali Riza Temel
- 18 Ata që i do dhe ata që nuk i do Allahu
Xhafer Durmush
- 23 Devijimi në akaid
të shpie në Xhehenem
Xhemal Nar
- 24 Shqetësimi për Ahiretin
Dr. Murat Kaja
- 26 Mallkuar qofshin gënjeshtarët
Fatmir Hadri



46

Mrekullitë e Kuranit 30

Një Ajet - Një Hadith 32


Emri gjithëpërfshirës Allah 41
Ilir Hoxha

Ruani veten dhe familjen 46
Nuredin Nazarko
Zgjimi 50

Muhamed Abdullah Deraz 52

Pa ardhur ende ajo ditë 54
Sami Gëksyn

Këshillë për namazin 56
Ferid Piku



Kjo botë pa Ahiretin: Katastrofë për njerëzimin
M. Ali Eshmeli

42

Delikatesa dhe thellësia tek sahabët
Ajden Tallaj

48





Edukimi *i egos kolektive*

Ahmet Tashgetiren

Ndërmjet njerëzve përdoret një fjalë e tillë: “Ai që nuk e pëlqen veten, pëlqet dhe vdes.” Lumturia e njerëzve vjen pak edhe nga të pëlqyerit e vetes. Kjo mund të quhet edhe “energji pozitive”. Në themelin e optimizmit ka energji pozitive, ndërsa në themelin e pesimizmit ka energji negative... Njeriu që nuk pëlqen asnjë gjë që bën, e ka të pamundur që të ngjitet drejt pozitave të larta. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për shoqëritë. Njeriu ka lindur me instinktin për të jetuar në shoqëri. Formimi i familjes është një orientim hyjnor dhe i natyrshëm në çështjen për të jetuar në formë sociale. Edhe historia e njerëzimit është zhvilluar nga të jetuarit në bashkësi.

Cila është energjia pozitive që i bën shoqëritë të përparojnë, të lartësohen dhe të zhvillohen? Kur t’ua bëjmë këtë pyetje historianëve të civilizimeve nisur nga ky këndvështrim, mund të dëshmojmë shumë prej përgjigjeve që japin ata. Ibn Halduni, dijetari mysliman që mund të cilësohet si babai i historianëve të civilizimeve, thotë: “Në bazën e civilizimeve gjendet asabijeti / përpjekja / besimi në vetvete etj.” Ja, këtë mund ta shohim si energji pozitive që i lartëson shoqëritë. Mirë, por çfarë është përpjekja?

Asabijet mund të kuptohet edhe si lidhje me dashuri dhe pasion. Ndoshta edhe besim në vetvete. Ndoshta është edhe një perceptim i egos së fortë.

Një shoqëri që posedon një energji të tillë, qoftë një popull, qoftë një shoqëri ideologjike, qoftë ndonjë

drejtim fetar, qoftë ndonjë familje apo qoftë ndonjë shoqëri tregtare, nëse çdo gjë që ka në dorë e shikon me vlerat më jetike për njerëzimin, do të thotë se është takuar me energjinë për të përparuar.

Këtë vlerësim mund ta bëjmë edhe për shoqëritë që janë bashkuar për të dhënë shërbime fetare islame. Tarikatet, xhematet, strukturat shoqërore civile etj.; çdo lëvizje është formuar për të fituar kënaqësinë e Allahut nëpërmjet këtyre shërbimeve fetare. Secila lëvizje mendon se ka zbrazëtitirë në fushën ku do të punojë dhe beson se do ta mbushë atë zbrazëtitirë. Edhe të tjerët mund ta bëjnë mirë, por vendosmëria se unë mund ta bëj edhe më mirë, i hap rrugë shtimit të mirësisë dhe e ushqen këtë bindje.

Nëse i kthehemi përsëri vlerësimit të Ibn Haldunit, të gjitha këto janë burime të energjisë pozitive që mund të cilësohen si “përpjekje pozitive”.

Kur përpjekja shuhet, kur pasioni del jashtë funksionit, kur perceptimi i egos zhduket, kur emocionit i përparimit humbet, kur besimi në vetvete dobësohet, do të thotë se shoqëria u ka ardhur periudha e prapambetjes dhe rënies. Kjo mund të ndodhë për shkak të ndryshme si: Brezat e rinj nuk e kanë pasionin e brezit të parë, ose nuk u japin dot përgjigje sfidave që u dalin përpara, ose vlerat që kanë nuk u përgjigjen dot pritshmërive të kohëve të reja.

Një dimension tjetër i asabijetit, përveç besimit në vetvete, është edhe ndjenja shkatërruese kundrejt

të tjerëve. Në të vërtetë, çdo asabijet ka në vetvete pak esencë “që e përjashton tjetrin”. Besimi në vetvete gjithmonë arrihet duke e krahasuar veten me të tjerët. Për këtë arsye, në çdo asabijet gjendet pak sundim i “egos”.

Ndërkohë që Islami inspiron emocione si “gara në mirësi” apo “të bësh mirësi për hir të Allahut” në të gjitha personalitetet dhe strukturat që formohen në përbërjen e tij, nga ana tjetër i inkurajon besimtarët që të jenë të ndjeshëm për t’i mbrojtur të drejtat e të tjerëve, për të mos i dëmtuar ata dhe për të mos ua penguar ecjen dhe përparimin e tyre në mirësi.

Islami e sheh shoqërinë e tij si tullat e një muri apo si organet e një trupi. Të qenët si tullat e një muri do të thotë që ta plotësojmë dhe ta forcojmë njëri-tjetrin. Ndërsa të qenët si organet e një trupi do të thotë që të jemi të informuar për ekzistencën jetike të njëri-tjetrit, ta ndjejmë dhimbjen që i shkaktohet ndonjërit prej nesh dhe si rezultat, të mos bëjmë gjëra që i dëmtojnë të tjerët. Vetëdija e tërësisë së trupit duhet të jetë te të gjitha organet. Kjo do të thotë që truri duhet të ruaj zemrën dhe zemra duhet të ruaj edhe damarët më të hollë.

Thirrja që bën Allahu Teala në Kuranin Fisnik duke u shprehur: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”** (Huxhurat, 10) – dhe thirrje të tjera si: **“Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme, ndërsa Unë jam Zoti juaj, andaj frikësohuni prej Meje! Por ata (popujt ku u çuan të dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre. Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte.”** (Mu’minun, 52-53) **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë. Drejtojuni Atij me pendesë, frikësojuni Atij dhe falni namazin e mos u bëni si ata, që i shoqërojnë Atij diçka tjetër (në adhurim), si ata, që fenë e vet e kanë përçarë dhe janë ndarë në grupe, e ku çdo grup është i kënaqur me atë që ka.”** (Rum, 30-32), janë për ta parandaluar asabijetin negativ që të mos hyjë si një krimb në strukturën e shoqërisë islame.

Në Kuranin Fisnik ka një qortim shumë të fortë kundrejt “marrjes së epshit për zot”. Aty shtrihet pyetja: **“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot?”** (Furkan, 43) Ndërsa në ajetin pasues vjen ky gjykim: **“A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.”** (Furkan, 44) Të jesh si bagëtitë (kafshët) do të thotë të shkosh pas epshit. Ndërsa njeriu hutohet, madje edhe shmanget nga rruga e drejtë, për shkak se e merr epshin e tij për zot me vullnetin e tij të lirë dhe me vetëdije.

Marrja e epshit për zot do të thotë shndërrim në idhull i “unit” me dije apo pa dije. Do të thotë një

ngarkim barre mbi “unin” i cili asnjëherë nuk e mbart dot. Të thënët vetëm: “Unë!”, është formimi më i qartë i asabijetit, “Egos” dhe “Ene-s”. Nëse asabijeti arrin deri në këtë dimension, edhe pse e bën njeriun të përparojë deri në një distancë të caktuar, është një barrë që e bën njeriun të ndëshkohet nga fuqia hyjnore dhe që e shtyp atë nën përgjegjësinë që i ka ngarkuar mbi supe.

Aq sa është një dukuri negative “marrja për zot e epshit” nga ana e njeriut, po aq pasoja të tmerrshme lind edhe marrja për zot e epshit nga ana e shoqërisë.

Edukimi i vetes është një disiplinë që e njohim të gjithë. Në përgjithësi ky edukim shpaloset në përmasa individuale. Njeriu ka një nefsi. Nefsi ka një strukturë që “urdhëron të keqen”. Nefsi duhet të edukohet dhe pastrohet, në mënyrë që t’i kalojë gradat emmare, levvame, mulhime etj. dhe të lartësohet në kulmet e nefsit mutmainne, razije dhe marzije. Gjithashtu, të shpëtojë nga devijimet si “marrja e epshit për zot”, të hyjë ndërmjet robërve të devotshëm duke e përvetësuar “vetëdijen e nënshtrimit dhe bindjes ndaj Allahut Teala” dhe të arrijë në një cilësi e cila do t’ia mundësojë hyrjen në Xhenet.

Sipas informacionit që jep Kurani Famëlartë, njeriu bie në tërbim kur e sheh veten sikur nuk ka nevojë për të tjerët: **“Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.”** (Alak, 6-7) Kur njeriu ndjehet i vetëmjaftueshëm, do të thotë se ka shkelur në shkallën e parë të marrjes së epshit për zot. Esenca e edukimit të nefsit është dhënia e vetëdijes së nënshtrimit dhe bindjes ndaj Zotit (xh.xh.), domethënë, që njeriut t’i jepet vetëdija se të gjitha gjërat që i posedon i ka nga mirësia dhe begatia e Allahut të Madhëruar. “O njeri! Ti po përdor fuqinë që ta ka dhënë Allahu i Lartësuar. Andaj, përdore atë brenda kufijve që të ka vendosur i Madhërishmi! Përndryshe do ta kalosh cakun dhe do të jesh përgjegjës për çdo gjë që vepron.” Ja, një vetëdije e tillë i jepet njeriut në edukimin e nefsit.

Shoqëritë dhe organizatat i çojnë ata që gjenden brenda tyre te një iluzion fuqie shumë më të madh. “Vetëmjaftimi” ka më shumë mundësi formimi në grupe dhe shoqëri. Në të vërtetë, njerëzit formojnë shoqëri për të kaluar disa dobësi që kanë. Më së fundi, shoqëritë bashkohen dhe formojnë një fuqi. Kjo fuqi ka një lloj nefsi. Për shkak të kësaj lind nevoja për ta edukuar këtë nefsi. Kryerja e kësaj nevojë në jetën e përditshme është shumë me e vështirë se edukimi i një nefsi. Siç është i rëndësishëm edukimi i nefseve të dy njerëzve në marrëdhëniet ndërmjet tyre brenda një grupi, po kështu është shumë më e rëndësishme marrëdhënia që kanë me dhjetëra apo qindra njerëz ndërmjet tyre dhe me të tjerë jashtë tyre. Ne e dimë se zbatimi në jetën e përditshme i dispozitës së Kuranit Fisnik, në të cilin thuhet: **“Besimtarët janë vëllezër...”** – në shoqërinë islame,

ka të bëjë me formimin e vetëdijes së vëllazërisë në zemrën e çdo besimtari. Gjithashtu e dimë se kjo nuk është aspak e lehtë.

Kjo është një e vërtetë që e dëshmojmë në çdo kohë: “Në çdo vend ku njerëzit i kanë të mira marrëdhëniet me njëri-tjetrin, patjetër duhet që egot të frenohen, në mënyrë që të mos ndërhyjnë dhe të mos bëhen shkak për padrejtësi e zullume. Mirë, por nëse është e mundur që ajetin fisnik të mësipërm ta lexojmë në formën: “Të gjitha grupet islame janë vëllazër”, sa përputhet kjo me realitetin që po përjetojmë në ditët e sotme? Edhe pse ajeti nxjerr në pah një synim, të gjithë i dinë vështirësitë e praktikimit të tij në jetë ndërmjet individëve dhe grupeve besimtare.

Ndërkohë që pasionet janë të kufizuara në plan individual, kur njerëzit mblidhen dhe bëhen grup, synimet rriten, fushat e bashkëpunimit shtohen dhe si rezultat, gjëja që ne e quajmë “nefsi i grupit” fillon të përdorë një fuqi më shtypëse për të arritur qëllimin e saj. Ja, aty do të arrihet një pikë e domosdoshme e cila është “Edukimi i Nefsit të Grupit”. Në Kuranin Fisnik ka shumë shembuj tipikë që tregojnë se si i shtyn njerëzit “psikologjia e grupit” për të marrë rezultat duke përdorur fuqinë. Për shembull, njëri prej tyre i përket botës së ndjenjave të politeistëve mekas. Në ajetin fisnik thuhet: **“Vërtet thonë ata: “Ne jemi grup i pathyeshëm”?! Së shpejti do të thyhet grupi (në Bedr) dhe (secili prej tyre) do t’ia mbathë.”** (Kamer, 44-45) Ndërsa një ajet tjetër i përket botës së ndjenjave të besimtarëve që gjendeshin në ushtrinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në Hunejn: **“Në të vërtetë, Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, si dhe në ditën e (luftës së) Huneinit, kur juve ju mahniti numri juaj i madh. Por ai numër nuk ju solli dobi aspak, sepse toka ju duk juve e ngushtë, edhe pse është e gjerë dhe kthyer shpinën duke ia mbathur.”** (Teube, 25)

Besimtari duhet ta pranojë se burimi i fuqisë që ai përdor është nga Allahu i Lartësuar. Andaj, të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm se nuk mund të përdorin asnjë lloj force pa vullnetin dhe dëshirën e Zotit (xh.sh.). Për këtë arsye, besimtari nuk duhet të dalë jashtë rregullave dhe dispozitave që i ka vendosur Allahu (xh.xh.), kur ta përdorë fuqinë dhe energjinë e tij. “La havle ve la kuvete il-la bil-lah!” Siç duhet të thotë çdo njeri: “Ne jemi të Allahut, ne i përkasim Allahut!”, edhe çdo lloj shoqërie duhet të formohet me misionin “për hir të Allahut” dhe duhet të veprojë sipas këtij misioni.

Ndërsa ajo që mund të thuhet në lidhje me mjekimin e nefsit të grupit është kjo:

“Çdo gjë që mund të thuhet për individin brenda kornizës së të drejtave të vëllazërisë në Islam, mund të thuhet edhe për grupet apo shoqëritë. Dispozitat e vendosura për t’i shtuar sjelljet që e forcojnë vëllazërinë dhe për t’i ndaluar sjelljet e veprimet që e ndalojnë atë janë të vlefshme edhe në marrëdhëniet ndërmjet grupeve me njëri-tjetrin.

“Drejtojuni Atij me pendesë, frikësojuni Atij dhe falni namazin e mos u bëni si ata, që i shoqërojnë Atij diçka tjetër (në adhurim), si ata, që fenë e vet e kanë përçarë dhe janë ndarë në grupe, e ku çdo grup është i kënaqur me atë që ka.” (Rum, 31-32) **“Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme, ndërsa Unë jam Zoti juaj, andaj frikësohuni prej Meje! Por ata (popuj ku u çuan të dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre. Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte.”** (Mu’minun, 52-53)

Një ajet tjetër i ngjashëm me këto gjendet në suren Huxhurat, në të cilën sistemohen marrëdhëniet ndërmjet besimtarëve brenda kornizës së vëllazërisë: **“O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo. Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirrësh me emër të keq pas (pranimit të) besimit! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.”** (Huxhurat, 11)

Marrëdhëniet e popujve, fiseve, shteteve, tarikateve, medhhebeve dhe strukturave sociale civile islame duhet të analizohen përsëri nga aspekti i “nefsit të grupit” dhe duhet të bëhet çfarëdo që të jetë e nevojshme për t’i futur ato në një format prej të cilit Allahu Teala është i kënaqur, sepse, veprat që janë vënë në pah qoftë në shkallë shtetesh apo qoftë në shkallë organizatash fetare, japin shenja të defekteve serioze nëse i shtjellojmë për t’i dhënë përgjigje pyetjes: “Për kë bëhen ato?” Nëse në fund të punës ka një situatë si “padrejtësi kundrejt myslimanëve” dhe nëse pamja e përgjithshme jep një tablo të mjerë në të cilën “myslimanët vrasin njëri-tjetrin”, do të thotë se po përjetohej një problem i madh në njetin e punëve që gjoja po bëhen për hir të Allahut (xh.xh.).

Nëse ne kemi probleme me njëri-tjetrin, secili prej nesh së pari duhet të shohë veten e tij pa i paragjykuar të tjerët dhe pyetjes: “Çfarë mund të kem bërë ndonjë gjë prej të cilës Allahu nuk është i kënaqur?”, duhet t’i japim përgjigje me zemër të hapur, domethënë, pa fshehur asnjë gjë sikur të ishim në mjedisin e mahsherit të vërtetë dhe në audiencën e Allahut Teala. Këtu shihet qartazi se në botën tonë ka një situatë jo të mirë dhe problematike. Andaj, nëse bëhet fjalë për një dukuri si “lufta e Islamit me Islamin”, duhet t’i analizojmë edhe një herë ato që kemi në dorë dhe ato që gjenden në zemrat tona. Kujt i gjuhet me grushte, kundër kujt është e gjithë kjo urrejtje, kë qëllon ai plumb i dalë prej nesh dhe çfarë thotë Allahu Teala kur na shikon ne?

Përse jemi krijuar? Çfarë na ka bashkuar? Cili do të jetë vendi ku do të shkojmë nesër? A do të shkojmë te idhulli epsh apo do të dalim në audiencën e Krijuesit të Madhërisëm?



NËSE PËRKATËSITË ushqejnë nefsin

*Dhe jo
Zemrën*

Dr. Adem Ergyl

Njeriu, si domosdoshmëri e natyrshmërisë së tij, e ndjen të nevojshme që t'i përkasë një grupi, komuniteti, bashkësisë etj. Shpesh herë kjo është një nevojë e natyrshmërisë njerëzore, sepse njeriu është i dobët kur është i vetëm. Ndërsa dobësia sjell paaftësinë. Për këtë arsye, njeriu e ndjen të nevojshme që të gjendet bashkë me dikë, në mënyrë që të qëndrojë në këmbë. Në të kundërt, ndjenja se do të shkatërron apo se do të zhduket, ia pushton qenien. Ka prej njerëzve që dëshirojnë të futen në ndonjë grup, shoqëri apo komunitet për shkaqe të ndryshme si; për t'u edukuar dhe zhvilluar sa më mirë, për të kryer ndonjë punë, për të realizuar ndonjë synim, për të arritur sundimin apo për të qetësuar e kënaqur ndjenjat pozitive apo negative. Të vërtetat dhe nevojat psiko-sociologjike e imponojnë njeriun për ta bërë këtë.

Periudhë pas periudhe marrim përkatësi të ndryshme. Përkatësia familjare, përkatësia arsimore, përkatësia atdhetare, përkatësia shtetërore, përkatësia në racë, fe, medhheb, tarikat, skuadër, parti, xhemat

dhe shumë përkatësi të tjera të ngjashme me këto hyjnë në rendin e ditës sonë. Në një pjesë prej këtyre përkatësive gjendemi pa vullnetin tonë, domethënë se janë përkatësi që kanë ardhur nga lindja. Ndërsa në pjesën tjetër kemi zënë vend përsëri në mënyrë të natyrshme brenda kornizave të ecures dhe zakoneve të shoqërisë. Por nga ne ka edhe prej atyre që dëshirojnë të bëhen anëtarë të një grupi me vetëdije dhe me dëshirë.

Çdo mjedis ndaj të cilit ndiejmë se i përkasim i shton disa ndryshime dhe vlera të reja personalitetit, mendimit dhe botës sonë të ndjenjave. Këndvështrimi ynë ndaj jetës, kriteret tona për të vlerësuar ngjarjet, gëzimet dhe hidhërimet tona fillojnë të formohen sipas grupit të cilit i përkasim. Përkatësia është një e vërtetë jetësore. E vërteta se kujt, përse dhe si duhet t'i përkasim një grupi, komuniteti apo shoqërie është një zgjedhje e rëndësishme. Nisur nga kjo pikëpamje, përkatësitë tona mund të jenë shkak për zhvillimin tonë ashtu siç mund të jenë edhe për prishjen.

Egoja “e fryrë” që del në pah te një person që nuk ka marrë edukim, që nuk ka disiplinë dhe që nuk e di cakun e tij, shkakton tirani dhe padrejtësi të mëdha. Kjo është një e vërtetë që dihet nga të gjithë. Edhe rrezikun e tërbimit të shumë nefseve të papjekura që veprojnë duke u bashkuar në grupe duhet ta krahasojmë me këtë. Nisur nga kjo që thamë, siç kanë nevojë njerëzit të edukohen dhe disiplinohen një nga një, në të njëjtën mënyrë, lind edhe domosdoshmëria për ta edukuar, disiplinuar dhe orientuar në rrugë të drejtë “nefsin” e grupit, bashkësisë apo komunitetit, nefsi i cili në përgjithësi është edhe më i vështirë për t’u edukuar. Madje, edhe “nefsi” i grupeve të cilat formohen nga individë që kanë marrë apo po marrin edukim dhe disiplinë, ka nevojë për një edukim të veçantë. Në të kundërt, “egoja e grupit” zhvillohet dhe me kalimin e kohës shndërrohet në ezhdërha. Në një situatë të tillë as vatrën e edukimit nuk mund t’i kryejnë funksionet e tyre. Në këtë atmosferë nefset fillojnë të rriten në një mënyrë të ndryshme. Si rezultat, udhëtimi i “ahseni takvim-it” shndërrohet në udhëtimin e “esfeli safilin-it”.

Mbrojtja e anëtarëve të grupit nga dredhitë dhe kurthet e nefsit të grupit, orientimi i grupit drejt një synimi të vërtetë e të ligjshëm dhe edukimi i individëve në këtë fushë, sigurisht se në fillim është përgjegjësi e liderëve të grupit. Gjithashtu nuk mund të themi se anëtarët e grupit nuk kanë asnjë përgjegjësi në lidhje me këtë çështje. Sigurisht se edhe ata kanë përgjegjësinë për t’ua kujtuar, për t’ua bërë të qartë dhe për t’i ndaluar liderët nga gabimi. Sahabët e nderuar i thanë Umerit (r.a.): “Nëse gabon, të drejtojmë me shpatat tona nëse do të jetë e nevojshme.” Ky këndvështrim që kishin sahabët e nderuar ishte rezultati i një edukimi rigoroz që është marrë në vatrën profetike, sepse, nga një njeri që nuk ka respekt ndaj Zotit (xh.xh.) dhe ndaj të vërtetës, nuk mund të shpresohet që të ketë bindje dhe nënshtrim ndaj besimit.

Fushat kryesore në të cilat veçanërisht duhet të edukohet “nefsi i grupit” janë këto:

1. Edukimi për dashuri, besnikëri dhe bindje të pakufishme

Nëse një person i bashkohet një grupi me vullnetin e tij, padyshim se ky është një rezultat i natyrshëm i admirimit, besimit dhe dashurisë që ndjen ndaj atij grupi. Një njeri në të vërtetë nuk konsiderohet anëtar i një grupi ndaj të cilit nuk ndjen dashuri. Ndërsa grada e admirimit dhe dashurisë formon thellësinë në besnikëri dhe nivelin e fuqinë në influencë. Si rezultat i kësaj, njeriu merr parasysh çdo sakrificë dhe rrezik në mbrojtje të atij grupi. Kjo dukuri asnjëherë nuk mund të konsiderohet shqetësuese brenda kornizës së synimeve të ligjshme, madje, një besnikëri e tillë është për t’u parë me lakmi. Nëse njeriu

ndjen më shumë dashuri ndaj grupit, partisë, shkollës, tarikatit dhe liderit të tij, asnjëherë nuk mund të konsiderohet si diçka e gabuar. E gabuar është mosmarrja në konsideratë e të tjerëve dhe poshtërimi apo nënçmimi i atyre. Dashuritë ekstreme me kalimin e kohës mund të shkaktojnë fanatizëm të verbër. Ndërsa fanatizmi është një sëmundje grupi, sepse, të dhënë pas diçkaje në një masë kaq të madhe, e shndërron njeriun pothuajse në të verbër dhe të shurdhër. Për shkak të kësaj, në vend se e vërteta të analizohet me mendje të shëndoshë dhe me transmetim të saktë (Kuran dhe Sunet), bindjet e grupit apo të liderit mund të dalin para çdo gjëje. Nëse udhëheqja e një grupi është një udhëheqje që i bën idhuj dëshirat e pasionet e saj, që nuk ka kufij në hallall e haram, që nuk mbart shqetësimin për Ahiretin dhe që është e dhënë vetëm pas interesave të kësaj bote e pushtetit, natyrisht se ata që gjenden në atë grup do të skllavërohen, do të bëhen robotë dhe vullneti i tyre nuk do të merret në konsideratë. Ndërsa një rezultat i atillë është prej padrejtësive më të mëdha që mund t’i bëhet nderit dhe dinjitetit të njeriut. Dashuria dhe besnikëria jonë duhet të jenë të kufizuara sipas dispozitave hyjnore. Në një vend ku kundërshtohet Zoti (xh.xh.) dhe e vërteta, nuk mund të bëhet fjalë për bindje ndaj krijesës.

2. Edukimi për të mos rënë në kthetrat e vetëpëlqimit

Siç është një sëmundje shpirtërore vetëpëlqimi nga ana e njeriut, edhe vetëpëlqimi ekstrem i grupit është një shenjë e një sëmundjeje edhe më të madhe. Ky vetëpëlqim mund të dalë në pah nganjëherë për shkak të numrit të madh dhe nganjëherë për shkak të punëve apo shërbimeve që bën grupi. Fitoret dhe sukseset e arritura mund ta llastojnë grupin. Për shembull, myslimanët ranë në vetëpëlqim në luftën e Hunejnit ngaqë ishin të shumtë në numër. Kjo gjendje i bëri ata që të shpartalloheshin. Allahu i Lartësuar ua tërhoqi vërejtjen dhe i qortoi ata për këtë gabim të ndjenjave të tyre. Kjo, në një kuptim është vetëpëlqim i grupit, gjë e cila e verbon grupin ndaj mangësive dhe gabimeve të tij. Gjithashtu i vendos një pengesë të madhe zhvillimit të tij. Andaj, një rrugë e tillë nuk duhet të zgjidhet ngaqë tërheq zemërimin e Allahut të Madhëruar edhe pse duket si një motivim i fuqishëm në aparençë për t’ua shtuar sa më shumë besnikërinë dhe dashurinë anëtarëve. Allahu Teala e ka konsideruar si kundërshtim të rregullave të vëllazërisë veçanërisht hyrjen e grupeve besimtare në garën e lavdërimit kundrejt njëri-tjetrit apo të talljes me mangësitë e njëri-tjetrit, sepse robërit nuk mund ta dinë se kush është më i mirë te Allahu Teala.

3. Edukimi për të mos rënë në mendjemadhësi

Mendjemadhësia është fara e faraonizmit dhe karunizmit. Ajo e bën personin apo grupin udhëtar të

Xhehenemit. Mendjemadhësia në përgjithësi lind nga besimi i tepërt në vetvete. Dituria, gjendja e mirë, pushteti dhe pasuria, megjithëse i japin vetëbesim grupit, mund t'i japin edhe mendjemadhësi. Nëse grupi kaplohet nga ndjenja e vetëpëlqimit, do të thotë se është kapluar nga sëmundja e nënçmimit të robërve të tjerë të Allahut Teala, e cila është prej mëkateve më të mëdha. Kjo sëmundje është si virusi i kancerit në trup, i cili duhet të mjekohet para se të rritet dhe të përhapet në të gjithë trupin. Në të kundërt, e shkatërron trupin në të cilin gjendet. Mendjemadhësia e tërheq grupin drejt dallgës së egoizmit dhe e bën atë të ndjehet sikur nuk ka nevojë për të tjerët. Ndërsa një situatë e tillë shkakton devijim të pafrenueshëm. Të mos harrojmë se njëri prej ligjeve të Allahut (sunnetullah) ndaj shoqërive është që t'i shkatërrojë grupet që kanë mendjemadhësi dhe t'i fshijë ato nga sipërfaqja e tokës me kalimin e kohës.

4. Edukimi në lidhje me përdorimin e fuqisë

Formimi i grupeve në të njëjtën kohë është një formim i fuqisë. Kudo që të formohet ndonjë fuqi, është e qartë se do të bëhet shkak për një rrezik serioz nëse nuk udhëhiqet në mënyrë të drejtë. Sado lloje fuqish që të ketë si; fuqia e parasë, fuqia e pushtetit, fuqia e shumicës, fuqia e besnikërisë, fuqia e bashkësisë etj. do të thotë se në vetvete mbart një rrezik. Siç mund të ketë ndikime shkatërruese akumulimi i pikave të shiut që shndërrohet në rrëqe, edhe shoqëritë njerëzore që bashkohen në të njëjtën mënyrë, do t'i prishin dhe do t'i shkatërrojnë shoqëritë dhe individët nëse nuk udhëhiqen e administrohen siç duhet. Bazuar në këtë, fuqinë duhet të mësojmë ta përdorim për Allahun e Lartësuar brenda rregullave të ligjshme dhe të pranueshme.

5. Edukimi për të zënë vend pranë fesë së Zotit (xh.xh.), kundër gabimit dhe devijimit

Sukseset dhe fitoret e arritura nga grupi, me kalimin e kohës mund t'i shpjerë anëtarët te besimi se çdo gjë që bën grupi apo lideri i tij është e drejtë dhe e vërtetë. Ndërkohë besimtarët duhet të qëndrojnë me vendosmëri në palën e të vërtetës dhe kundër devijimit duke u shprehur se vetëm Allahu Teala është i pagabueshëm. Nëse nuk veprohet në këtë mënyrë, grupi apo lideri i grupit mund të shndërrohet në idhull apo të adhurohet si zot. Edhe pse sukcesi dhe triumfi i grupit arrihet me bindje dhe nënshtrim ndaj liderit, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se bindja duhet të bëhet brenda kufijve të lejuar. Përgjatë historisë mund të shohim shumë shoqëri që kanë rënë në një idhujtari të tillë dhe që nuk kanë qenë të vetëdijshme për këtë.

Kjo ngjarje që i ka ndodhur Adij ibn Hatimit (r.a.), e shpjegon mjaft qartë mënyrën se si janë vënë në

pozitat e zotit liderët, dijetarët e fesë dhe murgjit. Adij ibn Hatimi (r.a.), tregon: Edhe pse në qafë kisha një kryq prej floriri, shkova te i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të. Ai (a.s.), më tha: *“Çfarë është ky, o Adij? Menjëherë hidhe atë idhull!”* Pasi më tha kështu, i Dërguari i Allahut (a.s.), lexoi ajetin: **“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes, ndërkohë që janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë** (në adhurim).” (Teube, 31) Pastaj më tha: *“Ata nuk i adhuronin këta, por kur këta ua bënë hallall ndonjë gjë atyre, ata e pranonin për hallall dhe kur ua bënë ndonjë gjë haram, e pranonin për haram (gjë e cila konsiderohet adhurim).”* (Tirmidhi, Tefsir, 9/10.)

6. Edukimi për t'ia kujtuar vazhdimisht synimin grupit, komunitetit, bashkësisë etj.

Veçanërisht grupet e mirësisë e edukimit, organizatat e ndihmave humanitare, shoqatat vullnetare dhe ndoshta edhe partitë, në fillim mund ta nisin rrugën me qëllime dhe nijete shumë sublimë, por nganjëherë, disave prej tyre mund t'u devijojnë mendjet e zemrat dhe të kenë paqartësi në nijet për shkak të interesave të kësaj bote që u dalin përpara, mundësive të mëdha financiare dhe pushtetit të madh që arrijnë të kapin. Në situata të tilla, veçanërisht ata që gjenden në pozitën e liderit, duhet t'ua kujtojnë vazhdimisht anëtarëve të grupit, komunitetit, bashkësisë etj. qëllimin kryesor dhe t'ua tërheqin vëmendjen në lidhje me pikat e devijimit. Nëse një devijim i tillë ka dalë në pah te pozita e liderit, anëtarët e tjerë të grupit, komunitetit, bashkësisë etj. që janë të vetëdijshëm duhet të përpiqen t'ua kujtojnë liderëve qëllimin që kanë pasur dhe t'ua korrigjojnë nijetet e tyre për hir të Allahut Teala. Në të kundërt, ata që humbin nuk do të jenë një apo disa prej tyre, por të gjithë anëtarët bashkë me liderët.

Së fundi mund të themi këtë: Të gjendesh brenda një grupi të mirë nga të gjitha aspektet në emër të arritjes së shkallës më sublimë në mirësi dhe devotshmëri, është një specifikë mjaft e rëndësishme nga aspekti i zbritjes së mëshirës hyjnore mbi ne në çdo lloj situatë. E rëndësishme është që të gjendemi në vendin e duhur. Përkatësitë tona të vogla nuk duhet të na çojnë në fraksione që e përçajnë tërësinë e umetit, por duhet të shndërrohen në gjymtyrë të forta që e mbajnë të mbërthyer fort unitetin e umetit. Nëse përkatësitë tona, të cilat duhet të jenë shkak për t'i pastruar nefset, për t'i përmirësuar zemrat dhe për të fituar Ahiretin, bëhen shkak që nefset tona të tërbohen dhe të llastohen, atëherë, ato do të jenë një humbje e madhe edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.



E DREJTA PËR TË SHPRESUAR

Nuredin Jëlldëz

E drejta për ta parë me shpresë të sotmen dhe të nesërmen është haku i atyre që kanë shkëlur mbi sipërfaqen e tokës si njerëz besimtarë. Faktikisht, shpresa e vërtetë është shpresa e tyre.

Të besosh dhe të jetosh si besimtar do të thotë që të formosh lidhje me Allahun Teala, i Cili është Krijuesi dhe dhuruesi i jetës. Edhe pse djalli i mallkuar dhe ata që i shërbejnë atij përpiqen t'i bëjnë njerëzit të besojnë se të bëhesh besimtar është shkaku i vetëm i hyrjes në qorrsokak, e vërteta është se Allahu Teala është poseduesi i çdo gjëje dhe Ai që e thotë fjalën e fundit. Njeriu besimtar që jeton nën hijen e kësaj të vërtete të madhe është njeriu i shpresës.

Të jesh besimtar do të thotë që t'i kapërcelesh shpresat e kufizuara të kësaj bote. Të jetosh për Ahiretin, do të thotë që çdo investim ta bësh për botën tjetër dhe ta shohësh këtë botë si një stacion. Besimtari e njeh mirë këtë botë dhe realitetin e saj.

Besimtari e njeh këtë botë nga babai i tij, Ademi, alejhi's-selam. Ai e sheh këtë botë si vendin në të cilin ka ardhur pasi zbriti nga Xheneti. Atë (dynjanë) nuk e konsideron vatan, por e sheh si vendqëndrim i detyrueshëm për t'u kthyer te vatani i vërtetë.

Besimtari e njeh nga Nuhu (a.s.), jetën të cilën po bën. Besimtari nuk e humb kurrë shpresën, edhe nëse vështirësitë dhe vuajtjet vazhdojnë jo me vite, por me shekuj me radhë. Edhe nëse gjendet në një vend të thatë apo edhe nëse tufani ia shkatërron të gjithë botën materiale, prapë se prapë qëllimi i tij është i qartë dhe i caktuar. Besimtari përpriqet dhe mundohet, por asnjëherë nuk dorëzohet. Ai jeton me një besim që shekujt nuk mund ta vjetërsojnë.

Njëri prej burimeve të shpresës së besimtarit janë ato që sheh te Ibrahim, alejhi's-selam. Besimtari është njeri durimtar dhe i qëndrueshëm kundrejt të gjitha pengesave që i dalin përpara, edhe nëse ato i vijnë nga shtëpia e tij, nga babai i tij, nga ndonjë sistem që ka ushtri të fuqishme apo nga çdo gjë tjetër. Besimtari e merr nga Ibrahim (a.s.), besimin për të pasur shpresa, për të vazhduar pa u dorëzuar dhe për t'u bindur se durimtarët janë ata që do të fitojnë në fund. Besimtari e ka parë te Ibrahim (a.s.), të vërtetën se si nuk e djeg

dot zjarri njeriun. Gjithashtu, nga ai ka mësuar që të mos i humbasësh shpresat edhe nëse hallet i shndërrohen në flakë. Nga Ibrahim (a.s.), ka mësuar edhe besimin ndaj Zotit (xh.xh.), duke u mësuar se "Ai i mjafton".

Kur besimtari e shikon Musain, alejhi's-selam, sheh te ai se ndaj cilave gjëra duhet të durojë përgjatë jetës së tij. Gjithashtu e kupton se hallet mund të fillojnë akoma edhe pa lindur dhe e kupton se uji nuk mund ta mbysë njeriun dhe se askush nuk mund t'i bëjë dëm, nëse Allahu Teala dëshiron ta mbrojë. Ndërkohë që ai e kupton kështu të vërtetën, filizi i shpresës rritet vazhdimisht brenda tij.

Besimtari e kujton të Dërguarin e Allahut, Muhamedin (a.s.), nga lutja që ka bërë në Taif. Atë mundohet ta shohë në rrugët e Mekës, në xhaminë e tij në Medine dhe në fund të malit Uhud. Ai e sheh Pejgamberin (a.s.), duke dhënë përgëzimin e rënies së sistemit të Kistrës në Hendek me kazmën në dorë. Ai gjithmonë është i entuziazmuar me një emocion që varfëria, vetmia dhe dëshpërimi nuk mund t'ia shuajnë. Besimtari ulet me shpresë dhe ngrihet me shpresë. Hyn në shtrat me shpresë dhe ngrihet nga shtrati çdo mëngjes sikur të kishte lindur atë ditë. Besimtari e sheh premtimin që Allahu ia ka dhënë në lidhje me Xhenetin. Ai e ndjen veten sikur të ishte në buzë të lumenjve të Xhenetit.

Ai e di shumë mirë se Zoti (xh.xh.), vlerëson çdo vepër, andaj përpriqet pa reshtur, në mënyrë që të bëhet një besimtar punëtor. Ai e kupton se nuk i ka hije që të rrijë, të presë dhe të thurë imagjinata. Ai gjithmonë thotë: "Çfarëdo që mund të bëj, le ta bëj për hir të Allahut, sado pak qoftë ajo". Besimtari beson se Allahu mund t'i rrisë e t'i bëjë sa mali i Uhudit sevapet e punëve të vogla që ai bën.

Besimtari ia lë amanet Allahut Teala të sotmen, të nesërmen, atë që posedon dhe atë që ka në imagjinatë, sepse ai e di se çdo gjë që i lihet amanet Allahut të Lartësuar nuk mund të dëmtohet. Nëse ky është besimtari, atëherë, përse shpresa të mos jetë e drejtë e tij? Një Dynja e mirë dhe një Ahiret i mirë është e drejta e tij. Gjithashtu, edhe Xheneti, edhe të shpresuarit e tij është e drejtë e tij.



Feja dhe Fetaria

(Tevhidi, istikameti, ndershmëria dhe adhurimi)

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Koncepti fe është një tërësi që formohet nga besimi dhe praktika, të cilët do t'i japin rezultatet e tyre në Ahiret. Ndërsa në aspektin terminologjik feja është një sistem hyjnor që i inkurajon njerëzit e mençur për të bërë mirësi me vullnetin e tyre, është një rrugë e caktuar nga Allahu Teala që i shpie njerëzit te vetë Ai dhe një kornizë e bindjes, adhurimit dhe nënshtrimit ndaj Atij. Për këtë arsye, është një realitet dhe një e vërtetë e cila ka ardhur që nga njeriu i parë. Përfaqësuesi i fundit dhe më i përsosuri i konceptit që quhet fe është Islami, të cilin Allahu Teala e ka përsosur për myslimanët dhe ka njoftuar se e ka zgjedhur dhe është i kënaqur prej tij. (Shik. Maide, 5)

Nëse themi se “myslimani është një vlerë që e ka humbur veten” duke marrë parasysh jo gjendjen e tij në Kuranin Fisnik, por në jetën e tij të përditshme, kjo është me vend. Sëmundja më e madhe e myslimanit mund të përkufizohet në këtë mënyrë: “Dashuria e madhe ndaj jetës së kësaj bote.” Sepse myslimani i sotëm nuk po i jep dot rëndësi të mjaftueshme asnjë gjëje përveç çështjes së ushqimit dhe veshmbathjes. Madje, një mysliman i atillë u jep përparësi interesave të tij ekonomike dhe politike kundrejt detyrave të fesë dhe vëllazërisë fetare.

Disa prej myslimanëve tashmë në një kuptim janë përshtatur ndaj mosekzistencës së tyre dhe kanë fituar një personalitet të ri në mjedisin e devijuar dhe shekullar. Ata po e shtojnë edhe më shumë mundësinë e tendencës për t'i parë dhe pranuar si normale gjërat anormale. Por të mos harrojmë se çdo mysliman është i obliguar që t'i zbatojë pa mangësi

bazat e Islamit sa të jetë e mundur dhe t'i lejojë t'i zbatojnë edhe ata që ka nën përgjegjësi, sepse myslimani duhet të ketë vendosmërinë, vullnetin dhe përgjegjësinë për ta zbatuar Islam. Me një shprehje tjetër, feja dhe fetaria e tregojnë influencën e pritur prej tyre nëse zbatohen pa shtirje, me sinqeritet, me ndershmëri dhe me mënyrë shembullore. Në ditët e sotme ka një nevojë të madhe për këtë në çdo shtresë dhe në çdo pozitë. Madje këtu mund të fusim edhe shtresën e fetarëve, sepse pretendimet për fetari që nuk e kanë gjetur dot mundësinë për ta zbatuar fenë apo që nuk e kanë arritur dot pjekurinë e nevojshme, me shprehjen më të thjeshtë, nuk janë gjë tjetër përveçse mashtrime.

Atëherë, për të pasur një fetari ideale, duhet të bëjmë një jetë sipas urdhrave dhe ndalesave të Allahut Teala, i Cili na e ka falur jetën dhe sipas traditës së rob-it shembullor, të Dërguarit të fundit, Muhamedit (a.s.), i cili ishte “i dërguar si mëshirë për botët”, pa u kapluar nga këndvështrimet, praktikrat dhe frymëzimet e të tjerëve të cilat janë të lidhura ngushtë me interesat e kësaj bote. Këtu mendoj se është e dobishme, nga aspekti i “bashkimit të umetit”, që t'i kujtojmë dhe t'i ndajmë disa cilësi dhe domosdoshmëri themelore të kësaj kornize qoftë edhe duke u përmbledhur.

TEVHIDI DHE ISTIKAMETI

Ebu Amr Sufjan ibn Abdullah eth-Thekafiu (r.a.), i cili ka transmetuar vetëm pesë hadithe nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: “Të Dërguarit të Allahut i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Ma shpjego Islam. Në atë mënyrë sa që të mos kem nevojë të pyes (sipas transmetimit të Ebu Usames, “askënd tjetër përveç teje”) për të pas teje!” I Dërguari i Allahut (a.s.), më tha: “*Thuaj i besova Allahut dhe (pas kësaj) ji i drejtë!*” (Muslim, Iman 62; Nesai, es-Sunenu'l-kebir, VI, 458; Ibn Hibban, Sahih, III, 221; Taberani, el-Mu'xhemu'l-kebir, VIII, 69.)

Hadithet fisnike që e përkufizojnë dhe e shpjegojnë nga këndvështrime të ndryshme Islam, besimin, fenë dhe fetarinë gjenden në kapitujt e besimit të librave të haditheve dhe në librat që flasin rreth besimit. Ndërmjet atyre haditheve është pikërisht ky hadith që e nxjerr në pah Islam në një formë të përmbledhur dhe pothuajse si një formulë matematikore: Tevhid + istikamet = Islam.

Kur tevhidi dhe istikameti bëhen dy faktorët themelorë në shpjegimin dhe përkufizimin e fesë islame, do të thotë se istikameti duhet të mbështetet në një besim, në tevhidin e pastër, sepse, te çdo njeri që s'ka në bazë besimin e tevhidit, nuk mund të bëhet fjalë për istikamet / drejtësi, qëndrueshmëri etj. Por menjëherë le ta themi edhe këtë: Asnjëherë nuk mund të thuhet se të gjithë ata që kanë besimin e tevhidit, patjetër kanë një jetë të ndershme e të drejtë. Në fakt, si parim besimi i vërtetë kërkon ndershmëri, por praktikrat që kanë lidhje me ndryshimin në pjekuri dhe cilësi të besimit, mund të mos japin të njëjtin rezultat për çdo besimtar. Atëherë mund të themi se besimi i tevhidit është kushti primar i istikametit, por istikameti nuk është domosdoshmërisht rezultat i tevhidit. Krahas kësaj, padyshim se pjekuria (përsosmëria) arrihet duke bashkuar tevhidin me istikametin.

Fjala e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, aq sa është një shembull i cilësisë së tij për të shprehur kuptime të thella me pak fjalë (xhevamiu'l-kelime), në të njëjtën kohë është edhe një përgjigje që e nxjerr në pah esencën e detyrës së profecisë dhe fesë (me gjithë kuptimin e plotë të saj) që e ka sjellë, apo me një shprehje të vjetër, është një përgjigje lubbu'l-lub ose hulasatu'l-hulasa. Ndërsa në Sahihun e Muslimit ky hadith është dhënë nën titullin “Xhamiu evsafi'l-Islam / esenca e cilësive të Islamit”. (Shik. Muslim, Iman 13.)

NDERSHMËRIA

Ebu Hurejre (v. 58), radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “*Feja është ndershmëri.*” Atë e pyetën: “Kundrejt kujt, o i Dërguari i Allahut?” Ai iu përgjigj: “*Kundrejt Allahut, të Dërguarit të Tij, Librit të Tij, udhëheqësve të myslimanëve dhe të gjithë myslimanëve.*” (Nesai, Bej'at 31,41; Darimi, Rikak 41. Për transmetimin e Temim ed-Darit për të njëjtin hadith shik. Muslim, Iman 95; Ebu Davud, Edeb 59; Tirmidhi, Birr 17; Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 102,103. Ndërsa për transmetimin si Muallak shik. Buhari, Iman 42.)

Fjala “nasihat”, e cila përmendet në hadithin fisnik dhe që në shumicën e rasteve përkthehet “feja është këshillë / feja është porosi”, nuk do të thotë vetëm këshillë apo porosi. Fjala nus'h që do të thotë nxjerrje e mjalit nga hojet, në të njëjtën kohë do të thotë edhe

Për të pasur një fetari ideale, duhet të bëjmë një jetë sipas urdhrave dhe ndalesave të Allahut Teala, i Cili na e ka falur jetën dhe sipas traditës së rob-it shembullor, të Dërguarit të fundit, Muhamedit (a.s.)



fjalë apo vepër e pastër nga dredhia dhe mashtrimi. Nisur nga kjo, feja është sinqeritet, ndershmëri dhe mirësi. Përveç të tjerash, në këtë kuptim është përdorur edhe në këtë ajet fisnik: **“Nuk është gjynah të mos shkojnë në luftë të dobët, as të sëmurët, as ata që nuk mund të sigurojnë shpenzimet, nëse janë të sinqertë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Nuk ka vend për vërejtje ndaj punëmirëve. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”** (Teube, 91)

Nisur nga kjo, hadithin fisnik mund ta përkthejmë edhe në kuptimin “feja është ndershmëri”. Faktikisht kuptimi “feja është ndershmëri” përputhet plotësisht me vazhdimin e hadithit.

Ndershmëri kundrejt Allahut do të thotë që të kesh një besim të saktë ndaj njëshmërisë së Allahut Teala, të kesh një nijet të sinqertë në adhurim kundrejt Tij dhe të jesh i ndershëm në kryerjen e urdhrave dhe në largimin nga ndalesat e Zotit (xh.xh.).

Ndershmëri kundrejt të Dërguarit të Allahut (a.s.), do të thotë që ta pranosh profecinë dhe dispozitat që ka sjellë ai, t’i bindesh atij me sinqeritet duke u sjellë me ndershmëri në çështjet që ka urdhëruar a ndaluar, të kapesh fort pas traditës profetike dhe të përpiqesh ta zbatosh e ta përhapësh atë.

Ndershmëri kundrejt Librit do të thotë që të besosh se ai është Libri i Allahut të Lartësuar dhe të punosh me dispozitat që ka brenda sipas mundësisë. Gjithashtu, do të thotë që të mos i refuzosh ajetet apo të pranosh vetëm disa prej tyre. Domethënë, të sillesh me ndershmëri kundrejt Librit.

Ndershmëri kundrejt udhëheqësve të myslimanëve do të thotë t’u bindesh atyre në çështje që janë të vërteta dhe të drejta, t’ua kujtosh atyre të vërtetën në formën e duhur kur të jetë e nevojshme dhe të mos bësh kryengritje pa shkak ndaj tyre. Domethënë, të sillesh me ndershmëri kundrejt udhëheqësve të drejtë.

Ndershmëri kundrejt myslimanëve do të thotë që t’u tregosh dhe t’u mësosh atyre gjëra që janë të dobishme për fenë dhe jetën e tyre, t’i urdhërosh për të mirë dhe t’i ndalosh nga e keqja, të dëshirosh edhe për ata atë që dëshiron për veten tënde, të kesh mendime të sinqerta për mirësi ndaj tyre dhe t’i praktikosh ato. Sigurisht se njeriu mund të bëhet nasihun emin / këshillues besnik që përmendet në Kuranin Fisnik vetëm duke i pasur këto cilësi. Pejgamberët në këtë kontekst kanë qenë nga një nasihun emin.

Siç kuptohet edhe nga këto shpjegime të shkurtra, fe dhe fetari do të thonë që njeriu të bëjë mirësi nga zemra, me gjithë shpirt, në një mënyrë të sinqertë dhe të ndershme ndaj mjedisëve në të cilat gjendet qoftë në aspektin e besimit apo qoftë në aspektin social.

Në qasjen e Islamit rruga që të shpie te Allahu është “siratul-mustekim”, domethënë, rruga e drejtë. Për këtë arsye, edhe cilësia më e rëndësishme pas besimit e udhëtarit të kësaj rruge është ndershmëria. Ndershmëria e myslimanit nuk ka kufi. Ai është i obliguar që të thotë të vërtetën, të jetë i drejtë edhe nëse kjo është kundër tij. Ajeti fisnik: **“Thuaj (o Muhamed!): “Në të vërtetë, unë jam vetëm një njeri si ju. Mua më është shpallur që Zoti juaj është një Zot i Vetëm, andaj ecni në rrugën e drejtë që të çon tek Ai dhe kërkoni falje prej Tij! Mjerë ata të cilët i shoqërojnë Atij zota të tjerë.”** (Fussilet, 6), është një thirrje për ndershmëri që u drejtohet të gjithëve. Ndërsa rezultati i natyrshëm i kësaj thirrjeje është se ata që largohen nga zbatimi i urdhrave me zemër, me fjalë dhe me vepër apo ata që bëjnë ndonjëherë prej gjërave të ndaluara, domethënë, ata që kanë mangësi në fetari mund të largohen nga rruga e drejtë. Zgjidhja e këtij problemi është të penduarit dhe të rikthyerit me ndershmëri te istikameti / orientimi Islam duke kërkuar falje për mangësitë.

ADHURIMI

Të dërguarit e fisit Thakif i kërkuan të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, që të mos prekej idhulli i tyre Lati ose të paktën të mos u kërkonte që ta thyenin me duart e tyre dhe t’i lejonte që të mos falnin namaz. Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), u tha:

“Përsa u përket idhujve, ju lejoi që të mos i thyeni me duart tuaja, por përsa i përket namazit, e vërteta është kjo se, nuk ka mirësi në një fe që nuk ka namaz (nuk mund t’ua lejoi këtë).” (Ibn Hisham, Sijre, II, 538.)

Kjo ngjarje dhe kjo deklaratë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), siç tregon se nuk ka mirësi në një fe që nuk ka namaz e lutje, gjithashtu tregon edhe se nuk ka mirësi në një fetari të zhveshur nga ibadetet dhe adhurimi. Për këtë arsye, ata që kanë mangësi në çështjen e ibadeteve, nuk kanë ndonjë gjë për t’u marrë në konsideratë. Puna që duhet bërë është kryerja e urdhrave fetare sa të jetë e mundur dhe largimi nga të ndaluarat në formë absolute. Kjo është masa e fetarisë për të cilën na ka njoftuar i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam.

Në përgjigjen që i Dërguari i Allahut (a.s.), u ka dhënë të dërguarve të fisit Thakif, shprehet qartazi se nuk ka vend për idhuj në shtetin e tevhidit dhe se nuk mund të bëhet fjalë për lejim apo për të drejta të veçanta ndaj asnjë individi apo grupi në çështjen e urdhrave fetare. Atëherë, kjo do të thotë se fetaria e vërtetë arrihet duke i përvetësuar të gjitha virtytet së bashku si tevhidin, istikametin, ndershmërinë e adhurimin dhe duke i reflektuar ato në vepra.

Të mbrosh të dhunuarit

A tij që bën zullum
dhe padrejtësi i thonë i padrejtë,
ndërsa atij që i bëhet zullumi
dhe padrejtësia i thonë i dhunuar.
Thelbësore është që të mos jemi as
prej të padrejtëve dhe as
prej të dhunuarve.

Ali Riza Temel

Atij që bën zullum dhe padrejtësi i thonë i padrejtë, ndërsa atij që i bëhet zullumi dhe padrejtësia i thonë i dhunuar. Thelbësore është që të mos jemi as prej të padrejtëve dhe as prej të dhunuarve. Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik për besimtarët: **“... Nuk i bëni padrejtësi askujt dhe as nuk pranoni t’ju bëhet padrejtësi juve vetë.”** (Bekare, 279)

Allahu i Madhëruar nuk bën aspak padrejtësi, si rezultat, atë ua ka ndaluar edhe robërve të Tij. Për këtë arsye, në ajetet fisnike thuhet: **“Vërtet, Allahu nuk i bën padrejtësi askujt as sa një grimcë, por, nëse (dikush) bën mirësi, Allahu ia shumëfishon atë dhe i jep shpërblim të madh.”** (Nisa, 40) Allahu Teala i ndëshkon ashpër ata që bëjnë padrejtësi: **“...Sigurisht, të padrejtët do ta shohin se në çfarë mundimi do të kthehen (pas vdekjes).”** (Shuara, 227)

Edhe peygamberët kanë luftuar për t’i mbrojtur të dhunuarit kundrejt të padrejtëve. Dikush prej tyre është vrarë dhe dikush tjetër është syrgjynosur. Të gjithë peygamberët janë luftuar në forma të ndryshme.

Të mbrosh të dhunuarit do të thotë të mbrosh të vërtetën dhe ata që janë në të drejtë. Ndërsa mbështetja e të padrejtit do të thotë bashkëpunim në padrejtësi. Allahu Teala thotë: **“Dhe mos anoni nga ata që bëjnë të këqija, përndryshe do t’ju përcëlojë Zjarri. Ju nuk do të keni mbrojtës tjetër përveç Allahut dhe nuk do të ndihmoheni.”** (Hud, 113) Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), shprehet kështu në lidhje me këtë çështje: **“Kushdo që bashkëpunon me të padrejtin për ta ndihmuar duke e ditur se është i padrejtë, ka dalë jashtë Islamit.”** (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir,

2/155.) Mbrojtja e të dhunuarit është virtyt. Si rezultat, shenja dalluese e myslimanit është mbrojtja e të dhunuarve.

I Dërguari i Allahut (a.s.), para se t'i vinte profesia, ka qenë anëtar i aleancës Hilfu'l-Fudul, e cila u formua për të mbrojtur të drejtat e të dhunuarve. Historiku i formimit të kësaj aleance shkurtimisht është kështu: Një burrë prej fisit Zebit, shkoi në Mekë për të shitur mallin e tij. As ibn Vail, i cili ishte prej të parëve të Mekës, ia mori mallin atij, por nuk i dha pagesën. Personi që iu bë padrejtësi ishte aleat me Abdu'd-darin. Abdu'd-dari thirri në ndihmë fiset Mahzum dhe Xhunah, por ata nuk pranuan ta ndihmonin. Mbi të gjitha, e qortuan atë. I gjendur në këtë situatë, në kohën e mëngjesit kur mekasit ishin në shtëpitë e tyre pranë Qabesë, ai doli mbi kodrën Ebu Kubejs dhe tha me zë të lartë:

“O Beni Fihri! Ndhimoheni të dhunuarin që i është bërë padrejtësi në luginën e Mekës, i cili gjendet larg shtëpisë dhe miqve të tij! Ky njeri është me ihram, i raskapitur dhe akoma nuk e ka mbaruar umren. O ju që gjendeni ndërmjet Hixhrit dhe Haxherit! Më ndihmoni! Kjo Qabe u përket njerëzve që kanë moral të lartë, jo atyre që veshin petkun e të padrejtësisë dhe zullumqarit.” Kur Zubejr ibn Abdu'l-Muttalibi e dëgjoi këtë zë, doli në mejdan dhe tha: “Kjo nuk është një situatë që mund të lihet pa u zgjidhur.” Nisur nga kjo, Beni Hashim, Zuhre dhe Tejm u mblodhën në shtëpinë e Abdullah ibn Xhudan-it. Abdullahu u përgatiti ushqim atyre. Ata arritën të bënin marrëveshje ndërmjet tyre. Nisur nga marrëveshja që bënë, ata do t'i mbronin të dhunuarit dhe do të gjendeshin pranë të varfërve derisa të kishte qoftë edhe një pikë ujë në det dhe derisa të gjendeshin në vendin e tyre mali Sebir dhe Hira. Së fundi, shkuan të As ibn Vaili, e morën të drejtën e të dhunuarit dhe ia dorëzuan këtij të fundit. Kjo aleancë që u formua për të mbrojtur të drejtat e të dhunuarve u quajt “Aleanca e të virtytshmeve”. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), tregoi për këtë aleancë, u shpreh: “Unë dëshmoja një aleancë që u formua në shtëpinë e Abdullah ibn Xhudanit. Nëse ftohem përsëri te e njëjta aleancë edhe tani që jam Pejgamber, do të merrja pjesë me gjithë dëshirë, sepse ata patën bërë marrëveshje për t'ua kthyer të zotëve mallrat që u janë uzurpuar dhe për të mos e lejuar të padrejtin që ta shtypë të dobëtin.” (Salih, subulu'l-huda, 2/154.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), përgjatë gjithë jetës së

tij i ka mbrojtur të dhunuarit dhe të dobëtit. Edhe kalifët e drejtë që ndoqën rrugën e tij, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim. Për shembull, kur Ebu Bekri (r.a.), u zgjodh kalif, në fjalimin që mbajti u shpreh se për të i dobëti do të jetë në pozitën e të fortit dhe se i forti do të jetë në pozitën e të dobëtit.

E gjithë çështja është që fuqia të përdoret me drejtësi apo me një shprehje tjetër, për të mbrojtur të drejtët dhe për t'u dhënë atë që meritojnë të padrejtëve. Për fat të keq, njerëzit në përgjithësi mbajnë anën e të fuqishmëve duke mos e marrë parasysh nëse janë të drejtë apo të padrejtë. Për shkak të këtij qëndrimi dhe këndvështrimi, padrejtësia dhe zullumi vazhdojnë të ekzistojnë. Sidoqoftë, e ardhura e atyre që e mbështesin padrejtësinë është mjaft e tmerrshme, sepse Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: “**...Vërtet, keqbërësit nuk do të shpëtojnë.**” (En'am, 21)

Ne duhet të përpiqemi që të marrim lutjen e të dhunuarit dhe të kemi kujdes nga mallkimi i tij, sepse i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Kini kujdes nga mallkimi i të dhunuarit edhe nëse është jobsimtar, sepse ndërmjet Allahut dhe mallkimit nuk ka ndonjë perde që ta pengojë pranimin e tij.” (Axhluni, Keshfu'l-Hafa, hadithi nr: 75.) Edhe pse mallkimi në përgjithësi konsiderohet si diçka jo e mirë, të dhunuarve u është lejuar që të mallkojnë. Në Kuranin Fisnik thuhet: “**Allahu nuk do që të thuhet hapur fjalë të këqija, përveçse nga të dëmtuarit (dhunuarit). Allahu dëgjon dhe di gjithçka.**” (Nisa, 148) Një njeri që është dhunuar dhe që i është nëpërkëmbur e drejta e tij, mund të bërtasë, mund ta mallkojë me të madhe atë që i ka bërë padrejtësi, mund t'ia thotë në fytyrë të këqijat që ia ka bërë, madje, mund t'u përgjigjet fjalëve të këqija të atij me të njëjtën mënyrë. Allahu Teala e di gjendjen dhe e dëgjon klithmën e atyre që u bëhet padrejtësi. (H. Jazër, Hak Dini, 3/111.)

Ankesa e të dhunuarve arrin menjëherë te Allahu Teala. Ajeti i parë i sures Muxhadile është një argument i qartë për këtë: “**Allahu i ka dëgjuar fjalët e asaj që diskutoi me ty për burrin e vet dhe iu ankua Atij. Allahu e dëgjoi bisedën tuaj, sepse Ai dëgjon dhe sheh gjithçka.**” Muxhadile, 1) Shkaku i zbritjes së këtij ajeti shkurtimisht është kështu: Havle binti Tha'lebe ishte bashkëshortja e Evs ibn Samitit, i cili ishte prej ensarëve. Një ditë Havle i kishte parashtruar një kër-

I padrejti është një njeri që i bën padrejtësi vetes nëpërmjet atij që e dhunon. Sa më shumë që ta shtojë padrejtësinë, aq më shumë e thëllon pusin në të cilin do të bjerë. Faraoni, Nemrudi, Neroni, Sheddadi, Ebu Xhehli, Ebu Lehebi dhe të gjithë ata që u ngajjnë këtyre janë mallkuar për shkak të padrejtësive që kanë bërë. Padrejtësia është një krim i tmerrshëm që i bën vepruesit e saj të mallkohen deri në Ditën e Kiametit.

kesë bashkëshortit të saj. Bashkëshorti i Havles ishte nxehur dhe i kishte thënë:

“Ti për mua je si shpina e nënës sime.” Si pasojë, ndodhi dhihari.¹ Në periudhën e xhahilijetit (para se të shpallej Islami), bashkëshortja ishte haram për ata që e thoshin këtë fjalë. Si rezultat, nuk mund ta merrte kurrë më atë. Evsu u bë pishman për atë që tha dhe deshi ta merrte përsëri bashkëshorten e tij, por Havle nuk pranoi dhe shkoi t’i ankohej të Dërguarit të Allahut (a.s.), për këtë gjendje. Atij i tha: “O i Dërguari i Allahut! Kur Evsu më zgjodhi për bashkëshorte, isha e re dhe tërheqëse. Por pasi kanë kaluar shumë vite dhe kam bërë shumë fëmijë, Evsu më tha se isha si nëna e tij për të (bëri dhihar) dhe më la të vetme. Andaj gjej një zgjidhje për këtë situatë. I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk i tha gjë asaj. Nisur nga kjo, ajo ia shfaq gjendjen Allahut duke u shprehur: “O Zot! Po të ankohej Ty nga tmerri i vetmisë dhe nga dhimbja e ndarjes që do të jetë shumë e vështirë për mua. Unë i kam fëmijët e vegjël. Nëse ata ia lë Evsit, ai do t’i çojë dëm. Nëse i marr me vete, do të ngelin të uritur.” Pastaj e ngriti kokën drejt qiellit dhe përsëri iu përgjërua Allahut: “O Zot! Ty po të ankohej. Andaj, të përgjërohem që t’ia zbresësh shpalljen të Dërguarit Tënd!” Menjëherë pas kësaj zbriti ajeti fisnik. I Dërguari i Allahut (a.s.), e përgëzoi atë dhe i lexoi ajetin që kishte zbritur: **“Allahu i ka dëgjuar fjalët e asaj që diskutoi me ty për burrin e vet dhe iu ankua Atij. Allahu e dëgjoji bisedën tuaj, sepse Ai dëgjon dhe sheh gjithçka.”**

Kur Havle shkante te Umeri (r.a.), ai e nderonte atë. Një ditë kur Umeri (r.a.), po ecte bashkë me disa njerëz, Havle i kërkoi Umerit që të ndalej. Umeri (r.a.), u ndal, iu afrua asaj, ia vendosi dorën në sup dhe e dëgjoji me vëmendje. Pasi Havle i mbaroi fjalët e saj, disa prej të cilave ishin të ashpra, njëri prej atyre që ndodheshin pranë Umerit (r.a.), tha: “O udhëheqësi i besimtarëve! Ti i bërë burrat e kurejshve që të presin për atë grua të moshuar.” Umeri (r.a.), i tha: “Turp të kesh! A nuk e di ti se kush është ajo?” Ai iu përgjigj: “Jo, nuk e di.” Umeri (r.a.), ia ktheu: “Kjo është

ajo grua që Allahu Teala ia ka dëgjuar ankesën. Kjo është Havle binti Tha’lebe. Për Zotin, sikur të mos ishte deri në mbrëmje, nuk do të largohesha prej saj derisa t’ia plotësoja nevojën që kishte.”

Ata që janë dhunuar, qoftë edhe vonë, Allahu Teala i mbron dhe i ndihmon. Shembulli më i qartë i kësaj janë myslimanët, të cilët u dhunuan barbarisht nga politeistët në Mekë, u detyruan të largoheshin nga vendi i tyre dhe të migronin në vende të largëta. Allahu i Madhëruar thotë për ta: **“Ata që, pasi vuajtën të shtypur, u shpërngulën për hir të Allahut, Ne do t’i vendosim në vendbanime të mira në këtë botë. Natyrisht, shpërblimi që i pret në botën tjetër (Xheneti), është edhe më i madh. Ah! Sikur ta dinin ata!”** (Nahl, 41) Ata që ngelën të detyruar të shpërnguleshin drejt Abisinisë prej burrave dhe grave besimtare, fituan këtë premtim hyjnor. Më së fundi u vendosën në Medine, arritën mirëqenien, fituan kundrejt armiqve të tyre, arritën të bënin çlirime të reja, gjithmonë u përkujtuan me mirësi dhe fituan pëlqimin e kënaqësinë e Allahut të Lartësuar.

Në këtë botë padrejtësia ka ekzistuar gjithmonë. Dikush është sprovuar me fuqi e pasuri dhe dikush tjetër është sprovuar me varfëri e dobësi. Sigurisht se rezultatet e këtyre sprovave do të vlerësohen dhe të gjithë do ta marrin atë që meritojnë në këtë botë, ose në botën tjetër ose në të dyja botët. Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Mos mendo kurrësi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin), dhe, duke vrapuar me kokë lart, nuk do të mund t’i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta** (nga tmerri).” (Ibrahim, 42-43)

I padrejti është një njeri që i bën padrejtësi vetes nëpërmjet atij që e dhunon. Sa më shumë që ta shtojë padrejtësinë, aq më shumë e thëllon pusin në të cilin do të bjerë. Si rezultat, vjen një ditë dhe nuk mund të dalë më nga padrejtësitë në të cilat është zhytur. Faraoni, Nemrudi, Neroni, Sheddadi, Ebu Xhehli, Ebu Lehebi dhe të gjithë ata që u ngjajnë këtyre janë mallkuar për shkak të padrejtësive që kanë bërë. Padrejtësia është një krim i tmerrshëm që i bën vepruesit e saj të mallkohen deri në Ditën e Kiametit. Sikundër kësaj, të dhunuarit si Bilali, Ammari dhe Habbab ibn Ereti përkujtohen me mëshirë dhe mirësi. Të gjithë le ta bëjnë zgjedhjen e tyre duke u nisur nga dëshira se me kë duan të jenë dhe se si duan të kujtohen. Në këtë mënyrë, të vendosin nëse duan të bashkohen me të padrejtët e të kujtohen me mallkime ose të bashkohen me të dhunuarit dhe të kujtohen me mëshirë dhe mirësi.

1. Dhihar do të thotë: T’i thuash gruas se ti je sikurse nëna ime. Meqë me nënën nuk lejohet të kesh marrëdhënie atëherë, edhe gruaja, bazuar nga fjalët e shprehura, merr status të atillë. Nëse robi bëhet pishman nga kjo që ka thënë, atëherë patjetër duhet të lirojë një rob ose të veprojë siç thuhet në ajetet 3-4 të sures Muxhadile në të cilat Allahu Teala shpreh: “Ata që i ndajnë gratë e veta në këtë mënyrë e pastaj duan të kthejnë mbrapsht atë që thanë, duhet të lirojnë një skllav (apo skllave), para se të preken përsëri. Kështu ju urdhërohet. Allahu i di të gjitha ato që bëni ju. Ai që nuk gjen (ndonjë skllav për të liruar), duhet që të agjërojë dy muaj rresht, para se të preken si bashkëshortë. E, nëse nuk mund ta mbajë agjërimin, atëherë duhet të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo, që të tregoni besimin në Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Këta janë kufijtë e Allahut. Ndërsa për jobesimtarët ka vuajtje të mundimshme.”



Xhafer Durmush

Punë e mirë
Gjynah
Gënjeshërë
Durim



Ata që i do dhe ata që nuk i do Allahu

Sot po lexoja ajetin fisnik të 134-t dhe 135-të të sures Ali Imran. Aty thuhet: **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”**

Fjalja e fundit e këtyre ajeteve të bekuara sikur mori jetë sërish në zemrën time. Nganjëherë them se duhet t'i vendos para meje të gjithë ata që i do dhe ata që nuk i do Allahu i Lartësuar. Por ja që shoh se Allahu Teala na ka njoftuar për ata që i do e me të cilët është i kënaqur dhe për ata që nuk i do e me të cilët është i zemëruar. Gjithashtu na ka treguar rrugën, e cila na shpie te kënaqësia e Tij dhe na ka paralajmëruar që të kemi kujdes prej zemërimit të Tij.

Në ajete të ndryshme thuhet: **“Allahu i do ata (që pendohen dhe) që pastrohen shpesh.”** (Teube, 108) **“...Me të vërtetë, Allahu i do ata që i frikësohen (Atij).”** (Teube, 4) **“Allahu i do të duruarit.”** (Ali Imran, 146) **“Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.”** (Ali Imran, 159) **“Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi.”** (Huxhurat, 9)

Kuptimi i ajeteve fisnike që na njoftojnë për robërit prej të cilëve Allahu Teala është i kënaqur është kështu: Allahu thotë: **“Kjo është Dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre. Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të**

qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë...” (Maide, 119)

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim...” (Teube, 100)

“Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira – pikërisht ata janë krijesat më të mira. Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë...” (Bejjine, 7-8)

Me të vërtetë, kur t'i shohim cilësitë e atyre që “Zoti (xh.xh.), i do dhe është i kënaqur prej tyre”, vëmë re se janë cilësi dhe attribute që domosdoshmërisht duhet të gjenden te myslimani. Domethënë, shohim moralin hyjnor dhe moralin e peygamberëve për të cilët thuhet: “Ishin prej muhsinëve”, “evvahun halim” dhe “sa rob i mirë që ishte ai”. Si përmbledhje e të gjitha këtyre që thamë më lart, shohim virtytet që Usvetu Hasene, domethënë, i Dërguari i Allahut (a.s.), i ka thurur një nga një. Peygamberi (a.s.), ka thënë: **“Allahu Teala e do robin e Tij që është i devotshëm, që e ka zemrën e pastër dhe që merret me punët e tij.”** (Muslim, Zuhd, 11.) Edhe Eshexhit (r.a.), i cili ishte prej Beni Abdulkajisit, i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut goftë mbi të, i ka thënë: **“Ti ke dy cilësi që Allahu i do: Butësinë dhe largpamësinë.”** (Muslim, Iman 25, 26.) Të dyja këto hadithe fisnike

shprehin të vërtetat kuranore që thamë më lart.

Ndërsa ajetet fisnike, në të cilat Allahu i Lartësuar na njofton për ata që nuk i do dhe që është i zemëruar prej tyre, mund t'i radhisim në këtë mënyrë:

“Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburraveçë.” (Nisa, 36) **“Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin.”** (Bekare, 190) **“Allahu nuk e do shkatërrimin.”** (Bekare, 204-205) **“Allahu nuk i do ata që janë mohues - gjynahqarë.”** (Bekare, 276) **“Allahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët.”** (Ali Imran, 32) **“Allahu nuk i do punëmbropshtët.”** (Ali Imran, 57) **“Allahu nuk do që të thuhet hapur falë të këqija, përveçse nga të dëmtuarit.”** (Nisa, 148) **“Allahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin.”** (Maide, 87) **“Allahu nuk i do ata që e teprojnë!”** (En'am, 141) **“Allahu nuk i do tradhtarët mohues.”** (Haxh, 38) **“Allahu nuk i do ata që ngazëlleen!”** (Kasas, 76)

“Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. Allahu është zemëruar me atë...” (Nisa, 93) **“Për t'i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtare, që mendojnë keq për Allahun. Allahu është zemëruar me ata..!”** (Fet'h, 6) **“A nuk i sheh ata (hipokritët) që shoqërohen me njerëz, me të cilët Allahu është i zemëruar?”** (Muxhadile, 14)

“Kushdo që mohon Allahun, pas pranimit të besimit, (do të dënohet ashpër), do të ketë mbi vete zemërimin e Allahut dhe një dënim të madh.” (Nahl, 106)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në lidhje me këtë çështje: **“Allahu Teala nuk do të flasë me tre vetë në Ditën e Kiametit, nuk do t'ua falë mëkatet dhe nuk do t'i shikojë as në fytyrë. Mbi të gjitha, ata do të kenë një ndëshkim të tmerrshëm. Ata janë: i moshuari që bën imoralitet, udhëheqësi që gënjen dhe i varfri mendjemadh.”** (Muslim, Iman, 172.)

Ja, këto janë gjendjet dhe sjelljet e fatkeqëve, të cilët do të përfundojnë me humbje të përhershme si Faraoni, Karuni dhe Hamani. Andaj duhet të kemi kujdes që të mos u qëndrojmë pranë dhe të mos u ngajmë atyre. Ndërsa për çështjet që nuk janë përmendur këtu, duhet t'i shtjellojmë duke i krahasuar me të tjerat dhe duke pyetur ata që kanë dije të mjaftueshme rreth tyre. Përfundimisht, këto specifika duhet t'i përditësojmë në pjesë kohore të caktuara dhe ta llogarisim vazhdimisht gjendjen tonë shpirtërore.

Këtë material dëshirojmë ta përfundojmë me një lutje: **“O Zot! Na bëj t'i duam ata që do Ti! Na bëj të mos i duam ata që nuk i do Ti! Na i bëj të dashur evliatë e Tu! Amin!”**

Lexo Mendo

SINQERITETI NË LUTJE


Shumë ajete fisnike na inkurajojnë që të bëhemi prej besimtarëve që e meritojnë Xhenetin. Nisur nga kjo, në suren Ali Imran thuhet: **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit.”** (Ali Imran, 133) Ndërsa në suren Muhamed përshkruhen kështu mirësitë e Xhenetit që u është premtuar të devotshmëve: **“Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar...”** (Muhamed, 15)

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, na ka njoftuar në lidhje me mirësitë e Xhenetit: **“Allahu Teala ka thënë: “Unë kam përgatitur për robërit e Mi mirësi që asnjë sy nuk i ka parë, asnjë vesh nuk i ka dëgjuar dhe asnjë njeri nuk i ka imagjinuar.”** Ebu Hurejre (r.a.), i cili e ka transmetuar këtë hadith, më vonë tha: **“Nëse**

dëshironi mund të lexoni ajetin në të cilin thuhet: **“Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”** (Sexhde, 17)

Imam Gazaliu, (r.a.), thotë: **“Po të frikësohej njeriu nga Xhehenemi siç frikësohet nga varfëria, do të shpëtonte nga të dyja. Gjithashtu, po ta dëshironte Xhenetin siç do pasurinë, do t'i fitonte që të dyja. Nëse do të frikësohej nga Allahu Teala në botën e tij shpirtërore siç heziton nga njerëzit në pamjen e jashtme dhe në sjelljet e tij, do të ishte i lumtur edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.”**

Domethënë se njeriu duhet të jetë i vetë-dijshëm për atë që do dhe atë që nuk do. Përveç të tjerash, duhet të jetë i sinqertë në lutjen dhe kërkesën e tij. Ai duhet t'i aprovojë me zemër dhe t'i vërtetojë me vepra ato që shpreh me gjuhë.





EDUKIMI SHPIRTËROR NË EPOKËN E LUMTURISË

Adem Sarac

Islami e edukon dhe e formon njeriun e tij me rregullat e veta. Njeriu që edukohet dhe formohet sipas rregullave të Islamit quhet mysliman apo njeri i Islamit. Në të vërtetë, çdo besim, çdo sistem dhe çdo institucion e edukon dhe formon njeriun e tij sipas rregullave të veta. Njeriu bëhet individ i përkushtuar ndaj atij sistemi me rregullat e të cilit është formuar. Formimi i personalitetit të njeriut bëhet në raport me edukimin që i jepet. Ndërsa esenca e edukimit të personalitetit është edukimi shpirtëror.

Edukimi shpirtëror është aq i rëndësishëm, saqë Islami e ka theksuar këtë specifikë që me ardhjen e shpalljes së parë. Ndërsa çelësi i edukimit është leximi. Leximi është urdhri i parë i Islamit për ne.

Çështja më kryesore që nuk duhet ta neglizhojmë është vazhdimësia e ajetit fisnik në të cilin thuhet: **“Lexo me emrin e Zotit tënd!..”** Ai që na njeh ne më mirë, padyshim se është Ai që na ka krijuar. Allahu është Ai që na njeh më mirë. Ndoshta për këtë arsye është theksuar veçanërisht dimensionin “Krijues”. Këtu kërkohet qartë që robi vazhdimisht të jetë me Zotin e tij. Gjithashtu urdhërohet që robi vazhdimisht ta mbajë aktive lidhjen me Allahun e Madhëruar. Kjo lidhje shpirtërore arrihet vetëm me edukimin shpirtëror. Kjo në tasavvuf/mistikën islame quhet “lidhje e vazhdueshme me Zotin (xh. xh.)”.

Urdhri i Allahut Teala duhet ta kuptojmë drejt dhe saktë. Ne jemi të obliguar që ta kuptojmë mirë

thirrjen e të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam dhe të jetojmë sipas dispozitave të asaj thirrjeje. Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.), po e ftojnë në shpëtim një shoqëri që ka degraduar aq shumë sa ka arritur në pikën e shkatërrimit. Së pari thirrja bëhet për te besimi i tevhidit, në mënyrë që të pastrohen dhe të dëliren. Besimi është pastrim, dëlirësi dhe shpëtim. Besimi është pastrim nga të gjitha papastërtitë me në krye shirkun.

Islami është dorëzim dhe nënshtrim ndaj Allahut Teala. Ndërsa mysliman do të thotë njeri që i është dorëzuar dhe nënshtruar plotësisht Zotit (xh.sh.). Gjëja më kryesore është nënshtrimi ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Nënshtrimi është çështje themelore në edukimin shpirtëror siç është edhe burimi i çdo lloj mirësie dhe pastrimi.

Prej nesh kërkohet që ta mbajmë veten larg të këqijave etike dhe ta pajisim atë me moralin më të lartë. Andaj, ne duhet ta pastrojmë botën tonë të brendshme nga shirku dhe kufri. Gjithashtu duhet ta pastrojmë edhe nga mashtrimi, hipokrizia, përgojimi dhe thashethemet. Kjo është çështja themelore e edukimit shpirtëror.

“Ngrihu natën!” – thotë Allahu i Lartësuar. Ngrihu në këmbë për një detyrë të madhe që të pret dhe për të marrë mbi supe një barrë të madhe që është përgatitur për ty! Ngrihu në këmbë për të punuar, për t’u lodhur, për të vuajtur dhe për t’u përballur me vështirësi! Ngrihu dhe përgatitu për këtë detyrë madhështore e të shenjtë dhe merr edukimin që të duhet për ta kryer atë! Esenca e këtij edukimi është të ngriturit natën, sepse ai që nuk e gjallëron natën me ibadete, nuk mund të ketë një ditë të dobishme!

Njëra prej mangësive që përjetojmë përgjatë ditës buron nga ibadetet e pakta që bëjmë përgjatë natës. Allahu i Madhëruar, me këtë urdhër, i tregon të Dërguarit të Tij (a.s.), rrugën për të arritur suksesin në përpjekjen dhe luftën që do të bëjë. Në këtë mënyrë, Allahu Teala kërkon nga ai që ta madhërojë (Atë) natën dhe të forcohet. Ja, edhe kjo gjendet në edukimin shpirtëror.

Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, i thërriste njerëzit për në Islam, nuk mjaftohej vetëm duke u dhënë dijen bashkë me besimin, por u jepte këto katër gjëra që janë: Besimi, dija, vepra dhe sinqeriteti/devotshmëria.

Çdo njeri paraprakisht është i obliguar që ta pra-

nojë besimin. Njeriu bëhet mysliman për shkak të besimit. Mysliman është ai njeri që e di se kujt dhe si duhet t’i besojë. Kjo është dija e besimtarit. Myslmani patjetër duhet ta reflektojë në jetë atë që beson dhe që ka mësuar. Domethënë, duhet të bëjë një jetë sipas parimeve të besimit që ka përvetësuar dhe mësuar. Ndërkohë kjo quhet vepra e myslimanit. Besimtari mysliman duhet të besojë, të mësojë dhe t’i bëjë veprat e tij me sinqeritet. Domethënë se çdo mysliman në të njëjtën kohë është një njeri i devotshëm dhe i zgjedhur. Ja, edhe kjo arrihet vetëm me edukim shpirtëror të cilin e quajmë tasavvuf/mistikë islame.

Pejgamberi, alejhi's-selam, i përmirësoi zemrat me edukim shpirtëror. Prej njerëzve të humbur që quheshin “shoqëria e injorancës” formoi “Shoqërinë e Epokës së Lumturisë”. Përgjatë një kohe rreth njëzet e tri vite, u formua një brez i ri. Secili prej sahabëve të nderuar e ndriçoi këtë botë si një yll. Secili prej tyre ishte një yll, por në të njëjtën kohë, secili yll kishte një cilësi të veçantë.

Në krye të emrave që gjendeshin në pikën kulmore të edukimit shpirtëror padyshim që ishte Ebu Bekri (r.a.). Në të vërtetë, ky sahab i madh gjendej në pikën kulmore në çdo fushë. Ai vazhdimisht qëndronte pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ai ka pasur rolin më të madh në transmetimin e Islamit te brezat e ardhshëm.

Edukimi shpirtëror që reflektohet në çdo fushë të jetës, edhe pse nuk ka pasur emër në Epokën e Lumturisë, në shekujt e mëvonshëm do të quhej “Tasavvuf”. Tasavvufi ose mistika islame është jeta shpirtërore dhe aspekti esencial e spiritual i Islamit. Tasavvufi është edhe dëlirësi, edhe përsosmëri. Ai edukon njeriun e përsosur, i cili është i mrekullueshëm nga çdo aspekt.

Kur themi njeri i përsosur, sigurisht se njeriu i parë që na vjen në mendje është i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam. Siç shprehet edhe Kurani Fisnik, Ai është “usvetun hasene / shembulli më i bukur”. I Dërguari i Allahut (a.s.), i cili ishte shembulli më i bukur, edukoi njerëz që u bënë shembujt më të bukur. Në këtë mënyrë, formoi një shoqëri të dëlirë si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Ai i dha shumë rëndësi strukturës shpirtërore që ne e quajmë edukim shpirtëror.

I Dërguari i Allahut (a.s.), na e ka tërhequr vëmendjen për Ebu Bekrin (r.a.), i cili ishte emri që printe në këtë edukim shpirtëror. Kur Pejgamberi,

alejhi's-selam, emigroi nga Meka në Medine, me vete pati marrë Ebu Bekrin (r.a.). Tri netët që i kaluan bashkë në shpellën Theur, janë më të vlefshme se jeta e të gjithëve. Umeri (r.a.), e shpreh këtë në formën më të bukur: "Netët dhe ditët që Ebu Bekri (r.a.), i ka kaluar bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në shpellën Theur, janë më të mira se jeta e Umerit dhe e gjithë familjes së tij!" (Hakim, Mustedrek, III, 7/4268.)

Sulltani i sahabëve, i cili mori mësimet më të mira nga sulltani i pejgamberëve, në të njëjtën kohë ishte edhe njeriu në krye të zinxhirit të artë. Në stacionin Theur të udhëtimit të hixhretit, u bënë mësimet shpirtërore më të larta. Ebu Bekri (r.a.), për tri ditë dhe tri net mori mësim shumë të veçanta nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Për ta marrë këtë mësim shpirtëror, duhej që Ebu Bekri (r.a.), të ishte i gatshëm. Ebu Bekri (r.a.), tashmë ishte i gatshëm për këtë. Ose më saktë, ai i pati dhënë me një sukses të madh të gjitha provimet e periudhës së Mekës që zgjati trembëdhjetë vjet radhazi. Në këtë kontekst, ishte i gatshëm për mësim shpirtëror. I Dërguari i Allahut (a.s.), shokun e tij më të ngushtë pothuajse, e kishte përgatitur për një qëllim të tillë sublim. Puna serioze kërkon edhe një bazë serioze. Ja, ky është mësimi shpirtëror që ka ardhur nga Epoka e Lumturiës deri në ditët tona. Ky amanet i shenjtë ka ardhur nga ato ditë e deri në ditët tona nëpërmjet këtij zinxhiri të artë.

Ebu Bekri (r.a.), jo vetëm në periudhën e Mekës apo përgjatë ditëve të hixhretit, por edhe përgjatë gjithë periudhës së Medines ka qëndruar vazhdimisht me të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ebu Bekri (r.a.), ia pati dedikuar të gjithë jetën e vet të Dërguarit të Allahut (a.s.), siç e pati sakrifikuar çdo gjë të tij për Atë.

Ebu Bekri (r.a.), ishte ylli më i ndritshëm i Epokës së Lumturiës. Edukimi shpirtëror që Ebu Bekri (r.a.), e mori nga sulltani i përshpirtjes, në literaturë është shënuar si edukimi shpirtëror në Epokën e Lumturiës. Pasi Ebu Bekri (r.a.), e mori amanetin shpirtëror nga i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ia dha Selman el-Farisiut. Selman el-Farisiu (r.a.), përparoi aq shpejt saqë e përfundoi në një kohë të shkurtër edukimin e tij. I Dërguari i Allahut (a.s.), e donte shumë Selman el-Farisiun (r.a.). I Dërguari i Allahut (a.s.), thoshte për Selman el-Farisiun, i cili ishte i pandashëm ndërmjet ensarëve dhe muhaxhirëve për shkak të moralit dhe virtyteve

të larta që kishte: "Selmani është prej nesh, është prej Ehli Bejtit." (Hakim, Mustedrek, vëll. 3, fq. 691; Ibn Hisham, vëll. 3, fq. 241.)

Pasi ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (a.s.), Selman el-Farisiu (r.a.), pasoi Ebu Bekrin (r.a.). Ai nuk u nda asnjëherë nga kuvendet e Ebu Bekrit (r.a.) dhe vazhdimisht kishte një marrëdhënie shumë të ngushtë me të. Selman el-Farisiu (r.a.), mori frymëzim nga Ebu Bekri (r.a.). Ai mori kaq shumë frymëzim saqë arriti grada shumë të larta në dijet ezoterike dhe ato ekzoterike. Selman el-Farisiu (r.a.), së pari mësimin e tij e pati marrë nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Më vonë e vazhdoi me Ebu Bekrin (r.a.). Ndërkohë që nga njëra anë piquej mirë në hallkat e kuvendeve të Ebu Bekrit (r.a.), nga ana tjetër mbante kuvende fetare edhe vetë.

Selman el-Farisiu (r.a.), u dha mësim shumë personaliteteve që ishin sahabë si vetë ai. Ndërmjet këtyre gjendeshin edhe sahabë të mëdhenj si Ebu Said el-Hudriu (r.a.), Abdullah ibn Abbasi (r.a.), Evi ibn Maliku (r.a.), etj. Në të njëjtën mënyrë, u jepte mësim edhe të mëdhenjve të tabiinëve. Në krye të këtyre vinte Kasim ibn Muhamedi (r. alejh).

Selman el-Farisiu (r.a.), ia dha Kasim ibn Muhamedit trëndafilat që i pati mbledhur nga kopshti i trëndafilave të Epokës së Lumturiës. Me një shprehje tjetër, edukimi shpirtëror që u formua në Epokën e Lumturiës do të mbarojte brezat e tjerë nëpërmjet Kasim ibn Muhamedit (r. alejh).

Zinxhiri i artë, pas të Dërguarit të Allahut (a.s.), filloi me Ebu Bekrin (r.a.). Pas Ebu Bekrit (r.a.), vinte Selman el-Farisiu (r.a.). Pas Selman el-Farisiut (r.a.), do të vazhdonte me Kasim ibn Muhamedin (r. alejh)...

Ne këtu shtjelluam vetëm pikat kryesore në mënyrë të përgjithshme të edukimit shpirtëror në Epokën e Lumturiës. Në të njëjtën kohë u përpoqëm ta përmbledhim edhe dimensionin e zinxhirit të artë në Epokën e Lumturiës dhe në periudhën e fillimit, domethënë, t'i bënim një përmbledhje të shkurtër lindjes së Tasavvufit / mistikës islame. Epoka e Lumturiës është e mbushur me shembuj që mund t'i ndriçojnë të gjithë në çdo aspekt. Mjafton që ne të dimë të marrim shembull. Lus Allahun Teala që të na e mundësojë për të marrë shembull nga Shembulli i Shembujve dhe të bëjmë një jetë shembullore!..



Devijimi në akaid

të shpie në Xhehenem

Xhemal Nar

Biri i Ubade ibn Samittit, Velid ibn Ubade tregon: “Babai im, Ubade ibn Samit u sëmur. Kur shkova për ta vizituar, vura re shenjat e vdekjes tek ai. Nisur nga kjo, i thashë: “Baba! Më këshillo në çështjen që e sheh më të rëndësishme për mua!” Babai tha: “Më ngrini!” Kur e ngritëm, më tha: “O bir! Përsa kohë nuk beson në Caktimin hyjnor qoftë manifestim i mirë apo i keq, nuk do ta shijosh besimin dhe nuk do ta arrish të vërtetën e njohjes së Allahut Teala!” Kur e pyeta:

“O baba! A mund të më thuash se si mund ta ndajë nga njëra-tjetra të mirën dhe të keqen e Kaderit?” – ai më tha: “Ato që janë caktuar për të të ndodhur, patjetër do të të ndodhin. Nga ana tjetër, duhet ta dish edhe këtë se, një gjë që nuk të është caktuar për të të ndodhur, asnjëherë nuk do të të ndodhë. Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, pagja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, duke thënë: “*Allahu së pari ka krijuar lapsin dhe pastaj e ka urdhëruar atë që të shkruajë. Andaj, lapsi ka shkruar çdo gjë që do të ndodhë deri në Ditën e Kiametit.*” O bir! Nëse nuk do të kesh këtë besim, do të hysh në Xhehenem kur të vdesësh.”

Ehlu’s-sunneh ve’l-xhemaah kanë nxjerrë në pah besimin dhe akaidin e bazuar në argumente të sakta. Këto argumente u kanë dhënë fund debateve që kanë zgjatur me shekuj të tërë. Edhe në lidhje me Kaderin ka pasur shumë prej atyre që kanë folur mjaft pa vend. Ndërmjet këtyre ka dy fraksione që bien më shumë në sy. Njëri prej tyre ka rënë në ifrat, ndërsa tjetri në tefrit. Pra, njëri është fraksioni Kaderijje dhe tjetri është fraksioni Xhebrije.

Ndërkohë që kjo çështje ka marrë fund, disa hoxhallarë po na i nxjerrin përpara përsëri këto debate sikur të ishin të reja. Për shkak të një pjese të debateve të pavend po shkojnë dëm shumë përpjekje, po lëkundet dashuria ndërmjet besimtarëve, po prishet bashkimi dhe po përhapen fraksionet. Disa prej këtyre i kuptojmë, por ka edhe prej atyre që nuk i kuptojmë, për fat të keq. Vallë, cili është halli i këtyre dijetarëve? Këtë nuk po e kuptojmë dot!

Tani, nëse dëshironi, le t’i shtjellojmë shkurtimisht këto dy fraksione, në mënyrë që ta dimë se sa të vjetra dhe të mbyllura (përfunduara) janë këto debate:

1. Ibn Kethir, Tefsir IV/268 (Nga Imam Ahmed. Veçanërisht shënohet se është transmetuar edhe nga Tirmidhiu.) Shik. Muhammed Jusuf Kandehevi, Hajatu’s-Sahabe, 3/305-306.

Njëri prej këtyre fraksioneve është Kaderijje. Këta e mohojnë plotësisht Kazanë dhe Kaderin. Por ngaqë këtë e bëjnë vetëm me qëllimin për ta lartësuar sheriatin e Zotit (xh.xh.), nuk mund të akuzohen për kufër/mohim. Këta kanë shkuar deri aty saqë thonë: “Robi e krijon vetë veprën e tij.” Për këtë arsye, janë sulmuar shumë ashpër nga dijetarët e Ehli Sunetit. Veçanërisht dijetarët e Maveraun-Nehirit janë treguar shumë të ashpër në lidhje me këtë çështje dhe kanë thënë: “Gjendja e zoroastrianëve/adhuruesve të zjarrit është më e mirë se gjendja e fraksionit Kaderijje.”

Ata që ndjekin fraksionin Kaderijje, edhe pse më vonë filluan t’i besonin Kaderit të Allahut Teala, prapë se prapë nuk shpëtuan dot nga ngjasimi me zoroastrianët politeistë, ngaqë besonin se e mira vjen nga Allahu, ndërsa e keqja vjen nga dikush tjetër.

Ndërsa fraksioni tjetër është medhhebi i bidatit, që quhet “Xhebrije”. Këta, duke e kundërshtuar plotësisht Kaderijen, thonë: “Çdo gjë është e lidhur me Kazanë dhe Kaderin. Robi nuk ka asgjë në dorë. Veprën, vullnetin dhe fuqinë e krijon Allahu.” Ngaqë ata nuk e pranojnë vullnetin e pjesshëm të robit, shprehen se rob nuk është i aftë që të besojë vetë. Kujtdo që Allahu ia jep besimin, ai është besimtar. Kujtdo që nuk ia jep besimin, ai është qafir.

Siç shihet qartë, edhe këta, sigurisht se me nijet të mirë, duke u përpjekur gjoja për ta nxjerrë Allahun larg mangësive, janë zhytur në një tefrit të tmerrshëm për shkak të dijeve të ngushta të tyre dhe pa e kuptuar, e akuzojnë Allahun (Zoti na faltë) për padrejtësi.

Për shembull: Nëse robit nuk i është lënë në dorë vullneti i pjesshëm, atëherë, a nuk do ta kundërshtonte Ebu Xhehli Allahun e Lartësuar duke thënë: “O Zot! Çfarë faji kam unë? Ti më ke krijuar qafir. Kështu që mohimi nuk është prej meje, por prej Teje, sepse unë nuk kam në dorë asgjë. Ti më ke krijuar ashtu siç ke dëshiruar. Edhe unë kam vepruar ashtu. Atëherë, përse më ndëshkon? A nuk është padrejtësi kjo?”

Për këtë arsye, një njeri të tillë (ndjekës i fraksionit Xhebrije), goditeni me një shuplakë të fortë. Nëse thotë: “Përse më godite?”, përgjigjuni në këtë mënyrë: “Allahu e paska shkruar kështu në kaderin tim. Çfarë mund të bëj unë?”

Si thoni? Vallë, a do të pranojë?



Shqetësimi për Ahiretin

Dr. Murat Kaja

Në zemrat e njerëzve asnjëherë nuk duhet të mungojë shqetësimi për Ahiretin. Nëse nga zemra del llogaria për botën tjetër dhe ajo shndërrohet në një zemër që mendon vetëm për hesapet e kësaj bote, kjo cilësohet si një sëmundje e madhe shpirtërore.

Allahu Teala nuk i vendos njëherësh në zemrën e robit dy frikë dhe dy siguri. Ata që gëzohen me haramet në këtë botë, do të përpëliten me frikë dhe trishtim të vërtetë në botën tjetër. Ndërsa besimtarët që e kanë frikë Allahun në këtë botë dhe që shqetësohen për Ahiretin, në botën tjetër do të arrijnë gëzimin, lumturinë dhe sigurinë e vërtetë. Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Ai, të cilit do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij. Kurse ai, të cilit do t’i jepet libri i tij pas shpinës, do të lutet për të vdekur dhe në zjarr do të digjet, sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari).” (Inshikak, 7-14)

“Ata (banorët e Xhenetit) do të afrohen, duke biseduar me njëri-tjetrin e duke thënë: “Më parë, Ne kemi pasur frikë në familjet tona (nga gjykimi i Allahut), por, Allahu na ka dhuruar mëshirë dhe na ka ruajtur nga era përcëlluese (e Zjarrit).” (Tur, 25-27)

Shembujt e shkëlqyer që tregojnë mënyrën e mbajtjes në formë aktive të shqetësimit për Ahiretin në

jetën e kësaj bote na janë transmetuar nga jeta e sahabëve të nderuar dhe veçanërisht nga jeta e Umerit (r.a.). Andaj, le ta krahasojmë gjendjen tonë duke shfaqur disa prej tyre:

Ebu Bekr el-Absi (r.a.), tregon:

“Bashkë me Umerin, Osmanin dhe Aliun hymë në vendin ku gjendeshin devetë e zekatit. Osmani u ul në hije dhe filloi të shkruante. Aliu (r.a.), u ul pranë tij dhe po i thoshte të shkruante ato që thoshte Umeri (r.a.). Ndërsa Umeri (r.a.), po kontrollonte në këmbë devetë e zekatit në diellin e asaj ditë që i nxehti ishte shumë përvëlues. Sipër kishte vendosur dy mbulesa. Njërën e kishte mbështjellë në anën e poshtme, ndërsa tjetrën e kishte vënë mbi kokë. Umeri (r.a.), po i numëronte devetë dhe po u tregonte atyre ngjyrat dhe dhëmbët e tyre që t’i shkruanin.

Aliu (r.a.), i tha Osmanit (r.a.): “A nuk e ke dëgjuar këtë fjalë të vajzës së Shuajbit (a.s.), në librin e Allahut Teala: **“O babai im, - tha njëra nga ato të dyja - merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht që njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët, që dikush mund të marrë në shërbim.”** (Kasas, 26) Pastaj ia bëri me shenjë nga Umeri (r.a.) dhe e vazhdoi kështu fjalën e tij: “Ja, ky person është një njeri i fuqishëm dhe i besueshëm.”¹

1. Taberi, Tarih, IV, 201; Ibn Asakir, Tarihu Dimeshk, vëll. 44, fq. 274-275; Dehlevi, Izaletu'l-hafa, II, 558.

Një ngjarje tjetër të ngjashme me këtë e transmeton shërbëtori i Osmanit (r.a.):

“Një ditë të nxehtë vere isha bashkë me Osmanin (r.a.), në shtëpinë e tij që gjendet në zonën Avali (zonë afër qytetit të Medines). Në ato momente Osmani (r.a.), pa dikë që po i tërhiqte nga pas dy deve të reja. Sipërfaqja e tokës dukej dallgë-dallgë për shkak të të nxehtësisë të madh. Osmani (r.a.), tha: “Vallë, çfarë ka ai njeri? Ah sikur të priste në Medine derisa të freskohej koha dhe pastaj të nisej për rrugë!” Kur burri na u afrua, Osmani (r.a.), më tha: “Pa shiko pak se kush është!” Pash dhe iu përgjigja: “Po shoh një njeri që ka vënë një mbulesë në kokë dhe që po tërheq nga pas dy deve.” Kur ai burri u afrua edhe pak, Osmani (r.a.), më tha: “Shiko edhe një herë!” Pash edhe një herë, por ç’të shikoja: Ai ishte Umeri (r.a.). Menjëherë i thashë Osmanit (r.a.):

“Personi që po vjen është udhëheqësi i besimtarëve!” Osmani (r.a.), u ngrit, doli te dera dhe e nxori kokën jashtë. Pasi avulli i nxehtë që frynte nga jashtë e shqetësoi, menjëherë e futi kokën brenda dhe priti edhe pak. Kur Umeri (r.a.), arriti afër shtëpisë, Osmani (r.a.), e pyeti: “Çfarë është ajo që të ka nxjerrë jashtë në këtë orë?” Umeri (r.a.), iu përgjigj:

“Dy deve nga mallrat e zekatit patën ngelur pas. Devetë e tjera të zekatit janë çuar në vendet e tyre. Edhe këto desha t’i çoja në korije që t’i bashkoja me të tjerat, sepse kam frikë se humbasin dhe pastaj Allahu Teala më merr mua në llogari për to!” Osmani (r.a.), i tha:

“Ejani këtu, o udhëheqësi i besimtarëve! Pini pak ujë dhe pushoni në hije! Ne i çojmë ato në vendin e tyre.” Umeri (r.a.), i tha:

“Ti kthehu te hija jote!” Osmani (r.a.), i tha:

“Kam shërbëtorë këtu që mund ta bëjnë atë punë.” Umeri (r.a.), përsëri ia ktheu:

“Ti kthehu në hijen tënde!” – dhe pastaj vazhdoi rrugën. Osmani (r.a.), u kthye pranë nesh dhe na tha: “Kush dëshiron të shohë një njeri shumë të fuqishëm dhe besnik, le të shohë atë person!”²

Dijetari i madh prej tabiinëve, Katade (r.a.), thotë: “Mos i lëndoni besimtarët, sepse, Allahu i Madhëruar mbron të lënduarit dhe dënon lënduesit.”

Sipas transmetimeve, kur Umeri (r.a.), e lexoi ajetin e mësipërm, u tmerrua dhe menjëherë shkoi te Ubej ibn Ka’bi (r.a.) dhe i tha: “O Ebu’l-Mundhir! Unë kam lexuar një ajet nga libri i Allahut që po ma dridh çdo vend të trupit tim. Për Zotin, unë nganjëherë i ndëshkoj njerëzit dhe nganjëherë i rrah!” Ubej ibn Ka’bi (r.a.), i tha: “Ti nuk je prej atyre që flitet në këtë ajet fisnik. Ti je një edukues (vepron kështu për t’i edukuar njerëzit).” (Ibn Ebi Hatim, Tefsir, X, 3152.)

Ijas ibn Seleme (r.a.), transmeton nga babai i tij: “Umeri (r.a.), doli në treg. Në dorë kishte një kamxhik. Kamxhikun e lëkund drejt meje dhe më tha: “Mos rri në mes, por hape rrugën!” Kamxhiku më goditi në fundin e rrobës. Kur pas një viti u takuam përsëri, më pyeti: “Seleme, a do të shkosh në haxh?” Kur i thashë: “Po.” – më kapi për dore dhe më çoi te shtëpia e tij. Më dha gjashtëqind dirhemë dhe më tha: “Këto përdori përgjatë rrugës në haxh. Dije se këto janë si dëmshpërbim për goditjen që të bëra me kamxhik!” Unë i thashë: “O udhëheqësi i besimtarëve! Mua nuk po më kujtohet kjo çështja e kamxhikut për të cilën po më flet.” Ai më tha: “Ndërsa unë nuk e kam harruar aspak!” (Taberi, Tarih, IV, 224.)

Hafsa (r. anha), i tha babait të saj, Umerit (r.a.): “O udhëheqësi i besimtarëve! A nuk bën të veshësh rroba më të buta se këto dhe të hash ushqim më të mirë se ky? Allahu ta ka mundësuar çlirimin e shumë vendeve dhe ta ka shtuar riskun!” Umeri (r.a.), e filloi fjalën: “Tani do të të jap si argumente gjendjet që i kam përjetuar vetë sikundër asaj që më the. A nuk e di ti se me çfarë vështirësish është përballur i Dërguari i Allahut (s.a.s.), në jetën e tij?..” Pastaj i tregoi për varfërinë dhe një pjesë të vështirësive me të cilat është përballur i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të.

Pasi Hafsa (r. anha), i dëgjoi këto, filloi të qante. Umeri (r.a.), e vazhdoi kështu fjalën e tij: “Po të them edhe këtë: Dy shokët e mi kanë shkuar nga e njëjta rrugë. Andaj, nëse unë do të hyj në një rrugë tjetër nga e cila nuk kanë shkuar ata, do të arrij në një vend ndryshe. Për Zotin, edhe unë do të bëj të njëjtën jetë të vështirë që kanë bërë ata, në mënyrë që ta arrijë bashkë me ata jetën e pafundme!” (Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VII, 79/34334; Nesai, es-Sunenu’l-Kubra, X, 389/11806.)

2. Imam Shafii, Musned, fq. 390; Ibn Asakir, Tarihu Dimeshk, vëll. 44, s. 274.



MALLKUAR QOFSHIN GËNJESHITARËT

Fatmir Hadri

Allahu Lavdiplotë dhe i dërguari i Tij Muhamedi (a.s.), na kanë bërë me dije se morali është një veçori e pëlqyer, që duhet ta ketë çdo njeri. Morali gëzon një pozitë të lartë në fenë islame. Ai është një ndër elementet kryesore i cili çon drejt formimit të besimtarit të vërtetë, të edukuar dhe të vetëdijësuar në baza islame. Andaj besimtari duhet të largohet nga moralet e këqija që e shpjen atë në degradim e shkatërrim. E njëri nga moralet e këqija që njeriun e shpjen në degradim dhe shkatërrim pa dyshim që është edhe gënjeshtria, një veti e urryer, një cilësi e keqe, një vepër e poshtëruar që u përket injorantëve e hipokritëve.

Allahu Lavdiplotë dhe i dërguari i Tij Muhamedi (a.s.), na inkurajojnë që të largohemi nga kjo, të jemi të sinqertë në fjalë edhe vepra, ajo çfarë themi të jetë në përputhje me realitetin, pa shtrembërime dhe pa deformime. Madje Muhamedi (a.s.), na lajmëron se ai i cili është i sinqertë në fjalë dhe vepra, sinqeriteti ka për ta shpënë tek mirësia në këtë botë dhe për tek Xheneti në botën tjetër. Ai në këtë drejtim ka thënë:

“Me të vërtetë, sinqeriteti të shpie tek mirësia, e mirësia të shpie në Xhenet. Vërtet, njeriu vazhdon të jetë i sinqertë (në fjalë e vepra) derisa shkruhet tek Allahu i Sinqertë. Kurse, me të vërtetë, gënjeshtria të shpie drejt shthurjes, e shthurja të shpie në Zjarr. Vërtet,

njeriu vazhdon të gënjejë derisa shkruhet tek Allahu Gënjeshtar.”¹

Pra, nëse njeriu vazhdon të jetë i sinqertë, tek batorët e qiellit dhe të tokës pa dyshim se do të njihet i sinqertë. Madje, nëse njeriu thotë gjithmonë të vërtetën do të shmangë edhe mëkatet e tjera. Në një hadith tjetër Muhamedi (a.s.), thotë:

“Më garantoni gjashtë gjëra, t’ju garantoj Xhenetin; Thoni të vërtetën kur të flisni, mbajeni fjalën kur ta jepni, çojini amanetet në vend, ruani nderin tuaj, ulni shikimin ndaj haramit dhe mos bëni keq me duart tuaja.”²

Mund të themi se njeriu i sinqertë është në rangun e dytë të atyre njerëzve që Allahu i ka begatuar me mirësitë e Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti; me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me punëmirët.”³

Si rrjedhojë e kësaj, nëse dëshirojmë të posedojmë një karakter të pastër dhe të moralshëm duhet të jemi të sinqertë në fjalë dhe vepra dhe të largohemi

1. Buhariu, Nr: 6094; Muslimi, Nr: 2607.

2. Imam Ahmedi, nr: 22250.

3. Maide, 75.

sa më shumë nga gënjeshtër qoftë me fjalë qoftë me vepra. Mirëpo gënjeshtër është bërë mjaft fenomen i përhapur, pothuajse në të gjitha mjediset shoqërore; në biseda të lira, takime, punë, marrëdhënie të ndryshme ndërnjerëzore, shkollë, studime etj... Gënjeshtër sikur është shndërruar në pronën (mall shitjeje) e tregtarëve, bashkëshortëve, studentëve, shkrimtarëve, mediave, e atyre që merren me art... dhe është bërë e pamundur që njeriu të kuptojë se kush nga këta është i sinqerti. Kurse gënjeshtër në Islam është e ndaluar dhe konsiderohet si një ndër mëkatet e mëdha. Si gënjeshtër përkufizohet çdo thënie që kundërshton realitetin (të vërtetën). Allahu i Lartësuar në Kuran thotë:

“Mallkuar qofshin gënjeshtarët!”⁴

Duke u nisur nga kjo kuptohet se Allahu i ka mallkuar ata që gënjejnë. Andaj gënjeshtër duhet konsideruar si veprim i shëmtuar që të shpie në humbje dhe sjell mallkimin e Allahut. Në fillim kur thuhet gënjeshtër duket sikur është një veprim që të nxjerr nga situata jo e pëlqyeshme dhe e palakmueshme, por nuk duhet harruar se personi i cili gënjen gjithmonë e ndjen veten të shqetësuar nga ajo se mos po i del në shesh gënjeshtër dhe të bjerë në një gjendje të keqe e të palakmueshme. Për të mos ardhur deri tek një situatë e tillë, ai detyrohet të gënjejë sërish. Por sido që të jetë herët apo vonë, gënjeshtër e tij do të zbulohet. Kështu pra, njeriu vazhdon të gënjejë derisa vuloset si gënjeshtar. Pas kësaj njerëzit atë do ta njohin për mashtrues, engjëjt do ta njohin për gënjeshtar dhe më e keqja siç e thamë edhe më lart, ai është regjistruar tek Allahu si gënjeshtar.

GËNJESHTRA MASHTRIM I VETVETES

Njeriu duhet të jetë vigjilent që, si në jetën e përditshme ashtu edhe kur ngushtohet përballë ndonjë situatë ose kur bie në ndonjë gjendje të palakmueshme, mos të përdorë gënjeshtër për ta treguar veten e tij të pastër. Sepse me këtë do të mashtronte vetëm veten. Në rast se bën një gjë të tillë, atëherë duhet ta ketë parasysh se tek ai do të fillojnë të shfaqen shenjat e hipokrizisë, dhe në këtë mënyrë gënjeshtër do t'ia kaplojë të gjithë zemrën. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Kur vijnë tek ti hipokritët, thonë: ‘Ne dëshmojmë se ti je vërtet i Dërguari i Allahut! Allahu e di se ti je i Dërguari i Tij, por Ai dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë.’”⁵

Andaj njeriu duhet të ketë ndërgjegje, iman dhe mendje të fortë që të mund të mbrohet nga kjo cilësi e shëmtuar. Në të kundërtën, njeriu përballë cilësive

të këqija që janë të lakmueshme për epshin do të mbetet i dobët.

Allahu në Kuran thotë:

“Gënjeshtërën e trillojnë vetëm ata që nuk i besojnë argumentet e Allahut; të tillët janë ata gënjeshtarët.”⁶

Një besimtarë i sinqertë, kur e shikon këtë ajet kuranor, vëren se gënjeshtër trillohet vetëm nga ata të cilën nuk besojnë Allahun Mëshirëplotë. Kështu që prej Allahu kërkon ndihmë që mos të jetë nga ata njerëz që nuk besojnë, që nuk frikësohen vetëm nga Ai.

GËNJESHTRA, CILËSI KRYESORE E SHEJTANIT

Gënjeshtër ose dhënia e njohurive mashtruese është prej cilësive më kryesore të shejtanit. Andaj dhe shejtani me këto cilësi njerëzit i mashtron dhe i largon nga rruga e drejtë dhe e vërtetë. Ai vazhdon t'i largojë nga kjo rrugë personat që i ka bërë për vete. Një njëri që gënjen, do të thotë se në atë moment është duke iu nënshtruar indoktrinimeve të shejtanit.

Njëri nga ajetet e Kuranit që tregon karakterin mashtrues të shejtanit është në këtë mënyrë.

“Dhe, kur të marrë fund puna, djalli do të thotë: ‘Vërtet, Allahu ju bëri një premtim të vërtetë. Edhe unë ju premtova, por ju mashtrova...’”⁷

Me gjithë këtë ka edhe disa njerëz që gënjeshtërën e cilësojnë si të neveritur e të urryer, kurse në realitet ata vetë gënjejnë. Kurse veçoria më e rëndësishme e këtyre gënjeshtërave është pretendimi se gënjeshtër “nuk mund të vërtetohen ose vështirë është të vërtetohen”. Pra të tillët mundohen të ndryshojnë realitetin duke e shtrembëruar dhe përmbysur me metoda dashakeqëse, të ndërlikuara dhe me dredhi. Morali i këtyre personave “që gënjejnë duke shtrembëruar” të vërtetën në Kuran tregohet kështu:

“A t’ju tregoj unë se kujt i vijnë djajtë? Ata i vijnë çdo gënjeshtari e mëkatari.”⁸

Allahu i Madhëruar me këtë ajet kuranor ka njoftuar në mënyrë të qartë se çdo gënjeshtari dhe mëkatari i vijnë djajtë dhe në këtë mënyrë ata mbesin nën ndikimin e tij.

PRETENDIMI QË NUK GËNJEJNË

Sikurse thamë edhe më lart, disa persona pretendojnë dhe janë plotësisht të bindur se nuk gënjejnë. Kurse në realitet edhe kjo nuk ka aspak dallim me gënjeshtërën që thuhet haptazi. Njëri të vërtetën e

4. Dharijat, 10.

5. Munafikun, 1.

6. Nahl, 105.

7. Ibrahim: 22.

8. Shuara, 221-22.

refuzon haptazi kurse tjetri e refuzon duke trilluar arsye dhe ndjesa të ndryshme. Përshembull: Një person kur dëshiron ta marrë mbrapa fjalën që e ka thënë, në vend të thotë “unë e kisha gabim ose thashë diçka gabim”, thotë “unë me atë fjalë kisha për qëllim diçka tjetër jo atë që ju po mendoni”. Kur t’ia kujtosh se kjo metodë është një lloj i gënjeshtërsë ai nuk ia vë mendjen, madje mundohet që mungesën e sinqeritetit ta mbulojë me një gënjeshtëri tjetër.

Në këtë mënyrë, ai derisa mundohet të vërtetojë se nuk është duke gënjyer, radhë pas radhe i radhit gënjeshtret e tjera, vetëm e vetëm që veten ta nxjerrë të pastër dhe të drejtë në fjalë. Mos sinqeriteti në fjalë dhe në punë e fut njeriun në një rrugë pa kthim. Fjalën që ka thënë para një minute, pas një minute tjetër nuk e përkujton. Mundohet të tregojë një mendim tjetër. Kurse ky mendim nuk përputhet me të parin, ngase fjalët që janë thënë më herët nuk janë të vërteta dhe të sinqerta. Kurse për t’i treguar të vërteta dhe për t’i bërë që të jenë të njëjta me fjalët e mëhershme ai mbetet i detyruar që përsëri të gënjejë. Kjo rrëmujë atë e bën të harrojë krejtësisht fjalët që i ka thënë. Kur të përkujtohet ai përsëri për të mbrojtur vetveten dhe për të shpëtuar nga kjo situatë ai më në fund kundërshton dhe thotë: “Unë nuk desha të thosha atë” ose: “unë nuk e pata për qëllim atë, por e patë për qëllim këtë”. Në këtë mënyrë, ai për të mos u turpëruar para njerëzve me metoda jo të sinqerta mundohet të dalë nga gjendja në të cilën ka rënë.

Sikurse është gënjeshtëri të thuhet diçka që nuk është ose të mundohet të thuhet e kundërta e të vërtetës, ashtu edhe kjo mënyrë jo e sinqertë me të cilën synohet shtrembërimi i së vërtetës, është një gënjeshtëri e qartë. Kurse Allahu i Gjithëdijshtëm e di shumë mirë qëllimin dhe sinqeritetin e atij që thotë këto fjalë. Ata për të mos u turpëruar para njerëzve të tjerë mundohen të fshehin të vërtetën, kurse edhe pse mundohen të fshehin të vërtetën nga njerëzit, nga Allahu i Gjithëdijshtëm nuk mund ta fshehin, sepse Allahu e di atë që fshehin në zemrat e tyre. Allahu në Kuran këtë të vërtetë e tregon kështu:

“Ata fshihen (turpërohen) prej njerëzve, e nuk turpërohen prej Allahut...”⁹

Allahu Lavdiplotë na urdhëron që gjithmonë të jemi të drejtë në fjalë, në punë dhe në vepra. Ai na

urdhëron të dëshmojmë të vërtetën, edhe nëse është kundër interesit tonë. Allahu Fuqiplotë u drejtohet në këtë mënyrë atyre që kanë besuar.

“O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmuar të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, pse Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t’i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, Allahu hollësisht di ç’ka punoni.”¹⁰

Si përfundim, zgjidhja e vetme për të shpëtuar nga sëmundja e gënjeshtërsë është besimi i sinqertë. Kështu që vetëm besimi i sinqertë mund ta shpëtojë njeriun nga thënia e gënjeshtërsë. Sepse njeriu, ngase nuk e ka besimin në zemër dhe frikën ndaj Allahut Lavdiplotë, është në gjendje të gënjejë.

Shejtani ia bën njeriut gënjeshtren të bukur dhe e nxit në këtë drejtim. Duke shpresuar që të fitojë afërsinë, dashurinë dhe sigurinë e njerëzve vjen në një gjendje që nuk i besohet më, dhe çfarë është më e tmerrshme, ai kështu largohet nga mëshira dhe dashuria e Allahut Mëshirëplotë.

Njeriu, edhe nëse do të pësojë dëm material dhe shpirtëror në këtë botë, përsëri nuk duhet të largohet nga sinqeriteti dhe e drejta. Sepse ky është morali më i bukur që Allahu Lavdiplotë e do dhe e pëlqen. Nëse njeriu tregohet i vendosur dhe i sinqertë nga frika ndaj Allahut, Ai (xh.sh.) fundin e tij për shkak të sinqeritetit do t’ia bëjë të mirë dhe të begatshëm. Njeriu i sinqertë dhe i drejtë asnjëherë nuk do të jetë i dëmtuar apo i keqtrajtuar. Sepse Allahu Mëshirëplotë i do robërit e drejtë dhe të sinqertë. Allahu Mëshirëplotë e tregon kështu përfundimin e bukur që do të përjetojnë të drejtët dhe të sinqertët në Kuran:

Allahu thotë: “Kjo është Dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre. Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është fitorja e madhe!”¹¹

Allahu Mëshirëplotë na bëftë prej të drejtëve dhe të sinqertëve. Amin!

Njeriu vazhdon të gënjejë derisa vulozet si gënjeshtar. Pas kësaj njerëzit atë do ta njohin për mashtrues, engjëjt do ta njohin për gënjeshtar dhe më e keqja është se ai regjistrohet tek Allahu si gënjeshtar.

9. Nisa, 108.

10. Nisa, 135.

11. Maide, 119.

FETARË PA FETARI

Edison Çeraj

Ka një prirje dhe një përpjekje për ta bërë fenë pjesë të kulturës masive apo të botës së spektaklit. Më mirë se askush këtë po e bëjnë vetë të ashtuquajturit fetarë me në krye klerikët apo udhëheqësit shpirtërorë. Spikat njëfarë pushtimi i shumë prej hapësirave publike nga shenja, subjekte dhe veprimtari të ashtuquajtura fetare; domethënë, një pushtim i sipërfaqeve në mënyrën më sipërfaqësore të mundshme. Po arrijnë të depërtojnë gati kudo, por jo te njeriu. Ata mund të fetarizojnë grupe deri dhe shoqëri të caktuara, por jo njeriun. Ka kohë që ata s'kanë asgjë për t'i thënë njeriut. Fokusi i tyre i vetëm është turma. Ata ngazëlleshen nga turma dhe i druhen njeriut. Ata i largohen cilësisë si djalli temjanit dhe gjakojnë për sasinë si i eturi për ujin.

Këto specie të kujtojnë thënien e njohur të Shaw-it: "Falë Zotit jam ateist." Me siguri që Shaw e ka thënë këtë duke pasur parasysh distancimin nga këto specie, e jo për të bërë ironi nga pozita e një ateisti, pasi nuk ishte i tillë. As Nietzsche, në thelb, nuk rezultoi të jetë ateist – përkundrazi, revolta dhe kërkimi tij janë thellësisht religjiozë. Kur flasim për "ateizmin", nihilizmin apo kundërshtinë e Nietzsche-s në raport me fenë, duhet të kujtojmë se Heidegger-i, në dy vëllimet e tij mbi Nietzsche-n, thotë se, për sa i takon çështjes së vdekjes së Zotit, sipas Nietzsche-s, ai që ka vdekur është Zoti sipas Krishterimit. Pa dyshim që qëndrimi i mirënjohur opozitar i Nietzsche-s në lidhje me fenë, me Krishterimin në veçanti, lidhet shumë pikërisht me shpërfytyrimin e klerit dhe të fetarëve të kohës së tij, pasi e kishin personalizuar Zotin dhe fetarinë duke i futur në ca këllëpe të sajuara nga dora njerëzore.

Në këtë kuptim, ndodh jo rrallë të gjejmë fetari te "ateisti" dhe ateizëm te "fetari".

Klerikë e fetarë që janë për t'u pasur lakmi nga luksi që shpaleshin. Klerikë dhe fetarë që aspirojnë të rriten në karrierë. Klerikë dhe fetarë që punojnë fort, po shumë fort. Klerikë dhe fetarë që marrin pjesë nëpër formate të caktuara spektakli. Klerikë që janë të famshëm në media por nuk njihen në lagjen ku banojnë. Klerikë dhe fetarë që i kryejnë ritet me hap ushtarak, me zhurma e brohorima. Përherë e më pak rite, gjithnjë e më shumë ceremoni. Fetarë që s'harrojnë të dokumentojnë me foto gati çdo gjë, deri edhe veten duke u lutur. Fetarë që shkruajnë një gjuhë të drunjtë. Fetarë që ngazëlleshen kur takohen me qeveritarë e politikanë. Fetarë që

krenohen me sasinë. Fetarë që ndihen mirë mes turmës. Fetarë që kanë frikë nga vetmia. Fetarë që kanë aftësi të shkëlqyera menaxhuese. Fetarë që çojnë në qiell të shtatë turmat, por nuk i thonë asgjë njeriut. Fetarë që udhëtojnë gjithandej në emër të misionit, por jo drejt vetes. Fetarë që pinë cola dhe birra. Fetarë që kanë shpirtin e garës. Fetarë që bëjnë bamirësi të shoqëruar me kamera. Fetarë që duan vetëm vëmendje. Fetarë që ndërtojnë ngrahina që t'i lëbyrin ose të vrasin sytë, ku ka vend për masat (mijëra vende) e jo për njeriun. Fetarë që punojnë me plan. Fetarë që admirojnë *kitsch*-in. Fetarë që mësojnë përmendësh. Fetarë që e provojnë besimin me të dhëna shkencore. Fetarë që shkruajnë tekste të tipit "feja dhe shkenca". Fetarë që shkojnë rregullisht në palestër. Fetarë që shkollohen për psikologji. Fetarë që punojnë fetarë. Fetarë që besojnë te veprimet dhe veprimtaritë. Fetarë që thonë se feja është e bukur. Fetarë që thonë se feja është tolerante. Fetarë që thonë se feja është sistem jetese. Fetarë që koleksionojnë vepra të mira. Fetarë që besojnë te progresi. Fetarë që luten *online*. Fetarë që e shpërndajnë të vërtetën me fletushka. Fetarë që tregojnë vetëm se çfarë nuk janë. Fetarë që e përshtasin fenë me rrethanat. Fetarë që e pasurojnë buqetën e nepseve përmes fesë. Fetarë që festojnë festën e nënës. Fetarë që ia dedikojnë të dielën familjes. Fetarë me dimër në fytyrë e me buzëqeshje cerebrale. Fetarë që nuk e kanë lexuar Don Kishotin. Fetarë që e përdorin poezinë si dekor. Fetarë pa fetari.

Janë pikërisht këto paradokse, të cilat nuk është se janë fenomen vetëm i kësaj kohe, – ato kanë ekzistuar edhe në të shkuarën në forma të ndryshme, por kanë qenë periferike, ndërsa sot janë qendra – që e kanë zhytur fenë në realitet, duke e reduktuar në pjesë të realitet, në realitetin e një bote të shpëllarë *in perpetuum* me spektakël, ku herë jemi aktorë e herë spektatorë.

Që në çastin që feja u bë fe pushoi së qenuri fe, u bë "opium për popullin".

Duke pasur parasysh sa më sipër, mund të themi se fetarët sot, për nga mënyra se si po shfaqen në hapësirat publike, përherë e më shumë po u vjen era ideologji, madje tashmë po i zbehin ideologjitë e njohura, sepse fetarët duan të konkurrojnë çdo gjë.

Për kujtesë, thelbi i fetarisë është: nëse nuk bëhesh asgjë do mbetesh asgjë.

MREKULLTË E Kuranit

SASIA E SHIUT

Një prej shumë informacioneve të dhëna në Kuran rreth formimit të shiut është fakti se ai zbret në Tokë në një masë të caktuar. Kjo është përmendur në suren Zuhruf si më poshtë: **Ai lëshon nga qielli shiun me masë të caktuar. Me të Ne i japim jetë një vendi të vdekur. Ja, kështu edhe ju do të ringjallen nga varret.** (Zuhruf 11)

Fakti i zbritjes së kësaj sasive shiu të matur dhe të përcaktuar është konfirmuar prej kërkimeve të kohëve të fundit. Është llogaritur se në një sekondë avullojnë afërsisht 16 milionë tonë ujë nga Toka. Kjo shifër arrin në 513 trilionë tonë ujë në vit. Kjo sasi është e barabartë me sasinë e shiut që bie në Tokë gjatë një viti. Kjo lë të kuptosh se uji qarkullon brenda një cikli të ekuilibruar "me masë të caktuar". Jeta në Tokë varet nga ky qarkullim i ujit. Sikur njerëzit të shfrytëzonin të gjithë potencialin teknologjik që disponojnë, nuk do të mund ta realizonin dot këtë qarkullim në mënyrë artificiale. Madje edhe një devijim i vogël i këtij ekuilibri, shumë shpejt do të sillte një çekuilibrim të madh ekologjik dhe për rrjedhojë, fundin e jetës në Tokë. Por kjo nuk ndodh asnjëherë dhe shiu vazhdon të bjerë çdo vit pikërisht në të njëjtën sasi, ashtu siç është shpallur në Kuran.

QUMËSHTI I NËNËS

Qumështi i nënës është një përzierje e pakrahasueshme që shërben si burim ushqimor i shkëlqyeshëm për foshnjën e porsalindur dhe rrit rezistencën ndaj sëmundjeve. As ushqimi artificial për fëmijë i prodhuar nga teknologjia e ditëve tona nuk mund ta zëvendësojë këtë burim ushqimor të mrekullueshëm. Çdo ditë zbulohen dobi të reja që përmban qumështi i nënës për fëmijën.

Një prej argumenteve që shkencëtarët ka zbuluar rreth qumështit të nënës është se pirja e tij gjatë dy viteve të para të jetës ka dobi mjaft të madhe. Në Kuran jepet një lajm mjaft i rëndësishëm 14 shekuj më parë në lidhje me këtë fakt të zbuluar nga shkencëtarët kohët e fundit: **"Nënat duhet t'i ushqejnë foshnjat e tyre për dy vjet me radhë..."** (Bekare 233)

"Ne e kemi urdhëruar njeriun që të sillet mirë me prindërit, sepse nëna e vet e mbajti në barkun e saj, me vështirësi pas vështirësie dhe pas dy viteve ia ndau gjirin. Ji mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve të tu, sepse tek Unë është kthimi juaj." (Lukman, 14)



“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porositi Ai për t’u ruajtur nga të këqijat.”

(En’am, 153)

Në këtë botë ne jemi udhëtarë të rrugës nga lindja deri në varr. Besimi dhe mënyra e jetesës është pjesë e pandashme e kësaj rruge. Në një mënyrë jemi udhëtarët e rrugës së Allahut, mbi të cilën kemi vendosur të ecim. Vetëm në këtë mënyrë besojmë që jeta fiton kuptim.

Sa herë që falim namazi lutemi që Allahu të na udhëzojë dhe të na bëjë të qëndrueshëm në rrugën e drejtë. Në këtë mënyrë ne jemi të vetëdijshëm që jemi udhëtarë të një rrugëtimi shpirtëror. Ne nuk jemi të parët që ecim në këtë rrugë. Gjatë gjithë historisë së bashku me peygamberët shumë besimtarë kanë përshkuar këtë rrugë për të fituar dashurinë e Allahut dhe lumturinë e përjetshme. Të gjithë ata që kanë ndjekur dhe ndjekin këtë rrugë janë përfytyes të mirësive të mëdha.

Gjatë ecjes në këtë rrugë ndonjëherë tabani mund të jetë i rrëshqitshëm, prandaj ndihma e Allahut në këtë rrugëtim është e domosdoshme, prandaj ne lutemi: **“Zoti ynë! Na pajis me durim, na forco këmbët tona dhe na ndihmo kundër këtij populli jobesimtar!”** (Bekare, 250)

Kjo rrugë është e mbushur me vështirësi dhe prova. Prandaj ata që nuk janë të vendosur mund të devijojnë në rrugë të tjera pa krye. Prandaj për të mos hyrë në rrugë pa krye duhet përcaktuar qartë harta e rrugës e cila të çon tek Allahu. Rruga që të çon tek Allahu nuk duhet ngatërruar me rrugët që të çojnë tek Shejtani. Ajeti: **“Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porositi Ai për t’u ruajtur nga të këqijat.”** (En’am, 153) e përcakton qartë se rruga që të çon tek Allahu është një. Rrugët janë të shumëllojshme dhe të gjitha të hapura për njeriun. Në një anë është rruga e drejtë e cila të çon në lumturinë e përjetshme dhe në një anë tjetër janë rrugët që të çojnë në një humbje të frikshme. Në një anë janë mirësitë pafund, kurse në një anë tjetër është Xhehenemi.

Përgjatë rrugës ka sinjale dhe shenja rruqore të cilat duhen respektuar, çdo shkelje e shenjave rruqore ka një kosto dhe një dënimi

të caktuar. Mosrespektimi i shenjave rruqore nganjëherë paguhet me jetë, nganjëherë rrezikon jetën e të tjerëve. Prandaj, kur nisemi në këtë rrugë duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe të përqendruar maksimalisht në rrugën tonë. Përndryshe rrezikojmë shumë duke mos e përfunduar udhëtimin. Gjatë udhëtimit tonë në këtë rrugë shpirtërore duhet të respektojmë të gjitha shenjat dhe kufijtë e vendosur nga Allahu. Gjatë rrugës mund të na dalin shumë kurthe, të cilët synojnë devijimin nga rruga e drejtë. Shejtani dhe miqtë e tij janë në përpjekje të vazhdueshme për të na devijuar nga rruga e drejtë. Shejtani kurdis të gjitha llojet e kurtheve për ta bërë njeriun të ndjekë hapat e tij. Çdo shmangie nga urdhëresat hyjnore na afrojnë me shumë me Shejtanin. **“Atij që shmanget nga Këshilla e të Gjithëmëshirshmit (Kurani), Ne do t’ia caktojmë një djall, që do t’i bëhet shok i pandashëm. Në të vërtetë, djajtë i shmangin jobesimtarët nga rruga e drejtë, ndonëse ata mendojnë se janë të udhëzuar drejt.”** (Zuhruf 36-37)

Besimi i fortë është faktori më i rëndësishëm për t’u mbrojtur dhe shpëtuar prej kurtheve të shejtanit. Shejtani dhe ndjekësit e tij do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të hedhur farë dyshimi në besimin tonë, ata nuk do të reshtin për asnjë moment të vetëm në përpjekjen e tyre për t’i zhveshur besimtarët nga besimi. Të gjithë peygamberët e kanë kaluar jetën e tyre duke luftuar këtë grupim i cili përpiqet për të hedhur dyshime në imanin e besimtarëve. **“Mos zini pusi në çdo rrugë, duke frikësuar dhe penguar nga rruga e Allahut ata që besojnë tek Ai dhe duke kërkuar shtrembërimin e saj! Kujtoni atëherë kur ishit të paktë në numër e Ai ju shumoi. Shikoni si përfundojnë ngatërrestarët!”** (Araf, 86)

Në fakt të gjitha rrugët në fund të çojnë tek Allahu, të gjitha rrugët në fund do të na çojnë para Allahut për gjykim. E rëndësishme është të ndjekim rrugën që Allahu ka përcaktuar për ne, vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtojmë nga dënimi dhe Xhehenemi. Ne duhet t’i lutemi vazhdimisht me sinqeritet Allahut që të na bëjë të qëndrueshëm në rrugën e drejtë.

Zoti në një hadith Kudsij thotë:

“Unë jam i Gjithëmëshirshmi dhe Mëshirëploti.

Emrin e farefisit, e kam marrë nga emri Im (rehim). Kush e ruan këtë lidhje (farefisninë) do të jetë në kujdesin Tim.

Kush e prish atë, është privuar nga përkujdesi Im.”

(Ebu Davud, Zekat, 45)

Islami i ka konsideruar marrëdhëniet farefisnore prej temave kryesore dhe më të rëndësishme të moralit.

Rahman dhe Rrahim, të cilët janë dy prej emrave të Allahut shprehin mëshirën gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme të Allahut. Nga e njëjta rrënjë vjen edhe fjala farefis. Kjo tregon që ruajtja e lidhjeve farefisnore ndihmon në zhvillimin e ndjenjës së mëshirës midis individëve të fisit. Ruajtja e lidhjeve fisnore është një urdhër hyjnor, i përforcuar në ajete kuranore dhe thënie profetike të ndryshme. Ruajtja e lidhjeve farefisnore përveçse një vepër e mirë është një faktor i rëndësishëm dhe luan një rol jetësor në marrëdhënien tonë me Allahun. Islami nxit që midis të afërmeve të ketë një komunikim të vazhdueshëm dhe konstruktiv. Në mbajtjen gjallë të marrëdhënieve farefisnore luan rol komunikimi i drejtpërdrejtë apo edhe indirekt. Ruajtja e marrëdhënieve farefisnore bën të mundur fitimin e mëshirë së Allahut, e cila shfaqet pastaj në formën e begatisë dhe mirësisë shpirtërore dhe materiale. Ndërprerja e marrëdhënieve farefisnore çon në ndërprerjen e marrëdhënieve me Krijuesin. Pra ndërprerja e marrëdhënieve me të afërmit nënkupton ndërprerjen e marrëdhënieve me Allahun dhe privimin nga mëshirë e Tij. Kur dihet që i gjithë universi funksionin dhe gjen jetë nga mëshira e Allahut.

Duke qenë kaq e rëndësishme në asnjë mënyrë nuk duhet gjetur justifikim për dobësinë e marrëdhënieve fisnore.

Allahu krahas interesit të përgjithshëm që

ka treguar ndaj marrëdhënieve farefisnore, një interes ë veçantë ka treguar ndaj marrëdhënieve me prindërit. Kur Abdullah ibn Mesudi e pyeti Profetin (a.s.), se cila është vepra më e mirë?: “Namazi në kohë”, iu përgjigj Profeti (a.s.). “Po pas kësaj, cila vjen?”, pyeti Ibn Mesudi. “Mirësjellja ndaj prindërve”, tha Profeti (a.s.). Nga ana tjetër, mosrespektimi i prindërve në Islam konsiderohet prej mëkateve të mëdha.

Mirësjellja ndaj prindërve nuk është e varur nga besimi i ndryshëm që mund të kenë ata. Ajeti kuranor thekson pikërisht këtë fakt. **“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: ‘Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë’. Nëse ata orvaten që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t’ju lajmëroj për atë që keni bërë.”** (Lukman, 14-15)

Kur sahabët u gjendën në dilemë në sjelljen ndaj të afërmeve që nuk ishin besimtarë, Allahu zbrit ajetin kuranor: **“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.”** (Mumtehine, 8)

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Lidhja farefisnore është shumë e rëndësishme në fitimin e mëshirë së Allahut.
2. Ndërprerja e lidhjeve farefisnore sjell privimin nga mëshira hyjnore.
3. Ruajtja e marrëdhënieve fisnore sjell përkujdesjen e veçantë të Allahut ndaj personit.



NJERËZIMI KA NEVOJË PËR ATË MORAL DHE QYTETËRIM MADHËSHTOR

MORALI QË KËSHILLON KURANI

Allahu i Lartësuar thotë:

“Me të vërtetë, ti je me virtyte madhore.” (Kalem, 4)

Allahu i Madhëruar është i vetmi mësues dhe edukator i të Dërguarit të Allahut (a.s.). Atë e ka edukuar Zoti (xh.sh.). Morali i tij i pashoq është kriter real dhe shembulli më ideal për njerëzimin.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Në të Dërguarin e Allahut është shembulli i mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit, prandaj e përmend shumë Allahun.” (Ah-zab, 21)

Morali i tij madhështor është busulla e udhëzimit që të shpie te pëlqimi i Allahut Teala, është çelësi i paqes e i lumturisë në këtë botë dhe i shpëtimit e i Xhenetit në botën tjetër.

Morali madhështor është një kandil udhëzimi që shkëlqen, një llambë ndriçuese që largon çdo lloj errësire.

Ne kemi nevojë për atë moral.

Ne duhet t’ia reflektojmë edhe njerëzimit atë moral madhështor në formë pasqyrash të pastra, duke e përjetuar vetë dhe duke i bërë edhe të tjerët ta përjetojnë, sepse:

NJERËZIMI KA NEVOJË PËR ATË

Meqë gjendemi në atmosferën e qetë të përkujti-

mit të ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut (a.s.), do të ishte me vend t’i përmendnim disa shembuj nga madhështia e moralit të tij dhe ta kontrollonim jetën tonë, duke e peshuar me moralin e Pejgamberit (a.s.).

Ne jemi të detyruar ta shprehim se gjuha jonë është e paafte për ta përkufizuar plotësisht moralin të lartë, domethënë, përfaqësuesin më të shkëlqyer të moralit të lartë, burimin e krenarisë së krijesave, atë që ishte dritë nga koka deri tek këmbët, të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Ajo që mund të bëjmë është që t’i hedhim disa pika uji fytyrës sonë të etur nga deti i mëshirës së pa-fundme duke u përpjekur t’i qetësojmë zemrat tona, sado pak qoftë.

MORALI I TIJ ISHTE KURANI

Kurani Fisnik është arti më kulmor i Allahut të Madhëruar në fjalën e Tij.

Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), është arti më kulmor i Zotit (xh.sh.), në krijimin e njeriut. Këto dy pasqyra prej drite / fjala dhe krijimi i Zotit (xh.sh.), reflektojnë njëra-tjetrën.

Allahu i Madhëruar thotë:

“O ju që keni besuar! Mos nxitoni (me fjalët dhe veprat tuaja) para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij (pranojeni si kufi të pacënueshëm urdhrin e Allahut



dhe sunetin e të Dërguarit të Allahut) **dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm.**” (Huxhurat, 1)

Ndërsa ky hadith fisnik bën komentimin e ajetit të mësipërm:

“*Fjala më e bukur është fjala e Allahut. Rruga më e drejtë është rruga e Muhamedit.*” (Buhari, l’tisam, 2)

Kjo do të thotë se krahas Librit të Allahut, Suneti dhe morali i lartë i Profetit (a.s.), i japin drejtim jetës sonë dhe janë kriteret për të njohur kufijtë.

Jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.), e cila është she-mbull për çdo besimtar deri në Ditën e Kiametit, gjithmonë ishte e thjeshtë. Ajo ishte larg ekstremimit.

Ai, me jetën e ibadetit që e kryente me modesti, na ka treguar përsosmërinë e nënshtrimit ndaj Allahut Teala. Jo vetëm me jetën e ibadetit, por edhe me modelin she-mbullor si kryefamiljar dhe administrues, me sjelljen e përkushtimit ndaj punës dhe shoqërisë, me pak fjalë, në të gjitha aspektet e jetës, Ai na ndriçon me dritën e tij.

Ja një shembull i vogël nga ajo dritë:

MË MADHËSHTORI, MË BUJARI

Krenaria e Gjithësisë, Profeti (a.s.), na përcjell këtë mesazh përmes një hadithi të tij fisnik:

“*Te një besimtar i vërtetë nuk mund të gjenden këto dy cilësi: Koprracia dhe morali i ulët!*” (Tirmidhi, Birr, 41/1962)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte më bujar se erë-rat. Edhe kur ishte në vështirësi, edhe kur e kishte

gjendjen mirë, gjithmonë jepte për hir të Allahut Teala. Në Medine, e cila ishte qendra e shtetit islam, kishte raste që vinin plaçkat e luftës, por i Dërguari i Allahut (a.s.), ua shpërndante ato të varfërve pa e arritur mëngjesin.

Grada më e lartë e bujarisë është dhënia e përparësisë në ndihmë të të tjerëve edhe kur familja e fëmijët e tu janë në nevojë. I Dërguari i Allahut (a.s.), përjetonte kulmin e altruizmit. Nevojave të

as’habu’s-suffas, të nxënësve të Kuranit, u jepte përparësi ndaj nevojave të vajzës dhe familjes së tij.

Po të dëshironte mund t’i jepte Ehli Bejtit aq sa t’ua plotësonte të gjitha nevojat, sepse nganjëherë mrekullitë e duarve të tij të bekuara i mbulonin me mirëqenie dhe begati të gjithë. Nganjëherë plaçkat e luftës që vinin me bollëk dhe mundësitë e pa-fundme që silleshin rreth e rrotull tij, ishin të mjaftue-shme, madje tepronin për t’u dhënë pjesëtarëve të familjes së tij një jetë pa asnjë vështirësi. Por Ai i jepte përparësi lumturisë së Ahiretit, e cila është jeta e vërtetë. Jepte aq shumë për hir të Allahut, sa që shpesh herë nuk i ngelte asgjë për vete.

Aishja (r.a) thotë:

“Familja e Muhamedit (a.s.), deri në momentin kur Ai ka ndërruar jetë, nuk e ka ngopur barkun me bukë elbi dy ditë radhazi.” (Buhari, Ejman, 22; Muslim, Zuhd, 22; Ibn Maxhe, Et’ime, 48)

Mundësitë materiale ishin vetëm një mjet për t’i mëshiruar krijesat, për ta lartësuar fenë e Allahut dhe për t’i motivuar të tjerët drejt udhëzimit.



Safuan bin Umejje, i cili ishte njëri prej të mëdhenjve të politeistëve kurejshë, u gjend pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), në luftën e Hunejnit dhe të Taifit, edhe pse nuk ishte bërë mysliman.

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut (a.s.), po shihte plaçkat e luftës që ishin mbledhur në Xhirane, vuri re se Safuani po e vërente me mahnitje të madhe një pjesë të tyre, prandaj e pyeti:

“A të pëlqeu shumë?”

Ai iu përgjigj: “Po.”

Nisur nga kjo, i tha:

“Merre, le të jetë e gjitha e jotja!”

Nisur nga kjo mirësi, Safuani nuk u përmbajt e tha:

“Asnjë zemër nuk mund të jetë kaq bujare përveçse zemra e Pejgamberit.”

Më pas deklaroi shehadetin dhe u bë mysliman.

Ndërsa, kur u kthye tek njerëzit e fisit të tij, iu drejtua atyre:

“O populli im! Nxitoni dhe bëhuni myslimanë, sepse Muhamedi po jep dhe po bën shumë mirësi pa pasur frikë nga varfëria dhe nevoja.” (Muslim, Fedail, 57-58; Ahmed, III, 107.)

MODESTIA MË E SINQERTË

I Dërguari i Allahut (a.s.), edhe pse ishte më i nderuari dhe më i larti i krijesave si “rob dhe i dërguar”, jetonte me një modesti mjaft të sinqertë. Edhe kur ishte i detyruar për t’i shprehur cilësitë e tij të larta, theksonte:

“Nuk ka lavdërim. Këto nuk i them për t’u lavdëruar.”

Në sajë të modestisë dhe mëshirës së gjerë, i çliroi zemrat e njerëzve nga çdo lloj ambicieje për sërë shoqërore. Shumica e myslimanëve të parë që i besuan atij ishin të dobët, të varfër dhe robër. Sipas këndvështrimit të tij ndaj njerëzimit, midis një fshatari beduin të ardhur nga shkretëtira apo një robi që sapo i ishte falur liria, nuk kishte asnjë ndryshim me njerëzit e pasur dhe prijësit. Ai i jepte përparësi vetëm pjekurisë shpirtërore, domethënë, devotshmërisë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), një mëngjes kur sahabët e nderuar ishin pranë tij, u ul në gjunjë te sofrat që ishte përgatitur. Një beduin që e pa këtë sjellje, u habit nga ajo ulje e kulturuar dhe u shpreh i çuditur:

“Ç’është kjo ulje kështu?!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Allahu Teala më ka krijuar si një rob të ndershëm, jo si një inatçi dhe shtypës!” (Ebu Davud, Et’ime, 17/3773)

Ai, si falënderim për moralin madhështor që ia dhuroi Allahu i Lartësuar, së pari e përhapri atë moral të lartë në një mënyrë që i la të mahnitur edhe armiqet e tij. Ai gjithmonë jetoi në një gjendje adhurimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit (xh.sh.).

Shembujt më të bukur të modestisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.), u dhanë në kohën kur Ai ishte më i fuqishmi dhe më i pushtetshmi.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte në kulmin e fuqisë dhe pushtetit material. Ai e çliroi Meken me një ushtri të përbërë nga dhjetë mijë sahabë të tij. Atë ditë një bashkëqytetar i frikësuar, i emocionuar dhe që dridhej duke kërcitur dhëmbët, i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ma mëso Islamin!”

Ai iu përgjigj me butësi duke i kujtuar këtë shembull nga koha kur mundësitë i pati më të pakta:

“Qetësohu vëllai im! Unë nuk jam mbret apo sundimtar. Unë jam jetimi i fqinjës tënde të vjetër prej kurejshve që hante mish të tharë në diell!..”

Modestinë e tij e ndiqte falja dhe mëshira.

FALJA MË SUBLIME

Ai ishte Pejgamberi i mëshirës, prandaj i fali ata që e patën gjuajtur me gurë. I fali edhe ata që patën vrarë Zejneben (r.a.). I fali edhe ata që e torturuan xhaxhain e tij, sepse ai ishte i ngarkuar me detyrë që ta bënte njerëzimin të meritonte faljen e Allahut Teala. Ai ishte një njeri që e donte faljen, sepse Ai mishërohej prej një morali të dhuruar nga Allahu i Madhëruar.

*“Qetësohu
vëllai im! Unë nuk
jam mbret apo
sundimtar. Unë
jam jetimi i fqinjës
tënde të vjetër prej
kurejshve që hante
mish të tharë
në diell!..”*

Ditën e çlirimit të Mekës, politeistët kurejshë nuk arritën t'i bënin asnjë rezistencë ushtrisë madhështore të Islamit. Për shkak se nuk kishin asnjë rrugëzgjdhje, u futën në Mesxhidu'l-Haram dhe po prisnin të shqetësuar ndëshkimin për padrejtësitë që bënë përgjatë 20 viteve.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i pyeti:

“O populli Kurejsh! O mekas! Çfarë thoni? Çfarë pëndeini se do të bëj me ju tani?”

Kurejshët i thanë:

“Ne mendojmë se do të shfaqësh mirësi dhe do të na trajtosh me mirësi, ndaj themi: ‘Ti do të sillesh me mirësi ndaj nesh.’ Ti je një vëllai i nderuar dhe bamirës. Ti je biri i një vëllai të nderuar dhe bamirës. Tashmë ke arritur fuqinë dhe pushtetin. Na trajto me mirësi!”

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), u tha:

“Gjendja ime dhe gjendja juaj do të jetë si gjendja e Jusufit dhe gjendja e vëllezërve të tij. Unë po ju them të njëjtat fjalë, siç u tha Jusufi vëllezërve të vet:

“Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!” (Jusuf, 92) (Ibn Hisham, Siret, IV, 32; Vakidi, Megazi, II, 835; Ibn Sa’d, Tabakat, II, 142-143)

Pejgamberi i mëshirës u dërgua në mesin e njerëzve që jetonin në errësirën e xhahilijetit dhe në një shoqëri agresive e injorante. Përgjatë gjithë jetës si profet, u dhunua dhe u ofendua pa mbarim. Por ai duroi, toleroi dhe shfaqti butësi.

DURIMI DHE BUTËSIA E PAFUNDME

I Dërguari i Allahut (a.s.), shpesh herë mernte borxh për të plotësuar nevojat e nevojtarëve prej umetit. Bilali (r.a.), e tregon kështu sakrificën dhe bujarinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilat kishin arritur pikën më të lartë të altruizmit:

“Që nga dita kur është dërguar si profet nga Allahu Teala e deri në ditën që ka ndërruar jetë, shumë punë të të Dërguarit të Allahut (a.s.), i kam kryer unë për të. Për shembull, kur i vinte ndonjë mysliman dhe e shikonte se ishte i varfër, më urdhëronte mua që të shkoja dhe të merrja borxh. Pastaj unë shkoja dhe merrja rroba e ushqime për atë...” (Ebu Davud, Haxh, 33-35/3055)

Marrja borxh e të Dërguarit të Allahut (a.s.), për t’u dhënë të tjerëve, shfaq virtytin e tij për t’u dalë zot nevojtarëve, edhe pse nuk kishte vetë. Kjo na tregon për një moral madhështor dhe është dispozitë në çështjen e marrjes së borxhit.

Ebu Saidi’l-Hudri (r.a.), tregon:

“Një beduin erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i kërkoi borxhin që kishte për të marrë, por kur e bëri këtë, shfaqti një sjellje agresive. Madje i tha:

“Deri sa të ma paguash borxhin, do vazhdoj të të shqetësoj.”

Sahabët e nderuar e qortuan beduinin dhe i thanë:

“Turp të të vijë! Me sa duket, ti nuk e di se me kë po flet!”

Beduini tha:

“Unë po kërkohem hakun tim.”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u tha sahabëve:

“Përse nuk mbani anën e atij që ka për të marrë të drejtën e tij?” Pastaj dërgoi dikë te Havle binti Kajs dhe i tha:

“Nëse ke hurma të thata, ma paguaj këtë borxh! Kur të na vijë hurmat, do të ta kthej borxhin.”

Havle tha:

“Patjetër! Babai im të qoftë falë, o i Dërguari i Allahut!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), ia pagoi borxhin bedunit dhe mbi të gjitha, i dha edhe ushqim për të ngrënë. Beduini, i cili u gëzua nga kjo sjellje, e shprehu lumturinë e tij duke thënë: “Borxhin e pagove në mënyrën më të mirë. Edhe Allahu ta dhëntë shpërblimin e plotë për këtë!”

Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Ja, këta (që e paguajnë borxhin e tyre ashtu siç duhet), janë njerëzit më të mirë. Një shoqëri, në të cilën të dobëtit nuk mund t’i marrin të drejtat e tyre pa u lënduar, nuk mund të shpëtojë...” (Ibn Maxhe, Sadakat, 17)

Ja një shembull i pashoq i drejtësisë dhe butësisë së të Dërguarit të Allahut (a.s.)...

Ai i shikonte mëkatarët dhe njerëzit e pasjellshëm si zogj të plagosur. Kështu që nuk prekej kurrë prej tyre. Ai përpiquej me butësi për ta larguar umetin nga zjarri i Xhehenemit dhe për ta shpëtuar nga injoranca, sepse ndërgjegjja e tij ishte e mbushur plot me ndjenjën e përgjegjësisë.

VETËDIJA E PASHOQE PËR PËRGJEGJËSINË

I Dërguari i Allahut (a.s.), e shikonte veten përgjegjës për të gjithë shoqërinë.

Sa dëshmitare fisnike janë këto shprehje të tij për butësinë dhe ndjenjën e përgjegjësisë që kishte ai:

“Unë jam më përpara madje edhe më afër çdo besim-tari, se ç’është ai me veten e tij. Nëse dikush lë pasuri

kur të ndërrojë jetë, ajo pasuri u përket të afërmeve të tij. Por nëse lë borxhe apo jetimë, ai borxh më përket mua. Edhe përkujdesja ndaj jetimëve është detyrë për mua.” (Muslim, Xhuma, 43; Ibn Maxhe, Mukaddime, 7)

I Dërguari i Allahut (a.s.), duke e ngarkuar të gjithë umetin e vet me përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit, ka thënë:

“Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete). Imami është çoban dhe përgjegjës për tufën e tij. Burri është çobani i familjes së tij dhe përgjegjës për tufën e tij. Gruaja, është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj. Shërbyesi është përgjegjës për pasurinë e pronarit të vet dhe për tufën e vet.” (Buhari, Ahkam 1; Muslim, Imaret 20)

Një çoban, bën kujdes në këto gjëra:

- Çobani e kupton gjendjen shpirtërore të tufës së vet.
- Çobani e lëshon tufën e vet në vende ku ka kullotë. Aty e lë të pushojë dhe të hajë dhe, nuk i lëshon në vende të thata.
- Çobani e ruan tufën e vet prej ujçërve dhe egërsirave.
- Çobani, edhe një qengj të sëmurë nuk i la ujçërve, por e merr në gji dhe e fut në tufë.
- Çobani ndonjëherë ecën para, e ndonjëherë pas tufës, duke e kontrolluar tufën për të cilën është përgjegjës.

Gjithashtu, edhe besimtari ka përgjegjësi ndaj atyre që ka nën vete:

- Ai i bën ata që të qëndrojnë dhe të shërbejnë në rrugën që do t'i çojë drejt mëshirës hyjnore, e jo në rrugën që do t'i largojë prej Allahut.
- Ai i ruan ata prej shejtanit, që është edhe armiku i përrjetshëm i njeriut.
- Nëse ata gabojnë, ai kujdeset për ta me dhembshuri, si të ishin zogj krahtyer. Ai i ngre ata që bien dhe i mbështet.

Duke i nxitur besimtarët që të kujdesen për të dobët e shoqërisë, Profeti (a.s.), thotë:

“Familja më e mirë ndër myslimanët, është ajo që sillet mirë me jetimin. Ndërsa familja më e keqe ndër myslimanët, është ajo që sillet keq me jetimin.” (Ibn-i

Maxhe, Edeb, 6)

Xherir bin Abdullahu (r.a.), tregon:

“Një ditë ishim mbledhur pranë të Dërguarit të Allahut herët në mëngjes. Atë moment ia behu një grup të mjerësh prej fisit Mudar. Në trupat e tyre gjendej një mbulesë e thjeshtë me vija, që i ngjante lëkurës së tigrin. Ata e kishin shpuar në mes këtë mbulesë dhe e kishin futur në kokë. Mirëpo, ishin pothuajse të zhveshur.

Kur i pa ata në një gjendje kaq të varfër, të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ndryshoi ngjyra e fytyrës. Ai hyri menjëherë në shtëpinë e tij dhe më pas e urdhëroi Bilalin (r.a.), të thërrasë ezanin. Bilali (r.a.) e thirri ezanin, e më pas ikametin. Pasi Profeti (a.s.),

fali namazin, u ngjiti në hutbe dhe këndoi këtë ajet fisnik:

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.” (Nisa, 1)

Më pas këndoi këtë ajet:

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen!..” (Hashr, 18)

Pas kësaj, ai tha:

“Të gjithë të japin sadaka prej arit, argjendit, veshjeve dhe sado pak qoftë, prej grurit dhe hurmave të tyre. Madje, të japë sadaka edhe në qoftë ajo një gjysmë hurme!”

Pa kaluar shumë, një person prej ensarëve, solli një çantë të rëndë, të cilën nuk e mbante dot. Të gjithë hynë në radhë njëri pas tjetrit për të dhënë sadaka. Në fund, pashë që u bën dy grumbuj me ushqime dhe veshje. Më pas, vura re se të Dërguarit të Allahut po i qeshte fytyra që i shndriste si flori...” (Muslim, Zekat, 69.)

Ndërsa sot, është detyra jonë ta bëjmë të buzëqeshë fytyrën e bekuar të Profetit tonë (a.s.). A e ndjejmë edhe ne përgjegjësinë e jetimëve, të vetmuarve dhe të pashpresëve dhe, a veprojmë në përputhje me atë



që kërkon të qenit umet i Profetit tonë (a.s.)?

A përçojnë zemrat tona mëshirë, si Ai? A përhapin gjuhët tona aroma trëndafil, si ai?

Sepse sot, në mënyrë të veçantë harrohet delikatasa e Profetit (a.s.):

MË DELIKAT SE TRËNDAFILAT, MË ORATOR SE BILBILAT

I Dërguari i Allahut (a.s.), ishte një njeri i mbushur me hijeshi, thjeshtësi dhe butësi. Bukuria, madhështia, shkëlqimi dhe thjeshtësia e tij ishin aq të larta, sa që nuk kishte nevojë për ndonjë mrekulli, argument dhe shenjë të veçantë se ai ishte Pejgamberi i Allahut Teala.

Në fytyrë kishte bukuri vezulluese, në fjalë kishte oratori, në sjellje kishte hijeshi, në gjuhë kishte gojë-tari, në fjalë kishte rrjedhshmëri dhe në biseda kishte elokuencë. Ai asnjëherë nuk thoshte fjalë të padobishme. Çdo fjalë e tij kishte urtësi dhe ishte këshillë. Në fjalët e tij asnjëherë nuk kishte thashetheme dhe gjëra të pavlera. Gjithmonë fliste sipas aftësisë së perceptimit të të gjithëve. Ishte i butë dhe modest. Asnjëherë nuk qeshte me të madhe duke e tepruar. Gjithmonë buzëqeshte. Ai që e shihte atë befasisht, kaplohej nga frika. Ai që takohej e bisedonte me të, ndjente dashuri në zemër dhe në shpirt.

Të folurit me këshilla të bukura, me fjalë të urta dhe me shembuj për t'i ftuar njerëzit në mirësi dhe për t'ua predikuar atyre Islam, ishte metoda e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Me mëshirën e gjerë të tij që i përfshinte të gjithë njerëzit dhe për hir të mirësisë, udhëzimit, shpëtimit, virtytit dhe humanizmit, i gjallëronte zemrat si shiu i begatshëm që bie ëmbël-ëmbël dhe rëndë-rëndë. Kur fliste me dikë, nuk kthehej nga ai vetëm me kokën, por me të gjithë trupin e tij.

Ai ishte njeriu që fliste më me oratori, më me koncizitet dhe më me urtësi se të gjithë të tjerët. Ai fliste në mënyrën më përmbledhëse, duke e shprehur në formën më të saktë përmbajtjen dhe qëllimin e tij.

Fjalët mbarojnë dhe boja thahet, por cilësitë e Atij Deti të Mëshirës nuk mbarojnë. Rruga më e vyer për t'ua dhënë njerëzve moralin madhështor të Atij është përpjekja për ta përjetuar vetë atë moral të lartë. Për të marrë pjesë nga përshpirtshmëria e tij, duhet ta përrjetojmë atë emocion.

Veçoria jonë, duhet të jetë parimi i Profetit (a.s.):
“Njeriu është me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96.)

Theubani (r.a.), ishte një rob. Mbase në këtë botë

nuk kishte qoftë edhe një pemë apo një çadër. Ai vinte pranë Profetit (a.s.), dëgjonte bisedën e tij, ndikohej prej saj dhe ikte. Më vonë, vinte përsëri, dëgjonte bisedën dhe ndikohej përsëri prej saj.

Një ditë, kur shkoi përsëri, Profeti (a.s.), e pa se ishte shumë i mërzitur dhe e pyeti:

“Si e ke hallin o Theuban?”

Theubani (r.a.), filloi të tregojë me gjithë shpirt:

“Të qofshin falë nëna, babai dhe kjo jeta ime o i Dërguar i Allahut! Unë ndikohem së tepërmi prej bisedave të tua. Kur shkoj në shtëpi më merr malli shumë. Çdo moment që kaloj larg dritës tënde, për mua është një ndarje më vete... Nëse në këtë botë është kështu, kam frikë se në botën tjetër do të jetë edhe më keq. Atje, ju do të jeni së bashku me profetët e tjerë. Ndërsa unë, nuk është e sigurt se si dhe ku do të jem. Mbi të gjitha, nëse nuk do të hyj në xhenet, do të privohem plotësisht prej teje. Kjo frikë më djeg e më përcëllon o i Dërguari i Allahut!”

Profeti ynë (a.s.), heshti për pak çaste dhe më pas tha:

“O Theuban! Njeriu është me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96; Muslim, Birr, 165)

Duhet të llogarisim se sa e kemi përvetësuar kuptimin e këtij parimi...

Dashurinë tonë duhet ta matim me bashkimin tonë, ndërsa bashkimin tonë duhet ta krahasojmë me dashurinë tonë.

Duhet të pyesim:

Sa kemi përfituar prej botës shpirtërore të Profetit të Allahut (a.s.)?

Sa hise kemi prej jetës, gjendjes shpirtërore dhe personalitetit të asaj drite?

SA KEMI PËRFITUAR NE?

Si është pjekuria shpirtërore e adhurimeve tona?

Pra, a na çojnë adhurimet tona drejt pasionit dhe thellësisë së ndjenjave? Sa e arrijmë përkushtimin dhe qetësinë e zemrës?

Në çfarë niveli është delikatasa e veprave tona?

Sa arrijmë t'i bëjmë zemrat tona vend mëshire? Sa mëshirë shpërndajmë prej atij vendi? A kurorëzohen veprat tona me “Allahu qoftë i kënaqur!”, apo përfundojnë me “Të qoftë haram hakun tim!”?

Në çfarë niveli është delikatasa e moralit tonë?

A është delikatasa që shfaqim ndaj të tjerëve në të njëjtin nivel me mirësjelljen që presim prej tyre? A kemi arritur të shpëtojmë prej egoizmit dhe mendjemadhësisë? A është e sinqertë modestia jonë?

Në çfarë thellësie është butësia e zemrave tona?

Sa arrijmë t'i përshijmë në gjirin tonë të gjitha krijesat? Sa kemi arritur t'i bëjmë zemrat tona vend për nevojtarët e të vetmuarit? Sa përfshirëse dhe sa ndikuese është mëshira jonë?

Sa e ndritshme është drita në fytyrat tona?

Sa kemi përfituar ne prej përkufizimit që jepet në ajetin fisnik ku numërohen cilësitë e besimtarëve që janë bashkë me Profetin tonë (a.s.):

“...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes...”
(Fet'h, 29)

Në çfarë harmonie dhe rrjedhshmërie janë fjalët në gjuhët tona?

Sa paqe shpërndajnë gjuhët tona ndaj shpirttrave? Sa qetësi u japin fjalët tona atyre që kemi përballë?

Në çfarë niveli është delikatesa e ndjenjave tona?

A jemi të vetëdijshëm se të gjitha krijesat na janë lënë amanet? Çfarë pjekurie ka kujdesi ynë ndaj ajeteve të Allahut, ndaj përgjegjësive tona dhe ndaj exhelit e kizametit që po afrohen? A na dridhen zemrat? A na lotojnë sytë?

Në cilat horizonte ndodhet thellësia e shikimeve tona?

Sa arrijnë zemrat tona të shohin madhësitinë e shfaqjeve hyjnore, fuqinë dhe bukurinë e tyre? Sa e zbatojmë urdhrin **“Lexo!”**?

Në jetën e tasavufit, një nga treguesit më të rëndësishëm të zhvillimit të zemrës, është edhe përparimi në meditim, sepse tasavuf, do të thotë të pajisesh me moralin e Profetit (a.s.), të marrësh hise prej frymëzimit të tij shpirtëror. Dhe kjo, bëhet shkak që niveli i zemrës të përparojë në ngritje. Si rezultat i përparimit të zemrës, arrihen edhe majat e meditimit.

Atëherë duhet pyetur:

Sa kemi arritur të shpëtojmë prej njohurive sipërfaqësore e të thata dhe prej dijes së padobishme? Sa kemi arritur të njohim të fshehtat dhe urtësitë?

Shkurtimisht:

Sa kemi përfituar prej moralit të lartë dhe detit të gjerë shpirtëror të Profetit tonë (a.s.), për të cilin ajeti

fisnik shprehet duke e lavdëruar: “(O Muhammed!) Padyshim se ti je me moral të lartë!” (Kalem, 4.)?

Sa gjenden tek ne prej të gjitha bukurive të atij Profeti të lartë, prej zemrës së të cilit rridhte mëshirë për botët?

Dy njerëz i dhanë selam Selmanit dhe e pyetën:

“A je sahab i të Dërguarit të Allahut (a.s.)?”

Ai iu përgjigj: “Nuk e di.”

Të ardhurit dyshuan se mos i ishin drejtuar ndonjë njeriu të gabuar. Selmani (r.a.), e vijoi kështu fjalën e tij:

“Unë e kam parë të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe kam marrë pjesë në kuvendet e tij. Por sahab i vërtetë i të Dërguarit të Allahut (a.s.), është ai njeri që mund të hyjë në Xhenet bashkë me të.” (Hejthemi, VIII, 40-41; Dhehebi, Sijer, I, 549)

Ndërsa hyrja bashkë me Atë në Xhenet, është e lidhur me bashkimin e mënyrës së jetesës sonë me jetesën e Atij në besim, ibadet, moral dhe vepra. Nëse sot mund ta perceptojmë dhe gjallërojmë me një vetëdije të tillë ditëlindjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe shumë ditëlindje të tjera të tij, atëherë do të thotë se kemi përfituar siç duhet nga epoka e lumturisë.

Domethënë, ne mund të përfitojmë nga ai duke marrë pjesë nga përshpirtshmëria e tij dhe duke e përjetuar me devotshmëri këtë pjesë.

Allahu i Lartësuar e ka nderuar njeriun. Robi nderohet duke kaluar etapa në drejtim të adhurimit, moralit dhe veprave të mira që gjenden në rrugën e drejtë të të Dërguarit të Allahut (a.s.). Në këtë mënyrë arrihet gjendja e kërkuar dhe sublime për të hyrë në Xhenetin e mrekullueshëm.

Allahu Teala na bëftë prej atyre që jetojnë me këtë përshpirtshmëri!

Zoti (xh.sh.), na bëftë prej robërve që marrin pjesë nga morali i të Dërguarit të Allahut (a.s.)! Gjithash-tu, na e mundësoftë dhe lehtësoftë për t'u bërë si vëllezërit e tij, që i merr malli dhe që dëshirojnë ta shohin atë!..

Amin!..

A është delikatesa që shfaqim ndaj të tjerëve në të njëjtin nivel me mirësjelljen që presim prej tyre? A kemi arritur të shpëtojmë prej egoizmit dhe mendjemadhësisë? A është e sigurtë modestia jonë?

Allah

EMRI GJITHËPËRFSHIRËS

Ilir Hoxha

الله

Allahu është Ai, ekzistenca e të Cilit është nga vetvetja dhe e detyrueshme. Ai është shkaku themeltar i çdo gjëje që ekziston. Po ashtu, Ai është edhe pika absolute e lidhjes së perceptimeve tona me faktin se Ai është genia e vetme e vërtetë. Nëse përpiqemi të kuptojmë diçka pa llogaritur Atë, jemi të detyruar që atë gjë t'ia atribuojmë diçkaje që nuk është e vërtetë. Nisur nga kjo, dija dhe kultura jonë që nuk të çon në teuhit/njëshmërinë e Allahut, janë vetëm mendime, dy ekstremet e të cilave nuk puqen kurrë bashkë. Dhe, maksimumi ku mund të arrijmë, është pakuptimshmëria.

Prej Tij vijmë, tek Ai do të shkojmë. Asnjë punë që nuk fillon me emrin e Tij nuk arrin synimin e vërtetë. Kur fillojmë ta shohim ekzistencën tonë duke llogaritur edhe Atë, ndryshon fund e krye edhe botëkuptimi ynë për jetën. Tashmë, kurrë nuk do të jemi më njeriu i dikurshëm. Ky ndryshim, reflektohet edhe në gjuhën tonë të përditshme. Kur shprehim gëzimet, hidhërimet, habitë, frikërat, zhgënjimet, etj, gjithmonë fillojmë të përmendim Atë. (Hasbunallah, evvelallah, mashaAllah, fesubhanallah, inshaAllah, Ja Allah, La haule ue la ku'ute illa billah, elhamdulillah, estagfirullah...) Kjo gjuhë, jo vetëm që reflekton besimin brenda nesh, por edhe na e forcon atë.

Ashtu si Vetë Allahu, i Cili vjen para të gjithë emrave dhe cilësive të Tij, ashtu edhe emri "Allah", vjen para të gjithë emrave dhe cilësive të tjera, duke i përfshirë të gjithë ata. Kush thotë "Allahu", e ka përmendur Atë me të gjithë emrat e tjerë. Pra, ai strehohet me të gjithë emrat e Tij që dihen dhe nuk dihen. Rëndësinë shpirtërore të emrit "Allah", e shohim edhe në këtë dua të Profetit tonë (a.s.):

"O Allah! Strehohem dhe të përgjerohem me atë emër të pastër, të bukur, e të bekuar, të cilin e do shumë, që kur të bëhet dua me atë emër Ti i pranon, kur të kërkohet me atë emër Ti jep, kur të kërkohet mëshirë me atë emër Ti mëshiron dhe kur të luten për shpëtim me atë emër Ti i shpëton." (Ibn Maxhe, Dua, 9.)

Në fakt, ekziston një "Allah" në mendjet tona dhe

"Allahu" i vërtetë.¹ Por për të njohur "Allahun" e vërtetë, ka vetëm një mënyrë. T'i vëmë veshin se si e ka prezantuar Ai Vetën e Tij... Pra, hapi i parë për të njohur Allahun, është kuptimi i Kuranit.²

Sipas Kur'anit, për të qenë prej atyre që "besojnë", nuk mjafton vetëm të besosh ekzistencën e Allahut. Por duhet ta besosh Allahun ashtu siç e meriton. Dhe ky kusht i domosdoshëm i besimit, është që një cilësi e cila i përket vetëm Allahut, të mos ia atribuosh askujt tjetër përveç Tij.³

Ai që e njeh Zotin e vet me të gjithë emrat e Tij, e di se, ashtu si nuk ka "asgjë tjetër që adhurohet përveç Allahut", nuk ka askush tjetër që "di çdo gjë përveç Allahut", "që ka fuqi për çdo gjë", "që dëgjon dhe sheh çdo gjë" dhe "që mbizotëron çdo gjë"...

Të urtët, ekzistencën e shohin si manifestim të emrave të Allahut. Sipas tyre, besimtarët përfitojnë prej manifestimeve të emrave në varësi të gjendjes së tyre shpirtërore. Emri që përfshin të gjitha cilësitë e Zotit është emri Allah.

Ata që janë vazhdimisht në ndikimin e fjalës Allah njihen si "njerëz të përsosur", ndërsa në psikologjinë e sotme, njihen si "njerëz të vetrealizuar". Ky, është një njeri që ka arritur të shndërrojë kontradiktat dhe kundërshtimet, në unitetin e teuhidit dhe po ashtu, ka arritur edhe paqen e plotë.⁴

Njeriu që dëshiron që manifestimet e këtij emri të shfaqen tek vetja e tij, duhet të përpiqet me sa ka mundësi, të pakësojë të metat dhe të shtojë virtytet. Ndërsa kjo, bëhet e mundur në sajë të një besimi të plotë në Allahun dhe në sajë të atyre që lindin prej kësaj, si pasioni për adhurimet dhe mbizotërimi i egos. Pa treshen besim-adhurim-moral, nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë përsosmëri. Kjo përsosmëri, është kushti i domosdoshëm për t'iu afruar Atij, sepse Allahu, është aq përtej kësaj bote, saqë për të formuar lidhje me ne, është e nevojshme që Ai të zbrësë, ndërsa ne të përsosemi.

1. -shih. Saffat, 180.

2. -shih. Bekare, 255; Hashr, 22-24.

3. -shih. Isra, 42.

4. -shih. Fexhr, 27.



Kjo botë pa Ahiretin: **KATASTROFË PËR NJERËZIMIN**

.....
M. Ali Eshmeli
.....

Ahireti: E mëpasshmja absolute e çdo gjëje. Përfundimi i pandryshueshëm drejt të cilit shkon çdo gjë dhe gjithkush. Kur njeriu nuk e pa atë, nuk e llogariti, apo e harroi, atëherë u fundos në çdolloj fatkeqësie.

Që prej Xhenetit e deri më sot, kjo e vërtetë qëndron në skenë. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, i parajlmëroi që të dy ata për të ardhmen:

“O Adem, me të vërtetë që ky është armiku yt dhe i gruas sate, prandaj mos e lini t’ju nxjerrë kurrsesi nga Xheneti, se pastaj do të vuani në mjerim!” (Ta-Ha, 117)

Për fat të keq, pavarësisht kësaj të vërtete që u tha Krijuesi, i Cili i vendosi ata në Xhenet midis të mirave, shejtani e gjeti mënyrën dhe i cyti:

“...O Adem, a do të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?” (Ta-Ha, 120)


Në sajë të këtij kurthi joshës dhe tinëzar, Iblisi arriti të zgjojë në egon e Ademit (a.s.), një kureshtje. Pas kësaj:

“Shejtani u pëshpëriti, për t’ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: “Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm.” Dhe iu betua atyre (duke u thënë): “Vërtet, Unë jam për ju këshillues i singertë!” Dhe i mashtrroi me dinakërinë e tij.

Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit dhe Zoti i tyre i thirri: “A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?” (A’raf, 20-22)

“Zbritni prej aty si armiq të njëri-tjetrit!” (A’raf, 24)

Në këtë mënyrë, ata u nxorën prej Xhenetit. Kjo, ishte fatkeqësia e parë njerëzore.



“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar.”

(A’la, 16-17)

Kjo ishte një fatkeqësi e rëndë për shkak të pakujdesisë ndaj atyre që kishte paralajmëruar Allahu për të ardhmen. Fatkeqësia e nxjerrjes prej Xhenetit për shkak të kaplimit prej vesveseve dhe mendimeve djallëzore dhe shkuarja pas një “të ardhme” të stisur dhe të rremë me një shqetësim të habitshëm.

Vetëm në sajë të pendimit arriti ta merrte veten biri i njeriut.

Mirëpo:

Kjo botë e përkohshme, u bë shkolla e një provimi të vështirë në boshtin e të mëparshmes dhe të mëvonshmes. Në atë shkollë, Allahu i Madhëruar, i Cili është Krijuesi dhe mësuesi i vetëm i njerëzimit, i shpalli njeriut:

“Padyshim se, jeta e ardhshme, për ty është më e mirë se kjo jetë!” (Duha, 4.)

“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amshuar.” (A’la, 16-17)

Sa keq!..

Biri i Ademit (a.s.), Kabili, i cili nuk arriti ta kuptonte shkakun e nxjerrjes së prindërve të tij prej Xhenetit, nuk arriti ta shihte as këtë të vërtetë hyjnore. Ai u zhyt në këtë botë në një mënyrë indiferente dhe nuk e vuri ujën në zjarr për Ahiretin. Zemra e tij u ngurtësua. Dhe, më në fund e humbi vlerën “krijimi më i bukur” dhe smiroi vëllain e vet, i cili ishte më i virtytshëm se ai. Më pas, kjo ndjenjë e çoi deri aty sa ta vriste vëllain e vet. Bota e tij, pas së cilës rendte,

u shkatërrua. Por bashkë me të, u shkatërrua edhe ahireti i tij...

Ai nuk arriti ta dallonte “të ardhmen e vërtetë”, për shkak të indiferencës së vet. Për rrjedhojë, kjo ishte një tjetër fatkeqësi për njerëzimin.

Ditët kaluan:

Njerëzit u shtuan dhe përsëri lakmia për këtë botë, ia kaloi asaj për ahiretin. Të gjithë u bënë indiferentë ndaj së ardhmes së vërtetë. Jeta pa menduar fundin e saj, i nxori nga rruga bijtë e Ademit (a.s.):

- U bënë idhujtarë.

- Filluan padrejtësitë dhe i kaluan kufijtë.

- U zhytën në gjynahe pa ngurruar fare, duke thënë se, “askush s’ka të drejtë të përzihet në punët tona”.

- Me thirrjet e tyre për “liri” ndaj Allahut, u bënë skllëvër të egove të veta dhe të shejtanit.

- U zhytën në çdolloj pune të keqe dhe poshtërsitë e tyre i zbukuruan si nuse.

- Ndërgjegjet e tyre u bënë monstrooze.

- Ata u verbuan edhe ndaj fatkeqësive më të qarta të mëhershme dhe të mëvonshme.

- Ata u shurdhuan.

- Mbi të gjitha, ata u bënë këmbëngulës në rebelim dhe mohim.

- Ndërsa përball mëshirës dhe udhëzimit, u bënë armiqtë më idhnaqë.

Në fund, u shfaq një rezultat shumë i hidhur:

Tufani: fatkeqësia që e mbyti tokën me ujë.

Të gjithë ata që nuk hipën në anijen e shpëtimit të Nuhut (a.s.), u mbytën në kthetrat e poshtërimit.

Kur e panë këtë, të gjitha frymët e vdekshme në këtë botë, u vendosën në vijë si tesbihë adhurimi. Tashmë, të gjithë ata që jetuan, e konceptuan këtë botë vetëm si arë përgatitjeje për Ahiretin.

Ndërkohë, ditët kaluan përsëri:

Kësaj here, në atë arë mbinë vreshtat e famshme të Iremi, ku dolën në pah bukuri të mrekullueshme dhe shumë tërheqëse. Njerëzit që u joshën prej atyre bukurive, e harruan përsëri Ahiretin. Bota filloi përsëri të jetohet pa ahiretin. Ata u mërzitën dhe u zemëruan prej paralajmërimeve hyjnore që u dërgoheshin nga qielli dhe prej personaliteteve të larta e të pastra që ua transmetonin ato.

Ata kundërshtuan me ashpërsi dhe u rebeluan. Ndërsa të Dërguarin e Allahut dhe mëshirën e udhëzimit që solli ai, e akuzuan me njëmijenjë faje në mënyrë të habitshme:

- Ti je i devijuar.
- Ti je i çmendur.
- Ti je gënjeshtar!¹

Sepse:

Ata ishin lazdruar shumë me fuqitë e tyre të përkohshme dhe ishin indiferentë ndaj Fuqisë Hyjnore dhe botës tjetër. Ata nuk donin t'u prishej jeta e tyre e shturur. U frynë me mendjemadhësi e mohim dhe filluan të flisnin pa logjikë:

- A të braktisim zotat tanë dhe të bëhemi robër të Allahut?²
- E kush është më i fortë se ne?³
- Jeta është vetëm në këtë botë. Ç'është kjo ringjallje pas vdekjes?⁴

Këto përcartje të tyre indiferente ndaj "të ardhmes së vërtetë", u bënë shkak i dënimit hyjnor ashtu siç ndodhi edhe me të tjerët para tyre. Allahu dërgoi një furtunë të tmerrshme.

- Një furtunë e zhurmshme.

1. - shih. A'raf, 60-66.

2. - shih. A'raf, 70.

3. - shih. Fussilet, 15.

4. - shih. Mu'minin, 37.

- Një erë që edhe të ngrinte, por edhe të digjte.

- Një katastrofë që bënte pluhur e hi çdo gjë mbi të cilën kalonte.⁵

"(një furtunë) që i shkulte njerëzit, sikur të ishin trungje hurmash të çrrënjësura." (Kamer, 20)

Kjo ishte një fatkeqësi tjetër njerëzore. Një fatkeqësi e hidhur që solli jeta e menduar pa Ahiret. Ky ishte një mësim që ta sjell mendjen në vend!.. Ata që morën mësim erdhën në vete dhe vazhduan të jetonin përsëri me mendje dhe me zemër në rrugën e drejtë.

Pas kësaj përsëri kaluan ditët:

Dhe përsëri u harrua arsyeja e atyre fatkeqësive që ndodhën. Biri i Ademit (a.s.), filloi të rendte përsëri pas një jete pa Ahiret. Si fillim, për shkak të dëshirës për të jetuar pa Ahiret, ata i ndërruan konceptet e tyre në lidhje me fatkeqësitë që u kishin rënë dhe thanë:

"Të parët tanë u shkatërruan sepse nuk kishin ndërtuar shtëpi të forta. Lidhur me këtë, ne kemi marrë masat e duhura. Tashmë furtunat nuk do të na dëmtojnë në asnjë mënyrë. Askush të mos shqetësohet, sepse jemi të gjithë të sigurt."

Këto mendime arrogante, zunë rrënjë në vetëdijet e tyre.

Në fund, për shkak të ndjenjës së tepërt të sigurisë dhe besimit në vetvete, ata devijuan përsëri nga rruga e drejtë dhe orientimi kah Ahireti:

- Prishjen e treguan si një ideologji joshëse dhe u rebeluan ndaj Krijuesit.
- Pretenduan se ishin më superiorë dhe u tallën me profetët e tyre.
- Mendimet e veta i konsideruan më të çmuara se të vërtetat hyjnore.
- Nuk ua vunë veshin këshillave hyjnore.
- U mbushën me urrejtje ndaj atyre që zgjodhën rrugën e drejtë.
- Ata qëndruan pranë grave që i nxitnin në devijim.
- U bënë robër të pasurisë dhe pronës.
- Shkelën premtimet e dhëna.

5. - shih. Fussilet, 16; Kamer, 19; Dharijat, 41-42.



- U treguan mosmirënjohës ndaj amanetit dhe mirësisë, duke i tradhtuar ato.

- E braktisën të mirën dhe vrapuan pas së keqes.
- Nuk i penguan punët e këqija.
- Nuk u kujdesën për të drejtën e robrit.
- U bënë çerdhja e çdolloj të keqeje.

Me gjithë këto poshtërsi dhe të këqija, ata e konsideruan veten si më të zgjuarit, më të drejtët, më të logjikshmit, më të diturit, më të maturit dhe si njerëzit më normalë. Për rrjedhojë, ata çfarë nuk i punuan dhe nuk i thanë të Dërguarit të Allahut, i cili në çdo aspekt ishte më i pastri, më i bekuari, më i respektuari dhe burimi i udhëzimit:

- Njeri gënjeshtar dhe i lazduar.
- Njeri që i është bërë magji.
- Nëse shkojmë pas tij, do të bëjmë një marrëzi dhe do të devijojmë.⁶

Përfundimi:

Edhe ata pësuan dënimin hyjnor. Allahu i Madhëruar urdhëroi dhe:

- Ata i përfshiu një zë i frikshëm prej të cilit nuk mund të shpëtonte njeri.
- Ranë mbi gjunjë dhe mbetën ashtu, duke u kthyer në rrënoja që merren para nga vërshimet.
- Përveç këtyre, ata u goditën edhe nga një tërmet shumë i fortë.
- Një lëkundje e frikshme.
- Të gjithë ranë me fytyrë përtokë dhe ashtu mbetën.⁷

Përsëri u përjetua një katastrofë e hidhur njerëzore. Një katastrofë e hidhur për shkak të dëshirës për të jetuar pa Ahiret. Por përsëri ata që u shpëtuan nga Allahu morën mësim të mëdha. Në këtë mënyrë rrotullohej bota.

Përsëri kaluan ditët dhe përsëri njerëzit i harruan këto katastrofa të hidhura. Gjithashtu, përsëri u shkatërruan shumë indiferentë, tiranë, mosmirënjohës dhe mohues në darën e katastrofave të ngjashme.

Si përfundim:

Me harrimin e Ahiretit dhe me verbërinë ndaj vdekjes, thelbi i njeriut u mposht nga djallëzitetë “nemrudiane”, u mbyt në “faraonizëm” dhe u kap nga sëmundja “ebu xhehiliane”. Të gjithë u shkatërruan për hir të kësaj bote që kalon sa hap e mbyll sytë dhe të dëshirave egoiste. Edhe masat e njerëzve që u mblodhën rreth tyre, edhe vetë ata, u bënë vetëm shkaktarë të katastrofave njerëzore.

6. - Kamer, 24-25; Shuara, 153.

7. - Mu'minûn, 41; Hud, 67; A'raf, 78.

Përsëri kaluan ditët dhe banorët e tokës përsëri e harruan Ahiretin. Tani, bota ndodhet përsëri në mes të një katastrofe tjetër njerëzore:

Njerëzimi po përplaset me njëri-tjetrin rreth boshtit të jetës pa ndjenja, vrasjeve, padrejtësive dhe luftërave për interesa. Tiranë që lazdrohen dhe egërsohen duke u mashtruar prej forcës së tyre tri ditëshe dhe që dërgojnë në varre duke copëtuar edhe ata që janë ende në djep.

Përsëri nuk arrijnë të shohin:

Kush do të shkatërrohet nesër si rezultat i thirrjeve për ndihmë dhe rënkimeve që ngrihen prej çdo cepi?

Në fakt, ata indiferentë të pashpirt, që kanë bërë shënjestër të bombave të tyre me miliona të pafajshëm në vendet Islame, janë të dashuruar pas zjarrit të Xhehenemit si peshq të hutuar.

Peshq!

Megjithëse po mashtrohen kaq shumë prej të gjitha karremave që ka hedhur shejtani prej mijëra vitesh, për fat të keq ende nuk kanë mësuar të mos mashtrohen. Pavarësisht gjithë atyre shembujve të hidhur dhe katastrofave e fatkeqësive që janë përjetuar para syve të tyre prej mijëra vitesh, peshqit e hutuar ende nuk kanë mësuar të mos bien pre e karremave të përkohshme të kësaj bote. Mosmirënjohësit dhe mizorët, nuk arritën ta kuptonin katastrofën e vërtetë edhe pas gjithë atyre shfaqjeve të hakmarrjeve hyjnore.

Mirëpo, dera e vetme e paqes në këtë botë dhe në tjetrën, është një jetë e devotshme me besimin në ahiret.

Atëherë, viti i ri, nuk është viti i harrimit të ahiretit. Nuk është as viti i rehatisë dhe kënaqësisë së kotë, i argëtimit të çmendura ose i jetës së zhytur në vorbullën e padrejtësive.

Në të vërtetë, çdo dëshirë, mendim, ideologji, tifozeri dhe fiksion që i shpie robërit drejt katastrofës njerëzore në këtë botë shumë të shkurtër, le të mbështillet me çfarëdolloj ambalazhi të dëshirohet, ato prap janë humbje në të dyja botët.

Zgjidhja:

Shqetësimi dhe përgatitja për ahiretin gjatë gjithë jetës.

Zgjidhja:

Të jetosh këtë jetë, jo sipas “ardhmërive të rreme”, të stisura nga filozofitë e kota, por sipas “ardhmërisë absolute dhe të vërtetë”, që ka caktuar Allahu i Madhëruar.

Atëherë, në botë do të mbizotërojë paqja. Ndërsa njeriut do t'i hapen deri në fund dyert e Xhenetit.

O Zot! Na e bëj të mundur! Amin!..

Ruani veten dhe familjen

Nuredin Nazarko

Një nga çështjet e ndjeshme, që shqetëson gjithësecilin që beson se ka prekur truallin e së vërtetës, është shqetësimi për të sakrifikuar që frytet e këtij trualli, të arrijnë në sa më shumë banorë të tokës.

Kjo ndjesi, është mëse normale, pasi që çdokush që ka prekur këtë truall nuk e ka arritur me forcat e veta, me sakrificat e veta apo të të tjerëve. Arritja në këtë truall, ngrënia prej frutave të tij është një kënaqësi prej së cilës edhe të duash, nuk mund të largohesh dot kurrsesi, vetëm në qoftë se diçka nuk shkon me zemrën e njeriut. Sidoqoftë, le ta marrim të mirëqenë se kush e ka prekur këtë truall, nuk mund të largohet prej aty. Kushdo që jeton me frytet e këtij trualli, shpreson të njëjtën gjë edhe për të tjerët, sepse asnjë shpërblim dhe asnjë çmim monetar nuk duhet paguar për të qenë pjesë e truallit të së vërtetës, ngaqë e vërteta është e hapur ndaj çdokujt dhe mirëpret çdokënd, mjafton që ta lërë pas vetveten, për të gjetur njeriun.

Kur njeriu prek këtë truall shndërrimi dhe transformimi nuk mund të mos jenë tashmë pjesë e pandarë dhe

e vazhdueshme e jetës së njeriut. Ky transformim dhe shndërrim përjetohet më së shumti në fazat e hershme të prekjes së truallit, kur ti ende je i mrekulluar me ato çfarë je duke parë e përjetuar. Aq shumë ndihesh i mrekulluar, saqë tashmë mendon se misioni i vetëm që ke për të realizuar është, tu bësh me dije të tjerëve se çdo të thotë të jetosh në truallin e së vërtetës, e ç'është do të thotë të ushqehesh me frytet e këtij trualli.

Ky shqetësim ndoshta nuk të lë të flesh gjumë rehat, nuk të mban në shtëpi, por gjithmonë të vë në lëvizje jashtë saj, duke u takuar e duke u ulur me të tjerë, për tu bërë të ditur se ç'është e vërteta. Kështu rrjedh koha, dhe në rrjedhën e saj gjithmonë e më tepër i fokusuar në shpëtimin e të tjerëve. Gjithë energjinë, forcën, përpjekjet e sakrificën i drejton pikërisht drejt këtij shqetësimi, në mënyrë që sa më shumë njerëz të dëgjojnë prej teje mesazhin e asaj çfarë mendon se do t'i shpëtojë nga e keqja e vetvetes.

Duke e mbushur kohën vazhdueshmërisht me shqetësimin për të mirën e të tjerëve, dalëngadalë venitet përkujdesi ndaj vetes, venitet aq shumë, saqë fillon e beson se nuk ke më nevojë ta vendosësh veten në tehun e kritikës dhe t'i parashtrosh asaj problemet që shqetësojnë çdo qenie njerëzore, sepse askush nuk mund të jetë i paprekshëm nga disfatat, problemet, shqetësimet dhe dilemat morale. Përyshimi i vetes nga nevoja për reflektim dhe ndryshim, është tregues i rënies pre të besimit se kushdo që njeh dhe prek truallin e së vërtetës është i vetëmjaftueshëm dhe tashmë nuk ka më nevojë të përpiqet të ndryshojë dhe transformojë veten, por vetëm të tjerët derisa të prekin truallin e së vërtetës.

Kjo frymë është një nga më shkatërrueset për qenien njerëzore, pasi që nuk i jep mundësinë të kritikojë vetveten dhe t'i gjejë asaj të metat që ka. Kushdo që i shkon pas kësaj fryme, beson se problemi janë gjithmonë të tjerët, ata të cilët ekzistojnë jashtë tij apo saj. Nisur nga ky stereotip mundësia për të prodhuar konflikte deri dhe me njerëz të afërt brenda familjes është mëse evidente. Këtu qëndron dhe paradoksi i gjithësa veprojnë sipas kësaj fryme.

Të përkushtuar deri në maksimum për të shpëtuar të tjerët nga mosprekja e truallit të së vërtetës, të pashqetësuar për veten dhe njerëzit më të afërt, që e meritojnë më së shumti përkujdesjen, përkushtimin, durimin dhe sakrificën, për tu parashtruar një model jete ashtu siç e vërteta e kërkon dhe jo një model ku pikërisht këta të afërt janë të fundit përsa i takon

përkujdesjes për t'ua kumtuar kënaqësinë e të qenit pjesë e jetesës në truallin e së vërtetës. Rendja për të shpëtuar të tjerët nuk iu lë as kohën e nevojshme për të përmirësuar edukatën e vetvetes.

Të mirë me të tjerët, të butë e të sjellshëm se duhet tu kumtojmë të vërtetën. Të ashpër, fodullë e moskokçarës me ata që na gjenden pranë në kohë të mira e të vështira, pa kushte, pa interesa dhe me gjithë qenien dhe shpirtin e tyre, pavarësisht se ende nuk e kanë prekur si duhet truallin e së vërtetës. Të edukuar e të kulturuar kur flasim e bisedojmë me të tjerët se mos nga vrazhdësia largohen e nuk na dëgjojnë. Të grindur, të paedukatë, mosmirënjohës e ulëritës ndaj atyre me të cilët ndajmë kafshatat e jetës së përditshme.

Në rast se jemi në të tillë frymë apo gjendemi të rrethuar nga kjo lloj fryme, le t'i drejtohem vetes duke e pyetur se kush janë më meritoret, për tu rrëfyer e kumtuar udhën e mbërritjes tek trualli i së vërtetës. Askush nuk është dakort, që të mos merremi me të tjerët, me shoqërinë e më gjerë, sepse dikush duhet të përcjellë dhe atje modelin e një jete sipas kornizave të së vërtetës, por më të rëndësishmit përpara të tjerëve janë vetja dhe familja. Përpara se të përpiqemi të ruajmë të tjerët nga shkëputja me truallin e së vërtetës, të sakrifikojmë të ruajmë vetet tona më së pari, pastaj familjen tonë. E kur të kemi kryer mjaftueshëm sakrificë për ruajtjen e këtyre dy kategorive, atëherë mund të mbërrijmë tek kategoria, të tjerët.

Në rast se kemi vepruar apo veprojmë të kundërtën e kësaj që duhet, atëherë kjo tregon se nuk e kemi kuptuar siç duhet thelbin e asaj çfarë na kërkojnë këto fjalë, *ruani veten dhe familjen*.

Duhet të reflektojmë dhe të mos sillemi e veprojmë si mësallë me dy faqe, pasi që kjo mënyrë e të vepruarit mund të minojë pretendimet tona se po na këputet shpirti për të shpëtuar të tjerët, ndërkohë që njerëzve që na rrethojnë, me dyfaqësinë tonë, në vend që tu shtojmë dashurinë për të vërtetën ua vështirësojmë rrugën drejt saj deri në përskaj.

Ne nuk mund të çajmë zemrat e të tjerëve, as ato të familjeve tona, madje as të vetes sonë se nuk është mundësi e jona kjo, por ne duhet të përpiqemi e sakrifikojmë që jetët tona të shërbejnë si pasqyrë e asaj çfarë realisht kërkon e vërteta prej nesh. Prandaj lipset t'i kuptojmë mirë gjërat e rëndësishme në mënyrë që më së pari të ruajmë veten dhe familjen nga largimi prej së vërtetës.



Delikatesa dhe thellësia tek sahabët

Ajdën Tallaj

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Sahabët e mi janë si yjet në qiell. Cilindo prej tyre të ndiqni, do të gjeni udhëzimin.” (Bejhaki, el-Med’hal, fq. 162-3, Nr: 152.)

Në ditët tona, kur fëmija nuk mund t’i besojë babait të vet, kur po veprohen gjëra të tmerrshme të cilat e shastisin trurin dhe mendjen njerëzore, kur çdo gjë po kthehet përmbys për hir të interesave materiale dhe parasë, ku pena dhe fryma e myslimanëve po sulmojnë njëri-tjetrin dhe kur çdo njeri, që prej të riut deri tek më i vjetri, janë në dilemë se, **“Kë të marrim shembull?”**, është e domosdoshme të analizohet seriozisht botëkuptimi i sahabëve dhe të zbatohet gjerësisht në shoqëri. Nëse brezat tanë i njohin ashtu siç duhet ata, do të shohin se hallet e tyre që janë bërë lëmsh do të zgjidhen dhe se kriteret e miqësisë dhe armiqësisë do të gjejnë vendin e vet.

Sahabi, lidhet me gjithë shpirt pas urdhrave të Islamit dhe jo formalisht. Madje, ata ishin të lidhur dhe e donin aq shumë Profetin (a.s.), saqë nuk devijuan aspak në çdo periudhë të jetës së tyre.

Kur zbriti urdhri në ajetin e dytë të sures Huxhurat për mos ngritjen e tepërt të zërit, Sabit bin Kajsi (r.a.), i cili e kishte të lartë tonin e zërit në mënyrë të natyrshme, u mbyll në shtëpi dhe nuk po shkante më në xhami. Në atë periudhë, arsytimi për mos vajtjen

në xhami ishte ose vdekja, ose ikja nga qyteti. Për këtë arsye, Resulullahu (a.s.), pyeti se ku është Kajsi (r.a.). Sahabët thanë se: “Për shkak se e ka të lartë tonin e zërit, ai nuk vjen në xhami sepse ka frikë se mos i shkojnë dëm të gjitha veprat”. Profeti (a.s.), e thirri dhe pasi i shpjegoi se ajeti nuk përfshin ata që e kanë të lartë tonin e zërit në mënyrë të natyrshme, i kërkoi që të vazhdonte të frekuentonte xhaminë rregullisht.

Po për Hubejbin (r.a.), çfarë mendoni?

Kur femohuesit e kishin mbështetur në mur nën diellin përvëlues, duke e torturuar vetëm e vetëm për ta kthyer nga feja e vet, ndaluan një moment dhe e pyetën:

“Si thua, a do të dëshiroje që tani në vendin tënd të ishte Muhamedi, e të torturohej?”

Mirëpo, Hubejbi (r.a.), iu përgjigj kësaj pyetje me një reagim të ashpër dhe një zemërim aq të madh, të cilin nuk e kishte shfaqur as gjatë torturave:

“Kurrë! Më mirë do të doja të jepja jetën disa herë me radhë, se sa të pranoja që atij t’i hyjë goftë edhe një gjemb në këmbë.”

Habbab bin Ereti (r.a.), kishte shkuar tek As bin Vaili për të marrë një borxh. Mirëpo, ky njeri i poshtë, pande hu se Habbabi (r.a.), do të kthehej prej kauzës së vet në këmbim të parave. Prandaj i thotë:

“Pa e mohuar atë (Profetin), nuk do ta kthej borxhin!” Por ai u përball me një përgjigje që nuk e priste aspak:

“Betohem në Allahun se, unë nuk do ta mohoj kurrë Profetin tim, as gjatë kësaj jete, as gjatë vdekjes dhe as kur të ringjallem.”

A nuk është ky një det dashurie i sinqertë, që është skalitur në qelizat, në mishin dhe kockat e tyre?

Familja e Jasirit (r.a.), po përjetonte torturat më të rënda. Ndërkohë që nëna Sumejje (r.anha), po ndahej më dysh nga dy kafshë që e tërhiqnin në drejtime të kundërta, baba Jasiri po martirizohej në mënyrën më të tmerrshme. Ndërsa biri i tyre Ammari (r.a.), megjithëse tha “Po e mohoj!”, vetëm me gjuhë, e jo me zemër, u shkatërrua komplet nga kjo që tha. Gjendja iu bë e ditur Rasulullahut (a.s.), i cili tha:

“Ammari është plot me besim nga koka deri tek këmbët. Besimi është përzierë në mishin dhe gjakun e tij. Nëse të detyrojnë, thuaje atë që duan vetëm me gjuhë.” (Ahmed bin Hanbel, Musned, 4/69-90.)

Ebu Bekri (r.a.), të cilit iu dha nderi të jetë bashkudhëtari i Profetit (a.s.), gjatë emigrimit, ku së bashku qëndruan edhe në një shpellë për disa ditë, mbajti në gojë guralecë për ditë me radhë nga frika se mos fliste ndonjë fjalë të pahijshme.

Ndërsa kur Ebu Bekri (r.a.), dha gjithë pasurinë që kishte për të ndihmuar ushtrinë për luftë, atij i erdhi një grup dhe e kritikoi. Por, Allahu e përgëzoi atë duke zbritur ajetin 36 të sures Shura. Gjithashtu, ai nuk tregoi qoftë edhe dyshimin më të vogël as në ndodhinë e Miraxhit. Shprehja e tij e famshme: *“Nëse e ka thënë ai, është e vërtetë!”*, i dha atij emrin e merituar Siddik-i Ekber/Besniku më i madh.

Po për Theubanin (r.a.), çfarë mendoni?

Ai ishte një djalë i ri rreth 15-16 vjeç, i cili garonte për t'i shërbyer Profetit (a.s.)... Ai i mbante peshqirin, i përgatiste këpucët dhe ujin. Madje, natën qëndronte tek dera e tij, se mbase Profeti (a.s.), kishte ndonjë nevojë. Një ditë, kur Profeti (a.s.), po tregonte për botën tjetër, e pa Theubanin (r.a.), që po qante me ngashërim. Kur Profeti (a.s.), e pyeti për shkakun, ai tha:

“Në këtë botë jemi pranë teje o Resulullah. Këtu ngopemi me ty dhe nuk mund ta durojmë dot ndarjen prej teje. Mirëpo, nesër në botë tjetër do të jetë e pamundur të të shohim për shkak të pozitës së lartë që do të kesh.”

Pasi dëgjoi këto fjalë, i Dërguari Allahut (a.s.), e ngushëlloi duke i thënë:

“O Theuban! Njeriu do të jetë me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96.)

Le të kujtojmë pak edhe “Besëlidhjen e dytë të Akabes”!.. Atje gjendeshin shtatëdhjetë persona prej ensarëve. Ndërkohë kur Abdullah bin Reuaha (r.a.), e pyeti Resulullahun (a.s.), se çfarë do të merrnin si shpërblim në këmbim të besës se do ta mbronin atë me jetët e tyre, Profeti (a.s.), iu përgjigj me një fjalë të vetme: *“Xhenetin”*

Me të dëgjuar këtë fjalë, ensarët treguan shembullin më të bukur të dorëzimit dhe miqësisë, duke thënë:

“Për Allahun, sa tregti fitimprurëse!”

Ebu Talha (r.a.), ishte një sahab që kishte marrë pjesë në çdo betejë deri në periudhën e Osmanit (r.a.), ku kishte marrë edhe plagë të shumta. Por megjithëse bijtë e tij iu lutën që tashmë të mos merrte më pjesë në luftë, ai nuk e braktisi luftën për Allahun. Më pas, gjatë një lufte detare, ai vdiq në anije. Edhe pse për nëntë ditë me radhë nuk gjetën asnjë ishull ku ta varrosnin, trupi i tij nuk mori asnjë erë të keqe. Më në fund, ditën e dhjetë gjetën një ishull dhe e varrosën.

Sahabët e nderuar, silleshin gjithmonë me kujdes, sikur mbi kokat e tyre qëndronte ndonjë zog dhe kishin frikë se në lëvizjen më të vogël do ta trembnin.

Virtytet e sahabëve, buronin jo vetëm prej edukimit nën kujdesin e mrekullueshëm të Profetit (a.s.), por edhe prej pjesëmarrjes së tyre në ndonjë prej ngjarjeve të rëndësishme si durimi nën torturat e tmerrshme, Besëlidhjet e Akabes, emigrimi, betejat e Bedrit, Uhudit, Bej'atu'r-Riduan, Umretu'l-Kaza, në Hajber, në Mute dhe Tebuk. Për këtë arsye, ata kishin grada të larta dhe ishin larg prej interesave personale apo dyfytërisë. E kush mund ta poshtërojë atë që Allahu e ka ngritur!?

Sipas një transmetimi që vjen prej Ebu Said el-Hudriut (r.a.), Profeti (a.s.), ka thënë:

“Mos i shani sahabët e mi! Betohem në Allahun që ka në dorë shpirtin tim se, edhe nëse jepni flori si sadaka sa peshë e malit Uhud, nuk mund t'ia arrini sevapit të dy grushteve me hurma, madje edhe sa gjysma e kësaj që jep vetëm njëri prej sahabëve të mi.” (Muslim, Fedail, 221.)

Allahu i Madhëruar i mëshiroftë të gjithë ata dhe na bëftë prej atyre që përfitojnë nga shefaatit të tyre. Amin!

“Betohem në Allahun se, unë nuk do ta mohoj kurrë Profetin tim, as gjatë kësaj jete, as gjatë vdekjes dhe as kur të ringjallem.”



Zgjimi

“Thuaj (o Muhamed): “Unë ju këshilloj vetëm një gjë: Ngrihuni singërisht për Allahun,” (Seb’e, 46.)

Zgjimi me ndihmën e Allahut nga gjumi i neglizhencës është hapi i parë në rrugëtimin shpirtëror. Kjo gjendje është konsideruar si faza e parë e rrugëtimit shpirtëror dhe si hapi i parë drejt kalimit në nivelin e pendimit. Pas fazës së zgjimit udhëtari pendohet për të gjithë ato që ka bërë deri në atë moment, kritikon veten, përpiqet të shtojë të mirat dhe të shpëtojë nga të këqijat. Në këtë mënyrë drejtimi nga Allahu dhe kapja pas litarit të Tij shpëton nga kurthet e shejtanit duke u strehuar në mëshirën e Allahut.

Ngritja në ajetin e lartpërmendur është përkufizuar si ngritje për hir të Allahut, zgjim nga gjumi i neglizhencës dhe dalje nga moçali i atrofizimit. Nga kjo pikëpamje zgjimi shpreh ndriçimin e zemrës dhe shpirtit në sajë të manifestimit të udhëzimit dhe dritës hyjnore duke u larguar nga neglizhenca dhe indiferenca.

Njeriu për nga natyra është i prirur nga dembelizmi, të harrojë të vërtetën dhe të anashkalojë dritën në qenien e tij. Prandaj ai ka nevojë gjithmonë për një këshillues i cili do ta zgjojë nga gjumi i neglizhencës. Dhe ky këshillues është manifestimi i cilësisë së udhëzimit hyjnorë në zemrën e tij. Personi në sajë të udhëzimit arrin të shikojë dritën në qenien e tij, në këtë mënyrë ai zgjohet nga gjumi i neglizhencës dhe fillon të zbatojë urdhëresat hyjnore. Në këtë pikëpamje zgjimi është shkalla e parë e cila e ndriçon zemrën duke i dhënë jetë asaj. Pra zgjimi nga gafleti dhe

drejtimi për tek Allahu është konsideruar si hapi i parë i udhëtimit shpirtëror. Dhe kjo gjendje në një mënyrë është përshkruar me gjendjen e një personi që është në gjumë i cili zgjohet, çohet në këmbë dhe fillon të ecë.

Imam Hereviu i cili është i pari që e ka përfshirë zgjimin në gjendjet shpirtërore thekson se zgjimi ka tre elementë imperativ.

I -Reflektimi dhe pranimi se mirësitë që Allahu i ka dhuruar robit janë të panumërta dhe të pafund.

Përpyeka për t’i njohur këto mirësi dhe vetëdija për mangësinë e theksuar në falënderimin e Allahut për gjithë këto mirësi. Udhëtari kur mendon mbi mirësitë e dukshme dhe të padukshme, të kaluara dhe të ardhme arrin të kuptojë se mirësitë e Allahut janë të panumërta dhe pafund. Pastaj arrin të ndërgjegjësohet se të gjithë këto mirësi nuk janë si shpërblimi i veprave të tij por si dhuratë dhe shpërblim nga ana e Allahut. Të gjitha mirësitë që zotëron njeriu janë dhuratë e Allahut përcaktuar për të. Në këtë mënyrë personi në fjalë arrin të kuptojë se sa do që të adhurojë Allahun, sa do që të mundohet në zbatimin e urdhëresave të Tij nuk mund ta përmbushë plotësisht kurrë falënderimin për mirësitë që zotëron. Sepse fundja ibadeti, bindja, forca dhe fuqia të cilat janë të domosdoshëm për të realizuar falënderimin janë përsëri mirësi dhe begati e Allahut për njeriun. Mirësitë rriten në raport të drejtë me falënderimin dhe ibadetin e personit për t’i dhënë hakun mirësive që zotëron. Kjo gjë i siguron njeriut pohimin e dobësisë dhe paaftësinë përballë Krijuesit

të gjithësisë. Nga ana tjetër njohja e mirësive të Allahut bëhet e mundur përmes:

1. Mendjes së ndriçuar nga drita e udhëzimit dhe besimit të cilën Allahu e ka vendosur në zemrën e çdo besimtari.

2. Shikimit dhe mendimit mbi mirësitë.

3. Marrja mësim prej njerëzve të sprovuar.

II - Reflektimi mbi mëkatet dhe gabimet dhe vetëdijesimi për rrezikun që përbëjnë dhe llogarinë që do të jepet për to.

Ky vetëdijesim e vë në lëvizje udhëtarin në rrugëtimin e tij shpirtëror për të kompensuar gabimet që ka bërë në të kaluarën. Përpiqet të korrigjojë gabimet në të gjitha aspektet sipas direktivave hyjnore. Pastaj ndërmerr iniciativën që përmes ibadetit, bindjes, pendimit dhe istigfarit të pastrohet nga mëkatet dhe të shpëtojë nga varësia dhe ndikimi i mëkateve dhe veseve të këqija. Përndryshe mëkatet bëhen shkak për turbullimin e zemrës dhe pengesën e hyrjes së dritës që vjen nga udhëzimi. Personi kërkon falje dhe përballë gjen mëshirën e madhe dhe të pafundme të Allahut. Vetëdijesimi për mëkatet dhe fillimi i punës për përmirësimin e tyre bëhet i mundur duke pranuar madhështinë e Allahut, duke kritikuar vetveten dhe besuar në realizimin e dënimit hyjnor.

III - Vetëdijesimi për veprat e mira të bëra deri tani, ndërgjegjësimi për rastet e pashfrytëzuara dhe veprat e humbura, përpjekja për përmirësimin e tyre kalimi i kohës se mbetur në mënyrë sa më produktive me ibadet dhe vepra të mira.

Kjo arrihet duke marrë pjesë në kuvendet e diturisë dhe urtësisë, duke respektuar urdhëresat dhe ndalesat hyjnore dhe duke u shoqëruar me njerëz të mirë. Udhëtarit vetëm përmes dijetarëve të urtë mund të kuptojë se cili veprim dhe punë e lartëson shkallën e tij dhe i mundëson lehtësimin në rrugëtimin shpirtëror.

Sipas Hereviut bazën e tre elementëve të zgjimit e përbën ndërgjegjësimi për domosdoshmërinë e shkëputjes dhe shpëtimit nga sjelljet dhe veset e këqija. Prandaj udhëtarit duhet të heqë dorë nga justifikimet dhe menjëherë t'i drejtohet pendimit dhe faljes hyjnore. Përndryshe njeriu për nga natyra është i prirur nga dembelizmi, kënaqësitë, shehveti dhe mburrja. Natyrisht kjo prirje e njeriut bëhet shkak për neglizhencën, indiferentizmin, hutimin dhe plogështinë. Nëse personi në fjalë nuk kundërshton dëshirat mesquine nuk mund të bëjë para në udhëtimin e tij shpirtëror.

Krahas shpëtimit nga neglizhenca, një tjetër funksion i rëndësishëm i zgjimit është orientimi i njeriut drejt pendimit. Prandaj Ebu Hafs Suhrevendi zgjimin e ka përkufizuar si një paralajmërim hyjnor që Allahu e vendos në zemrën e atyre që frikësohen prej Tij duke i orientuar ata drejt pendimit. Zgjimi i cili sipas tij konsiderohet gjendja e parë e cila orienton udhëtarin drejt Allahut duke e ngjitur në nivelin e pendimit. Nga kjo pikëpamje zgjimi është konsideruar si një nga fazat më të rëndësishme për një pendim të saktë e të vërtetë.

Përgatiti: Albert Halili



MUHAMED ABDULLAH DERAZ

ASHIKU I KURANIT FAMËLARTË

JETËSHKRIMI

Dr. Muhamed Abdullah Deraz ka lindur në vitin 1894, në prefekturën Kefr Shejkh të Egjiptit. U rrit në një familje dijeje dhe devotshmërie. Babai i tij, Shejkh Abdullah Deraz, ka qenë prej dijetarëve të shquar të Ez'herit. Ai është komentuesi i librit “El-Muvafekat” të Imam Shatibiut.

Deraz e përfundoi mësimin (hifzin) e Kuranit Famëlartë, që në vegjëli, akoma pa i mbushur dhjetë vite. Në vitin 1916 mori gradën profesor doktor. Në vitin 1928 punoi si profesor në Universitetin e Ez'herit. Ndërsa në vitin 1936 kreu obligimin e haxhit. Po në të njëjtin vit fitoi bursë studimi në Universitetin e Sorbonit, Francë. Në Francë qëndroi 12 vjet, që kaluan në seriozitet dhe përvetësim të kulturës perëndimore, prej burimeve rrënjësore të saj dhe meditimit krahasues të këtij rezultati me parimet morale të Kuranit Famëlartë.

Në Universitetin e Sorbonit arrin të marrë doktoraturën dhe tema e diplomës së tij titullohej “Morali i Kuranit” (La Morale Du Koran), e cila mori vlerësimet e orientalistëve të mëdhenj francez, si Louis Massigon dhe Lévi Provençal. Diskutimi i doktoraturës u bë, më 15.12.1947.

Pas kthimit nga studimet, u bë anëtar i Këshillit të Dijetarëve të Mëdhenj, në vitin 1949. Gjithashtu punoi si ligjërues në shumë universitete të Egjiptit, në lëndët e Historisë së Feve, Tefsirit dhe Filozofisë së Moralit.

Ndërroi jetë në qytetin e Lahorës të Pakistanit, në vitin 1958, ndërkohë që merrte pjesë në Konferencën e Kulturës Islame...

GJAK MAGRIBIT

Duket se familja Deraz kishte gjak dhe afërsi intelektuale të veçantë me magribin arab (Marokun e sotëm), ndoshta për shkak të ndjekjes familjare të traditës në medhhebin Maliki. Shejkh Abdullah Deraz, që është babai i tij, ka komentuar librin “El-Muvafekat”, të dijetarit andaluzian, Ebu Is'hak Esh-Shatibi, ndërsa Deraz, i biri e ka redaktuar librin. Pastaj ka shkruar studime mbi librin “El-I'tisam”, po të Shatibiut. U përpoq të prodhonte idetë e “El-I'tisam” dhe rinovimin e tyre në librin e tij “El-Mizan bejne es-sunneti vel-bid'ati”, por vdiq (Allahu e mëshiroftë), përpara se ta përfundonte.

Ndërkohë që Draz vazhdonte studimet në Francë, në mesin e shekullit XX, krijoi lidhje të forta me filozofin algjerian, Malik ibn Nebij. Mes të dyve u shfaq një ngjashmëri e madhe në interesimin e tyre në fushën intelektuale dhe në rezultatet e arritura prej të dyve në lëmin e studimeve kuranore. Këtë gjë e ka shprehur vetë Derazi në parathënien e tij të librit të Malik ibn Nebij “Edh-Dhahiretu El-Kuranijetu” (Dukuria Kuranore). Por, mos e ngatërro esencën e krahasimit mes këtij libri të Malik ibn Nebijit dhe dy librave të Derazit, “En-Nebeul-Adhim” dhe “Med-khal ila El-Kuran El-Kerim”, afërsinë intelektuale mes këtyre dy kolosëve, që janë prej mendjeve më të ndritura myslimane të shekullit XX.

Kjo gjë e tejkalon lidhjen intelektuale dhe afërsinë e mentalitetit drejt solidarizimit vëllazëror dhe përpjekjeve të përbashkëta. Sepse, Derazi u ngrit me guxim së bashku me kërkuesit e pavarësisë së Marokut (Magribit arab) ndaj Francës, duke rrezikuar edhe veten e tij, në kërkim të kësaj gjëje, si student dhe i huaj që qëndronte në Francë.

PERSONALITET KARIZMATIK

Deraz ishte një personalitet karizmatik, me cilësi të rralla, të cilat i ka përmbledhur Shejkh Ehl Katar Abdullah El-Ensarij. Prej cilësive të tij ai numëronte: mençurinë, zgjuarsinë, maturinë, durimin, modestinë, butësinë, besueshmërinë, trimërinë, guximin, bujarinë, këmbënguljen në hak, oratorinë në bisedë, zemërbutësinë dhe dhembshurinë ndaj pasuesve. Ai e kishte kuptuar rëndësinë e mesazhit kuranor, të cilin e mbarte, ashtu siç e karakterizonte shqetësimi për ymetin, kudo që gjendej dhe kudo që shkonte. Madje, edhe nxënësi i tij, kolosi Jusuf El-Karadawi shkruan për të: Sa herë që na fliste, apo rrinim me të, ai ishte i zënë me shqetësimin për Islamin dhe myslimanët.

Mbështetja e hapur ndaj lëvizjeve çlirimtare të Magribit arabik nën pushtimin e Francës, ndërkohë që ky vetë ishte në Francë vlen për t'u theksuar.

Kur revolucionarët egjiptianë i ofruan postin e Shejkhut të Ez'herit, ai kushtëzoi që Ez'heri të kishte pavarësi akademike prej pushtetit. Dhe, kur revolucionarët e refuzuan këtë gjë, ai kërkoi ndjesë për pranimin e këtij propozimi (postit), madje këmbënguli në këtë refuzim, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme e të përsëritura që i bënin.

MENDJE E NDËRTHURUR

Derazi ishte “djalë Ez'heri dhe djalë Sorboni”, siç e përshkruan edhe kolosi Karadawi. Ai pati mundësi të bënte studime të thella, si në kulturën islame dhe në kulturën perëndimore prej burimeve të tyre origjinale, duke ndërtuar një vizion të ndërthurur analitik unik, larg sipërfaqësore elementare (të thjeshtë) dhe “keqpërtypjes mendore”, e cila kishte goditur shumë prej atyre që qëndruan në kufijtë e kulturës së fjetur të trashëguar, apo perëndimore së ardhur. Ishte i thelluar në shpirtëroren e Gazalit, Hakimit, Tirmidhiut dhe Ebu Talib El-Mekkiut. Ekspert i filozofisë së Dekartit, Kantit dhe Bergsonit. Për shkak të kësaj mendjeje të ndërthurur, Derazi u dallua për horizontin e gjerë, thellësinë e analizës, hollësinë e argumentimit, së bashku me argumentet bindëse, retorikë magjike të buruar prej retorikës së Kuranit Fisnik.

ASHIKU I KURANIT

Me të vërtetë Derazi ka qenë njeriu i Kuranit. Mendja dhe zemra e tij ishte pushtuar nga dashuria për Kuranin. Gjithë kohën ishte i zënë me të dhe pothuajse nuk shikohej, vetëm se i zhytur në leximin dhe meditimin e tij, ose duke u falur me të. Çdo interesim i tij shkencor sillej, sidomos rreth Kuranit, saqë vështirë të gjesh ndonjë punim të tij shkencor, që të mos jetë Kurani lëmia dhe thelbi i tij. Derazi nuk mund ta ndalonte asgjë nga ashku për Librin e Allahut dhe varësinë e tij të zemrës për të. Ai i ndiqte shprehjet e Kuranit me dashuri të zjarrtë, e me të drejtë ai theksonte se ato janë “fotone drite”.

Derazi ishte i vazhdueshëm në leximin e gjashtë xhuzeve të Kuranit çdo ditë, pa lodhje dhe pa meritje. Ishte madhërues i Kuranit, saqë edhe sexhden e leximit e bënte gjatë seminarit të lëndës së tefsirit. Madje kërkonte prej studentëve të merrnin abdest përpara seminarit, si përgatitje për këtë. Rreth kësaj ka shkruar edhe shoku i udhëtimit për në Konferencën Islame në Lahor, Shejkh Muhamed Ebu Zehra: “Na printe në magazin e jacisë, pastaj kur secili nga ne shkante të flinte, ai falej dhe lexonte Kuran. Nuk e shikoje, vetëm se duke lexuar Kuran, apo duke u falur me të”.

METODË MESATARE

Shejkh Deraz ka qenë imam i mesatarizmit të pastër islam. Mesatarizmi i tij është dukur në trajtimet që i ka bërë disa dualizmave të mëdha, të cilat kanë lëkundur dhe kanë përtharë mendimin islam, si: Mendja dhe transmetimi, Suneti dhe bidati, imponimi dhe përzgjedhja, paqja dhe lufta, dituria dhe feja, morali dhe ligji etj. Duke ditur se nuk është vendi për t'u zgjatur rreth këtyre gjërave, po mjaftoj vetëm me disa tregues të tij rreth çështjes së “mendjes dhe transmetimit”. Ai thekson se dallimi mes hajrit dhe sherrit (të mirës dhe të keqes)... është frymëzim i

brendshëm, i përqendruar (vendosur) në qenien njerëzore, përpara se të jetë ligj hyjnor, megjithëse ligji hyjnor (sheriati) “plotëson ligjin moralo-natyror” dhe ky është plotësim i domosdoshëm i origjinës njerëzore, të cilën e vënë në dyshim gjëra penguese ndaj të vërtetës dhe së mirës, apo errësira që e drejtojnë nga lëkundja dhe dyshimi.

Pa dritën e Shpalljes, njeriu mbet në konfliktin e përhershëm rreth njohjes së të mirës dhe të keqes (hajrit dhe sherrit) “dhe do të përballen mendje me mendje, ashtu siç përballen ndjenja me ndjenja”. Historia njerëzore na jep mësimin më të mirë të shembujve të këtyre rropatjeve që nuk kanë mbarim, prej zbulësive (Nirvana) të Budizmit deri te pornografitë stoicike greke. Të gjitha këto janë dëshmitare se, drita e Shpalljes dhe drita e origjinës (natyrës së pastër) duhet të mbesin pengje syhapur, siç i ka dëshiruar Krijuesi i ligjit (sheriati) të origjinës, Zbritësi i ligjit qiellor.

PIONIERIZËM DHE RINOVIM

Pothuajse asnjë punim prej punimeve mendore të Derazit nuk lënë pa përmendur ide të mprehta rinovuese. Por rinovimi i tij u shfaq më shumë se askund tjetër në studimet kuranore. Në këtë kontekst mund të themi pa asnjë ekuivok se, Derazi themeloi dy shkenca të reja e ato janë shkenca e “Moralit të Kuranit” dhe shkencën e “Burimit të Kuranit”. Për të parën ka shkruar librin e tij “Kushtetuta e Moralit në Kuran”, ndërsa për të dytën ka shkruar dy libra: “En-Nebeul-Adhim” (Lajmi i Madh) dhe “Medkhal ila El-Kuran El-Kerim” (Hyrje në Kuranin Famëllartë). Derazi e kishte kuptuar se, ai ishte futur në një rrugë të pashkelur më parë dhe se ai po fillonte një punë themeluese në të dy këto shkenca. Prej këtu kuptojmë se përjasjet e tij në këtë fushë kanë qenë me të vërtetë të vlefshme. Ato janë rezultat i përpjekjeve të thella mendore, që nuk arrihen, përveçse nga ai që studion librat e tij dhe zbulon çfarë ka aty prej origjinalitetit, thellësisë dhe sinqeritetit.

Rinovimi i Derazit në shkencën e Kuranit shfaqet në metodën që ai ka ndjekur. Dijetarët e Islamit kishin traditë që ta argumentonin origjinën e Kuranit Famëllartë përmes portës së rregullave gjuhësore figurative. Ndërsa, Derazi u nis prej studimeve analitike të Mesazhit kuranor, logjik dhe historik. Kjo është një metodë rinovuese, e ndryshme nga metoda e trashëguar. Prej fryteve të saj është nxjerrja e Kuranit prej kontekstit të kulturës arabe dhe vendosja e tij në kontekstin global.

Allahu e mëshiroftë dr. Muhamed Abdullah Deraz, filozofin e Kuranit Famëllartë.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

Pa ardhur ende ajo ditë

— Sami Goksyn —

Në kohën e hilafetit të vet, Omeri (r.a.), në vulën e tij, kishte shkruar:

“O Omer! Vdekja të mjafton si ligjërues!”

Pra, në kuptimin; *“a mos po kërkon ndonjë ligjërues tjetër, nuk të mjafton vdekja?”*. Dhe, sa herë që vuloste një shkresë zyrtare, e shikonte këtë fjali dhe merrte mësim.

Çdo i gjallë do të vdesë dhe çdo trup do të mbështetet në prehrin e varrit. Këtë të vërtetë e di çdo gjallesë. Mirëpo, ata që nuk janë të përgatitur për jetën pas vdekjes, vazhdimisht largohen prej realitetit të vdekjes...

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Thuaj: «Vdekja prej së cilës po ikni, do t’ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe, Ai do t’ju njoftojë për atë që keni bërë.»” (Xhumu’a, 8)

Ajo që i ka hije njeriut besimtar, është të mendojë shumë në lidhje me vdekjen, të mos e harrojë kurrë atë dhe të përgatitet për të. Kuptimi në mënyrë të drejtë i vdekjes, i lehtëson vështirësitë e kësaj bote dhe e ruan njeriun prej lakmisë së saj.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kujtojeni shpesh vdekjen që ua prish kënaqësitë.” (Tirmidhi, Zuhd, 4.) Me këto fjalë, Profeti (a.s.), ka dëshiruar që ne ta përkujtojmë vazhdimisht vdekjen me një meditim të thellë.

Vdekja u jep fund kënaqësive. Mirëpo, këto këna-

qësi, të cilave ajo u jep fund, janë thjesht të përkohshme. Nëse bëhen përgatitjet e duhura për vdekjen, nëse bëhet një jetë e dobishme, vdekja bëhet dera e kënaqësive të përhershme dhe të përjetshme. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush e do takimin me Allahun, edhe Allahu e do takimin me të. Por kush nuk e pëlqen takimin me Allahun, as Allahu nuk e pëlqen takimin me të!” Kur e dëgjoji këtë, nëna jonë Aishja (r.anha), u habit dhe pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! A përfshihet këtu edhe mospëlqimi i vdekjes? Sepse askujt prej nesh nuk i pëlqen të vdesë” Resulullahu (a.s.), tha:

“Jo, nuk është kështu! Kur besimtari përgëzohet (i vjen vdekja) me mëshirën e Allahut, kënaqësinë dhe Xhenetin, ai e dëshiron shumë takimin me Allahun. Gjithashtu, edhe Allahu e dëshiron takimin me të. Ndërsa kur i vjen vdekja mohuesit, ai njoftohet me zemërimin dhe dënimin e Allahut. Për këtë arsye, ai nuk e pëlqen takimin me Allahun. Po ashtu, as Allahu nuk e do takimin me të.” (Buhari, Rikak, 41; Muslim, Dhikr, 14.)

Atëherë, për vdekjen, pra, për botën tjetër duhen bërë përgatitjet e duhura.

Si?

Ashtu siç përgatitet dikush për një udhëtim të gjatë...

Pra, duke përgatitur mjetet dhe ushqimet e nevojshme për udhëtim...

Po çfarë janë këto mjete dhe ushqime?

Allahu i Madhëruar, shprehet:

“...Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria!..”
(Bekare, 197.)

Në këtë udhëtim, neve na nevojiten më tepër përgatitje dhe pajisje. Ushqimi i këtij udhëtimit, janë veprat e mira dhe devotshmëria. Frika nga Allahu dhe kërkimi i mbrojtjes së Tij. Kush pajiset mirë me devotshmëri, arrin shpëtimin dhe vendin e paqes. Kurse ata që nuk e bëjnë këtë përgatitje, pësojnë disfatë dhe shkatërrohen.

Ata që dalin në udhë pa u përgatitur, vuajnë dhe hasin shumë vështirësi... Po ashtu, edhe ata që dalin pa u përgatitur në udhëtimin drejt botës tjetër, do të digjen në njëmijenjë pendime të padobishme:

“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: «O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!» Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai (kot) e thotë! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.” (Mu’minun, 99-100.)

Atë ditë, nuk ka kthim mbrapa!

Ndërsa sot ka. Sot, dera e teubes është e ende e hapur. Madje e hapur deri në fund. Sot, është e mundur të kthehesh prej gabimeve, të heqësh dorë prej kundërshtimeve dhe të pendohesh.

Kjo derë, është e hapur deri në frymën e fundit. Mirëpo, këtë çështje nuk duhet ta shtysh deri në frymën e fundit, sepse ti nuk mund ta dish kurrë se kur do të jetë ajo frymë e fundit.

Kanë thënë:

“O njeri i mashtruar prej iluzioneve të gjata që je marrë me këtë botë! Vdekja të vjen kur nuk e pret, ndërsa varri është sënduku i veprave.”

Duhet menduar mirë se, askush nuk e di se kur do të vdesë. Edhe pse në lidhje me këtë botë ka shumë plane e projekte, vdekja mund t’i vijë papritur njeriut. Prandaj, mos u mashtro prej rinisë tënde duke thënë, “sa të kemi pleqtë s’na vjen radha neve!”

Shumë njerëz të rinj e të moshuar, të cilët kanë rendur pas projekteve më të mëdha se të tuat, kanë vdekur dhe kanë ikur nga kjo botë duke i lënë punët

e tyre përgjysmë. Ka shumë njerëz që e kanë përfunduar shtëpinë e tyre dhe kanë vdekur pa pasur mundësi të hyjnë brenda. Shumë bujq që kanë korrur e vjelë prodhimin e tyre, por kanë vdekur pa pasur fatin të hanë qoftë edhe një kafshatë prej tij. Po ashtu, ka edhe shumë shkrimtarë, të cilët kanë mbyllur sytë para se t’i mbarojnë veprat e tyre. Lidhur me këtë çështje, një i urtë thotë:

“O njeri që ke harruar ditën e udhëtimit! Po të shoh indiferent ndaj vdekjes që ndan miqtë nga njëri-tjetri.

Ti nuk po merr fare mësim prej atyre që shkojnë drejt asgjësimit. Në fakt, ai që vdes, shkon duke e lënë këtë botë kështu si është.

Ajo që kanë marrë me vete, është vetëm një copë qefni. Gjithçka që kanë bërë ka mbetur ashtu siç ishte.

Ata kanë rënë larg njëri-tjetrit atje poshtë në tokë. Ndërsa kur ishin gjallë, ishin miq e shok për kokë.

Edhe ti, nesër ose ndonjë ditë tjetër, do të jesh pranë tyre. Por në varr do të jeni të vetmuar.

Aty nuk do të kesh asnjë dobi prej njerëzve të cilëve u besoje, sepse nuk do të gjesh një mik që do ta mbajë premtimin.

Atëherë, përgatitu që tani për vdekjen dhe shpëto prej iluzioneve të kota, sepse ajo është shumë afër!”

Për të kujtuar, kuptuar dhe për t’u përgatitur për vdekjen, le t’i vëmë veshin këtyre fjalëve të Allahut të Madhëruar:

“Atëherë, përse kur (dikujt) i vjen (shpirti) në grykë para syve tuaj, ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re. Përse pra, nëse nuk do të gjykoheni (në jetën e përtejme), ju nuk ia ktheni shpirtin atij? Përgjigjuni kësaj, nëse thoni të vërtetën! Kështu, nëse ai (në agoni) është nga ata që janë të afërt (me Allahun).” (Uakia, 83-88.)

“Por, kur shpirti të vijë në grykë e të thërrasin “A ka shërues”, atëherë, ai (që po vdes) do të bindet se ky është çasti i ndarjes dhe këmbët do të ngrijnë. Atë ditë, ai do të sillet te Zoti yt.” (Kijame, 26-30.)

Si përfundim, sado gjatë të jetojmë, një ditë do të futemi në varr dhe do të kthehemi tek Zoti ynë.

Allahu i Madhëruar na bëftë prej atyre që kthehen tek ai me besim të përsosur!.. Amin...



Sulbe të zgjedhura

Ferit Piku

Këshillë për NAMAZIN

Zoti ynë thotë në Kuranin famëlartë: **“Elif, Lam, Mimë. Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej Allahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm, të cilët e besojnë të fshehtë, e kryejnë faljen (namazin) dhe prej asaj që Ne u kemi dhënë, ata japin (zekat, sadaka etj)”**. (Bekare: 1-3)

Namazi është shtylla e dytë e Islamit. Pas shehadetit se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Tij, menjëherë vjen namazi, për ta vërtetuar besnikërinë e atij që thotë shehadetin. Namazi vërteton dëshminë tënde. Namazi është puna e parë, për të cilën llogaritet njeriu ditën e Kijametit. Namazi është shenja që i dalton njerëzit e devotshëm. Kush e mban namazin, ka mbajtur fenë, kush e rrëzon atë, ka rrëzuar fenë.

Namazi është ajo punë që të tregon se sa vlerë ka Islami në zemrën tënde. Nëse namazi ka peshë në zemrën tënde, dije se feja e Zotit ka zënë vend në zemrën tënde.

Namazi është tregues i dashurisë për Zotin, është takimi me Të. Kur njeriu do një tjetër, mezi pret të takohet me të. Njeriu që do Zotin, nuk e ka barrë e as bezdi faljen e namazit, por e fal atë me dëshirë dhe përkushtim, duke qenë i kënaqur me Zotin.

Namazi është tregues i falënderimit ndaj Zotit. Shumë njerëz thonë: “Shyqyr o Zot, të falënderojmë Ty që na ka ardhur dynjaja mbarë”. Por pak njerëz falënderojnë me zemra. Kush do ta dijë se sa e falënderon Zotin për të mirat që i ka dhënë, le ta shohë namazin e tij.

Namazi është i vetmi obligim që kryhet në çdo situatë. Asnjë obligim tjetër nuk është si namazi. Namazi

falet kur je i shëndoshë dhe kur je i sëmurë. Falet kur je në këmbë, falet edhe kur je ulur. Falet në tokë dhe në det, falet edhe në qiell. Në çdo situatë, madje edhe përpara vdekjes, duhet ta falësh namazin, qoftë edhe me shikimin e syve dhe nuk mund ta tradhtosh atë, se namazi është amaneti mes teje dhe Allahut (xh.sh).

Namazi është ajo punë, që nëse ti e lë me qëllim dhe me vetëdije, rrezikon daljen nga feja, pasi Profeti (a.s), thoshte: **“Ajo që na dallon ne nga jobesimtarët është NAMAZI. Kush e fal namazin, ka mbajtur fenë, kush e lë atë ka lënë fenë”**.¹

Namazi ishte porosia e fundit e të dashurit të zemrave tona, profetit Muhamed (a.s) dhe kur një profet lë porosinë e fundit, vendosja mirë gishtin kokës, se është porosia më e madhe që po të lë profeti i Zotit. Fjalët e tij të fundit ishin: **“Namazin, namazin, namazin”**.² Shokët e tij thonë: “Kur iu rëndua gjuha dhe nuk e shqiptonte dot fjalën **namaz**, ne e kup-tonim se ai deshi të thoshte përsëri **Namazin**”.

Namazi ishte buzëqeshja e fundit e Profetit (a.s), në këtë dynja. Ai buzëqeshi herën e fundit, kur nuk doli dot për të falur namazin e sabahut në xhami, por e pa Ebu Bekrin që po udhëhiqte besimtarët në namazin e sabahut dhe buzëqeshi, u qetësua, iu bë zemra mal, se i la myslimanët duke falur namaz. Nëse do ta shijosh buzëqeshjen e Profetit (a.s) edhe pse ai ka ndërruar jetë, fale namazin.

1. **Hadith i vërtetë**. Ahmedi (5/346) dhe Muslimi (82) me tekst të përafërt.

2. **Hadith i vërtetë**. Ebu Daudi (5156) dhe Ibn Maxheh (1625). Shejh Albani e vlerëson hadithin të vërtetë, ndërsa shejh Shuaibi e vlerëson hadithin të vërtetë për shkak të dëshmime përforsuese.

Prandaj myslimanët e parë, shokët e Profetit (a.s.), kur hynin në një vend të huaj, nuk e sulmonin atë vend, derisa të vinte koha e ezanit. Nëse thirrej ezani në atë vend, ata thoshin: “Ndal! Këtu ka myslimanë. Nuk mund të luftojmë”. E nëse nuk thirrej ezani në atë vend, ata luftonin, se nuk mund ta imagjinonin, që të kishte myslimanë, që thonë shehadetin me gojë, por nuk falin namazin.

Profeti (a.s) e parashikoi kohën tonë, gjendjen dhe situatën tonë dhe tha: *“Do të vijë koha që nyjet e Islamit do të zgjidhen njëra pas tjetrës (feja do të dobësohet ditë pas dite). Nyja e parë që do të zgjidhet do të jetë sheriati. Nuk do të zbatohet sheriati. Nyja e fundit që do të zgjidhet do të jetë namazi”*.³

Do të ketë shumë njerëz me emra myslimanë si: Muhamed, Ahmed, Hasan e Husejn, por që nuk e dinë se ç’është namazi. Namazi nuk ka vlerë në jetën e tyre, madje ata mund të tallen me ata që falin namaz. Kjo është nyja e fundit dhe Zoti na ruajtë, se po u këput kjo nyje, këputet feja e Zotit. Na bëftë Zoti nga ata njerëz, që nuk e këpusin nyjen e fundit. Nëse e mbajmë nyjen e fundit, në dashtë Zoti, kjo nyje do të bëhet shkak për t’u formuar edhe nyjet e tjera.

Ne e dimë fare mirë sot, se myslimanët janë mbi 1 miliard. Por, nëse ka statistika, sa prej tyre falen pesë herë në ditë? Do të shohësh që janë shumë pak. Sa prej këtyre që falen e dinë se çfarë po bëjnë? Përsëri do të shohësh shumë pak. Por të jemi të sigurt, se namazi ka vlerë të madhe. Ne bëjmë gjynahe çdo ditë. A e dini se puna më e madhe, që i fshin gjynahet e robit është namazi?! Prandaj Zoti i gjithësisë e ka bërë urdhër faljen e namazit, se Ai ta do të mirën, të do të pastër e të panjollësor.

Nëse ti merr abdes me përkushtim dhe këtë punë e bën jo për të freskuar fytyrën, por për të shkuar tek Zoti, të dalin gjynahet nga çdo gjymtyrë që ti lan. Gjynahet dalin nga duart, nga sytë, nga këmbët e deri edhe nga poshtë thonjve.

Nëse ka gjynahe që nuk dalin nga abdesi. Thuhet se mekelët i marrin këto gjynahe, i vendosin në kokën e njeriut dhe në qafën e tij. Kur njeriu fillon namazin dhe bie në ruku, gjynahet që ka pasur në kokë, fillojnë t’i bien poshtë. Në momentin kur bie në sexhde, me ballin përtokë, në kulmin e përkushtimit ndaj Zotit, ato gjynahe që ishin në qafë dhe në shpinë, bien përtokë. Pastaj kur robi jep selam i thuhet: “U pastrove prej këtij namazi”.

Prandaj Allahu (xh.sh.), ka caktuar pesë namaze, jo për të na lodhur ne, por për të na pastruar nga gjyhanet. Profeti (a.s.), tha: *“A mbetet papastërti në*

trupin e atij që lahet pesë herë në ditë në një lumë?” Shokët e tij u përgjigjën: “Jo o profet i Zotit”. Profeti (a.s.), vazhdoi: *“Kështu është edhe puna e besimtarit me pesë namazet. Zoti i shlyen gjynahet që janë mes tyre.”*⁴

Nëse pesë namazet nuk t’i falin gjynahet, atëherë vjen namazi i xhumasë, namazi më i madh i javës, që shlyen gjynahet e javës së kaluar. Nëse edhe xhumaja nuk t’i shlyen gjynahet, atëherë vjen muaji i Ramazanit një herë në vit dhe t’i shlyen gjynahet e vitit të kaluar. Por nëse edhe Ramazani nuk t’i shlyen gjynahet, vjen haxhi për atë që ka mundësi, të paktën një herë në jetën e tij dhe t’i shlyen të gjitha gjynahet që ke bërë në jetë. Nëse nuk ke mundësi për umre dhe për haxh, pendohu tek Zoti, se pendimi i shlyen gjynahet e robit dhe e nxjerr të pastër, siç e ka lindur nëna.

Prandaj ju ftoj ta përfjetojmë pak këtë namaz. Ta dimë se jo më kot Zoti ka bërë pesë namaze, jo më kot Zoti e thirri Profetin (a.s.), të shkonte në qiell e aty t’ia japë urdhrin për namaz. Urdhri për faljen e namazit është i vetmi adhurim që është caktuar në qiell e jo në tokë.

Namazi është puna e parë për të cilën llogaritet njeriu. Kur robi shkon tek Zoti, Zoti u thotë mekelëve: “O mekelët e Mi merreni në llogari robin Tim dhe shikojini namazet e tij. Shikoni në fillim namazet farze”. Nëse ai i ka falur të gjitha namazet në rregull, Allahu (xh.sh.), thotë: “Lum për këtë njeri. Shkruajeni atë nga banorët e xhenetit”.

Nëse farzet nuk i ka bërë siç duhet, disa i ka falur por nuk e ka pasur mendjen fare në namaz, atëherë Allahu (xh.sh.), u thotë mekelëve: “Shikoni nëse robi ka namaze sunete apo nafile”. Nëse ka, atëherë merret ky namaz dhe me të plotësohet farzi. Nëse nuk ka nafile apo sunete, farzi mbetet i mangët dhe llogaria nuk plotësohet.

Imagjinoje sikur të mos kesh as farze, as sunete e as nafile. Çfarë do t’i thuash Allahut (xh.sh.). Imagjino se ka njerëz, që nuk u janë shlyer gjynahet as nga abdesi, as nga namazi, as nga agjërimi, as nga haxhi, madje as mendja nuk u ka shkuar për këtë punë. Ata shkojnë tek Zoti të ngarkuar me gjynahe sa malet e malet janë të rënda. Në këtë rast të pret xhehenemi, Zoti na ruajtë prej tij.

E lus Zotin të na bëjë nga ata njerëz, që ftojnë për namaz dhe vetë e kryejnë atë, duke u bërë kështu një model i mirë për veten dhe për të tjerët.

Amin!..

3. **Hadith i vërtetë.** Ibn Hibani (6715) dhe Ahmedi (5/251). Shejh Albani e vlerëson hadithin të vërtetë, ndërsa shejh Shuajbi e vlerëson të pranuar.

4. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (528) dhe Muslimi (667).

RREZIQET E TË NDENJURIT ULUR

Hulumtimet e reja nxjerrin se të ndenjurit ulur 8 orë në ditë mund të rrisë me 60% rrezikun e një vdekjeje të parakohshme. Por shkencëtarët thonë se thjesht një shëtitje prej një ore mund të ndryshojë dëmin e të ndenjurit ulur për periudha të gjata. Si pas tyre, njerëzit që merren me aktivitete fizike me “intensitet të moderuar,” rreth 60-75 minuta çdo ditë, arrijnë t’i korrigjojnë rreziqet e të ndenjurit ulur gjatë.

Aktivitet sportive janë një mundësi e mirë për të eliminuar këtë rrezik. Por nëse dikujt nuk i pëlqejnë ushtrimet e vështira, mund t’i zëvendësojë ato me një shëtitje 30-60 min.

Shkencëtarët që kanë analizuar të dhënat nga më shumë se një milion njerëz mësuan se duhen rreth 60-75 minuta aktivitet fizik me “intensitet të mo-

deruar” për të ndrequr dëmin e shkaktuar nga të ndenjurit ulur për të paktën 8 orë në ditë.

Ata mësuan se mungesa e ushtrimeve fizike dhe të ndenjurit ulur gjithë ditës janë po aq të rrezikshme sa pirja e duhanit dhe mbi pesha.

“Aktiviteti fizik mund të përshkruhet si një pilulë magjike sepse mund të parandalojë gati të gjitha sëmundjet jo-ngjitëse. Nëse rri ulur për më shumë se 8 orë në ditë, do të ishte mirë të bënit ushtrime fizike për më shumë se gjysmë ore në ditë, ose 150 minuta në javë, që është koha e rekomanduar”.

Hulumtuesit thonë se të ndenjurit ulur për kohë të gjata rrit rrezikun e problemeve shëndetësore, duke përfshirë diabetin dhe sëmundjet e zemrës, sepse kjo rrit nivelet e insulinës dhe mund të ngadalësojë metabolizmin.

TË MIRAT SHËNDETËSORE TË RRUSHIT

Rrushi së pari është kultivuar në Evropë 6000 vite më parë. Kemi më shumë se 50 lloje të rrushit që kultivohet për tavolina kurse më shumë se 60 lloje që kultivohen për prodhimin e verës. Siç e dimë dhe kemi lexuar më parë rrushi është burim i madh vlerash ushqyese. Por kjo nuk është e gjitha sepse vlerat ushqyese të tij gjinden gjithashtu në farat e tij (substancat tanike, lecithin, flobafene dhe vaji yndyror), lëvorja e rrushit përmbanë substanca tanike dhe vajra, e gjithashtu edhe gjethet e rrushit përmbajnë të mira si sheqer, karotene, substanca tanike, kalium, sodium, silikon dhe hekur.

Rrushi është një burim i mirë i flavonoidit i cili i jep edhe ngjyrën e purpurt rrushit dhe lëngut të tij, sa më e fortë kjo ngjyrë aq më cilësore është përbërja me flavonoid.

100 gram rrush përmbajnë:



sheqer: 16g;
proteina: 0.6g;
yndyrë: 0.4g;
kalori: 60;
karbohidrate: 17g;

Të mirat Shëndetësore Të Rrushit

SËMUNDJA E ZEMRËS: Disa studime janë bërë duke i kushtuar vëmendje ndikimin e rrushit në ngadalësimin apo parandalimin e sëmundjes së zemrës. Rreth 20 vite më herët shkencëtarët kanë vënë në pah se Francezët kishin më pak probleme të lidhura me zemrën se sa njerëzit nga vendet tjera të botës. Kjo shpjegohej më konsumimin e madh të rrushit.

KANCERI: Rrushi ka ndikim në shkatërrimin e

qelizave kanceroze . Rrushi përmban sasi të lartë të acidit kafein, një element shumë i dëmshëm dhe armiqësorë ndaj kancerit.

VIRUSET: Në një studim të kryer në Erciyes University në Turqi, shkencëtarët kanë treguar se rrushi është shumë efikas kundër mikrobeve. Studimi tregoi se rrushi ishte shumë efikas ndaj bakteve të tilla si E. coli dhe Stop.

Rrushi është një burim i mirë energjie dhe ndihmon në pastrimin e trupit nga toksinat, gjithashtu ndihmon në pastrimin e mëlçisë dhe veshkave duke qenë se asimilohet lehtësisht. Po ashtu ndihmon në zvogëlimin e krijimit të pllakave të gjakut dhe mpiksjes së gjakut.

SHTATË ARSYE PËR NJË KONSUM MË TË MADH TË FIKUT

FIKU FORCON TRUPIN, PËRTËRIN FUQITË, RUAN SHËNDETIN DHE FSHIN RRUDHAT

NIVELI I LARTË I MAGNEZIT

Magnezi është njëri ndër elementet kryesore, cili e mbron sistemin tonë nervor nga stresi. Ka rëndësi të madhe për kockat, imunitetin dhe mirëfunksionimin e trurit, stimulon shëndetin dhe vitalitetin, shëron sëmundje të ndryshme dhe ngadalëson dukshëm procesin e plakjes. Fiqtë e thatë përmbajnë tri herë më shumë magnez sesa fiqtë e freskët.

VITAMINA DHE MINERALET

Fiku është i pasur me kalium, kalcium, hekur, fosfor, bakër dhe me vitamina, si B6, C dhe me betakarotinë. Përmbajtja shumë e ulët e yndyrës dhe niveli i lartë i fibrave, më i lartë se te çdo pemë apo perime tjetër, janë arsye pse duhet ta konsumojmë sa më shpesh këtë pemë. Pektina është një fibër, e cila e zvogëlon nivelin e kolesterolit të gjak, përdërisa triptofani ndihmon te problemet me qarkullimin e gjakut dhe të pagjumësisë.

SHEQERNAT NATYRORE

Përmbajtja e lartë e sheqernave natyrore do të sigurojë që truri juaj të punojë më shpejt, të pranojë dhe klasifikojë më mirë informatat. Natyrisht, duhet pasur kujdes te diabetikët, me rastin e konsumimit të fiqve të thatë, meqë ata përmbajnë dy herë më shumë sheqer sesa fiqtë e freskët.

PËRMBAJTËSIT USHQYSE

Fiqtë e thatë janë burim i mirë i shumë substancave ushqyese dhe paraqesin një shujtë praktike dhe të ushqyeshme, sidomos për sportistët dhe të rinjtë Çaji i fikut shëron sëmundjet e mëlçisë, fytyrës, organeve të frymëmarrjes, gurin në tëmth, etj.

STEROLET E BIMËVE

Fiku përmban edhe sterole të bimëve, të cilët kanë ndikim pozitiv në nivelin e kolesterolit në gjak. Sterolet e bimëve, sikur stigmasteroli dhe lanosteroli, që gjenden të fiku, lidhen me molekulat e kolesterolit në zorrë, duke penguar absorbimin e tij.

VEPRIMI ANTIKANCEROGJEN

Studime të shumta kanë zbuluar te fiku disa substanca me veprim antikancerogjen, sikur që janë benzaldehidi dhe kamarina. Këto substanca janë konsideruar si shumë të dobishme sidomos kundër karcinomës së prostatës dhe lëkurës.

HIDRATIMI

Fiku i freskët përmban deri në 80% ujë dhe 60% sheqer natyror, për këtë shkak fiqtë pengojnë edhe dehidratimin gjatë ditëve të nxehta. Shija e ëmbël e fikut përshtatet për mrekulli me shijen paksa të njelmët, sikur ajo e djathit të dhisë apo deles. Nga fiqtë e freskët mund të bëjmë komposto, pekmez, si dhe lëngje të fermentuara.





EKRAN I PADUKSHËM PËR IPHONE

Një shpikës kurd në Turqi ka zgjidhur një çështje pikante për shumë njerëz që përdorin telefonin në publik, por kërkojnë privatësi. Celal Goger ka shpikur një ekran sekret për iPhone-n që përmbajtjen e ekranit ta shohë vetëm përdoruesi. Kjo realizohet falë një mikroprocesori në syzet e diellit.

Celal Goger-it, i cili jeton në juglindje të Turqisë, ju deshën gjashtë muaj që të ndërtojë mikroprocesorin e parë për syzet që mundësojnë shikimin e ekranit sekret të celularit.

“Aktualisht veprimet kryhen përmes një mikroprocesori, por dua ta përmirësoj atë me një nano-procesor, me madhësi shumë herë më të vogël. Nëse do të kem sukses, kjo mund të vendoset në të gjitha syzet e diellit”, thotë Goger. Përdoruesit mund të montojnë nano-procesorin në njërën anë të syzeve për të mundësuar komunikimin me iPhone-n.

“Ndërsa mu deshën gjashtë muaj për të ndërtuar procesorin e parë, katër për të dytin, dy muaj për të tretin, tani më duhen vetëm 10 ditë.”

Shpikja tërhoqi vëmendjen e shumë njerëzve në rrugët e qytetit Bismil ku jeton Goger. Shumë prej tyre thonë se privatësia është problem. Ata nuk duan që njerëzit përreth tyre të shikojnë vjedhurazi ekranin e telefonave të tyre. Nevah Ayhan është banor i qytetit Bismil.

“Ekranit është tërësisht i bardhë dhe nuk shikohet asgjë. Kurse me syzet e diellit shikohet gjithçka. Kjo teknologji bën të mundur që ekranin e smartphone mos të shikojë askush tjetër.

Shpresohet të fillojë prodhimi në masë sepse kështu mund të përfitohet nga shpikja. Në këtë mënyrë njerëzit mund të ruajnë privatësinë e mesazheve, emailve dhe fotove.

Celal Goger thotë se ndërtimi i ekranit të padukshëm i kishte kushtuar vetëm katër dollarë. Por një variant i përmirësuar që mund të përdoret në syze të ndryshme mund të kushtojë deri në 10 dollarë. Ai shpreson që së shpejti ta nxjerr në treg shpikjen e tij.

VAZHDOJNË PLANET PËR UDHËTIM NË PLANETIN MARS

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Evropiane të Hapësirës (ESA), Jan Woerner thotë se udhëtimi për në Mars përbën një sfidë të madhe për shkak të gravitetit të lartë të planetit. Por ai mendon se Hëna mund të shërbejë si planet provë apo stacion transit për një mision në Mars.

Nëse ëndërron të udhëtosh në planetin Mars duhet të presësh të paktën 15 vjet, deri sa të zhvillo-

het e gjithë teknologjia e nevojshme për një sipërmarrje të tillë, thotë kreu i Agjencisë Evropiane të Hapësirës, Jan Woerner.

“Duhet rreth dy vjet rrugë vajtje-ardhje... por është një sfidë e madhe edhe për të zbritur në Mars, sepse planeti i kuq ka një gravitet më të lartë se Hëna. Është shumë, shumë e vështirë për të lënë përsëri Marsin dhe për t’u kthyer në Tokë”, thotë zyrtari në

një intervistë të tij.

Synimi i Agjencisë amerikane të hapësirës, NASA, është që astronautët amerikanë të mbërrijnë në Mars nga mesi i viteve 2030.

Drejtori i ESA-s, Woerner thotë duhet edhe shumë kohë për të arritur në Mars. Së pari për të dërguar një anije në Mars do të duhen raketa të fuqishme dhe karburant për t'u nisur nga Marsi për udhëtimin e kthimit, ndërsa njerëzit brenda anijes do të kenë nevojë për mbrojtje nga sfidat fizike dhe mendore, si dhe nga rrezatimi.

Ndërkohë, Jan Woerner mbështet idenë e krijimit të një rrjeti ndërkombëtar publik e privat të laboratorëve kërkimorë në Hënë, që ai e quan "fshat hënor", që do të zëvendësonte Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës kur këtij t'i vijë fundi dhe për të provuar teknologjitë e nevojshme për të realizuar udhëtimin në Mars.

Ideja e "fshatit hënor", thotë Jon Woerner, është "për të sjellë së bashku interesat e ndryshme të kompanive dhe vendeve, për shembull robotët dhe njerëzit, por edhe interesa krejtësisht të ndryshme si minierat, turizmi, dhe sidomos shkenca".

"Fshati hënor është një ndalesë në rrugën për në Mars", thotë Woerner, duke shtuar se teknologjia 3D e shtypjes mund të përdoret për të ndërtuar materiale dhe struktura nga shkëmbinj dhe pluhuri, duke hequr dorë nga mënyrat e kushtueshme për të transportuar çdo gjë të nevojshme për një mision.

Në muajin mars Evropa dhe Rusia filluan misionin ExoMars, në të cilin një anije do të përdorë një pajisje atmosferike për të çliruar shenja të jetës në Mars dhe për të vendosur një robot për të provuar teknologjitë e nevojshme për një Rover që është planifikuar për t'u lëshuar në Mars në vitin 2020.



Nga robërit e Tij,
Allahut i frikësohen
siç duhet
vetëm dijetarët.
Allahu është
i Plotfuqishëm
dhe Falës.

(Fatir, 28)

